

E

BIBLIOTEKA


884-32
P85

LILLEHÜLS

GJIROKASTER

STAVRI PONE

FLLADI I MBRËMJES



tregime

SHTA32
P 85

STAVRI PONE

**FLLADI I
MBRËMJES**

tregime



**SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»**

Fludi i mbrëmjes

Atë mbrëmje isha duke ecur pranë hotelit të madh, kur pashë së largu Hasanin. Me të kisha punuar disa vjet në Sharrat e Pukës, unë si inxhinier elektrik e ai si druvar. Kishim tre vjet pa u parë, që kur isha transferuar në një qytet të Jugut, e gjatë kësaj kohe pak kisha dëgjuar për të. Letra nuk këmbenim, por kjo s'do të thoshte se e kisha harruar. Dhe e merrja me mend se as ai mua. E kishim njojur njëri-tjetrin me dhëmbë e dhëmballë si i thonë, e ai s'ishte nga ata që i harrojnë shokët e vjetër. Iu afrova e i qëndrova përballë. Ai picërrroi sytë e çelur nën vetullat kaleshe, hapi krahët e m'u vërsul duke bërtitur:

- Çimi, për besë! Po ku je, mor haram!
- U përqafuam e u puthëm.
- Ku jam? Bredh lart e poshtë. Më rrëfe ti njëherë.
- Hajde, se të pyeta i pari. Ç'të ka sjellë?
- Apo je transferuar këtu?

— Rri, or Hasan, mos u tall! Erdha sot, me shërbim. Po ti?

— Edhe unë zëre se me shërbim. Na është shtruuar një shok në spital dhe kam ardhur ta shoh.

— Do të rrish nesër?

— Paradite po. Pasdite do të nisem. Zëra dhomë në hotel e thashë të ha darkë. Vonë do të shkoj prapë në spital. Eja të më shoqërosh.

Unë u mendova një hop. Darkë do të haja nga ime motër, Viku, dhe atë e kisha njoftuar me telefon (ajo ishte mjeke në një ndërmarrje), por të ndahesha ashtu shpejt e shpejt me Hasanin s'ma kishte qejfi. Kishim kaluar shumë ngjarje e peripeci së bashku. Le që me Hasanin edhe dy ditë njojje të kiske do të ndieje se e kiske bërë shok pér téré jetën.

Nisëm të ecnim kuturu, ende pa vendosur si të bënim. Hasani më shkoi krahun e zuri nga pyetjet e zakonshme: ç'thoshte puna, si e kisha gruan e kështu me radhë... Po ashtu nisa ta pyesja edhe unë e së fundi dolëm atje ku e nisëm: do ta shoqëroja unë atë, apo ai mua. Se, pa bërë një copë herë të mirë muhabet, s'kishim si ndaheshim, se të dyve nuk na bënte zemra.

— Dëgio, — i thashë, — eja më mirë ti me mua.

— Ku?

— Shkojmë tek ime motër, Viku. Ti e njeh. Është këtu tani. Ka dy vjet që i është transferuar i shoqi.

— Ou, sa mirë! Më së fundi. Se kaq herë e kishin kërkuar, apo jo?

— Po. Kështu, shkojmë bashkë tek ata. Këta dy vjet edhe unë rrallë kam ardhur në Tiranë. Ha-

më darkë andej. Edhe pér të fjetur rri, vend kanë.

Hasani zuri të mendohej.

— Pér të fjetur jo e jo, por edhe pér darkë, ku di unë...

— Eja tani, — i thashë dhe e zura nga dora.

— Tek ajo je si tek unë. Kanë mall pér njerëz ata, Hasan.

E tërroqa nga krahu. Kundërshtimi që i vura re në fillim nisi t'i zbutej.

— E po, fundja, mirë. Vetëm shkojmë pak nga dyqanet të marr gjësend. Më kuhton, kështu thjesht pér...

— Eja, mor, tani! — ia preva unë.

Mirëpo ai nguli këmbë dhe unë u detyrova të têrhiqesha. U futëm në një dyqan frutash, ku ai bleu nja dy kile portokalle. Unë kisha blerë me kohë një çokollatë të madhe pér vajzën e Vikut, Lilin e vogël.

Ngjitëm shkallët e apartamentit ku banonte motra dhe trokita në derë. Nga brenda u dëgjuau zëri i hollë i Lilit, që i thërriste së emës. Çelësi kërciti dhe dera u hap. Ballë meje u dha Viku me atë fvtyrën e saj të pastër, pérherë e zbukuruar nga një buzëqeshje e lehtë, e këndshme. E dija se ashtu, buzagaz, do të ma hapte derën. Ashtu më kishte pritur gjithnjë ajo. Por, kur mbi supin tim vuri re fytyrën e Hasanit, diçka ndryshoi në shprehjen e saj, diçka që mezi kapej, një si ngurim a hутim i castit..

— Kam ardhur me një mik, — i thashë dhe i hapa rrugë Hasanit.

— Mirë se ju gjej. — i tha ai dhe i zgjati dorën. Viku i dha të sajën, por pa gjallëri. Dukej se

ende vazhdonte të ishte nën pushtetin e hutimit. Unë vura buzën në gaz.

— S'po e njeh?

— Ashtu duket, — tha Hasani, edhe ai i qeshur në fytyrë.

Viku sikur u shkund.

— S'po më bie ndër mend... Po ç'rëndësi ka? Ejani brenda!

— Është Hasani, moj Viku! Na ka ardhur edhe në shtëpi!...

— Ah, po. Ai shoku yt i ushtrisë, nga Pogradeci...

— Jo, moj! Ky është Hasani, sharrëxhiu nga Puka! Edhe je njohur, edhe të kam folur...

— Sa fytyra shohin në ditë doktorët, more inxhinier! — m'u drejtua Hasani me të qeshur.

— Më fal, po ja... — tha si e zënë ngushtë Viku. E pashë që nuk i erdhi mirë për këtë harresë. Ajo e mbante veten për njeri me kujtesë të fortë.

Hymë në kuzhinë. Hasani i zgjati qeskën me portokalle. Ajo e mori dhe na pa nga këmbët.

— Sikur t'i hiqnit këpucët! Gjithë ajo baltë jashtë...

— Rri, Viku, tan! Ku i kemi me baltë?

— Hajde, hajde! — nguli këmbët ajo me një ton si urdhërues e si me të qeshur.

Unë për vete e kisha të vështirë t'i hiqja këpucët kur shkoja në ndonjë vizitë, por aty isha si në shtëpinë time dhe domosdo do t'i hiqja, ndërsa Hasani s'kishte përsë. Mirëpo ai jo që nuk e prishi qejfin, por e quajti me shumë vend kërkësën e saj.

U ulëm në divanët e mëdhënëj e të bukur e

ndezëm nga një cigare. Viku merrej me ca punë nё aneks. Lili e shikonët me kёrshëri Hasanin, pa guxuar t'i afrohej. Ai përpiquej ta merrte me tё mirë, por ajo nuk lëvizte nga vendi.

— More, — mё tha papritur ai, — si s'u kujtova qё këtu ka një vajzë tё vogël?

— Pse?

— Si, ore, pse! — foli ai i shqetësuar. Nxori me tё shpejtë një trelekëshe dhe ia zgjati vajzës.

— Merre, t'u bëftë xhaxhi. Do tё tё kisha sjellë një çokollatë.

— Pse, pak ishin portokallet? — i thashë.

Lili ngurronte ta merrte. Atё kohë nga aneksi doli Viku.

— Thuaji «falemnderit» xhaxhit, — i tha ajo.

Lili e mori me druatje, kartëmonedhën dhe e futi nё njërin nga xhepat e vegjël tё fustanit. Mua s'mё erdhi mirë nga qëndrimi i Vikut. Ajo u largua pёrsёri, ndёrsa unë nisa tё bisedoja me Hasanin. Pyesnim njёri-tjetrin pёr shokët e tё njo-hurit tanё. Ndёrkohë hidhja vështrimin rrrotull nё-pёr kuzhinё, e cila, qysh nga ardhja ime e fundit, kishte ndryshuar mjaft. Tёrё dhoma ndriste e shkёlqente. Natyrisht mё bёhej qejfi pёr komoditetin nё tё cilin jetonte motra ime. E megjithatë nuk di pse mё dukej se pamja qё tё zinte syri pёrreth nuk tё gёzonte. Ndoshta ngaqё diçka tepёr e spikatur buronte nga sendet, nga ai shkёlqim, diçka qё sikur ngulte kёmbё me kokëfortësinё pёr tё tё tёrhequ r vëmendjen.

Me ç'dija unё, Pavlloja dhe Viku bënin jetë tё thjeshtë. Viku ishte amvisë e mirë, e rregullonte pёr bukuri ekonominё e shtëpisë. Kjo mё kishte

pëlqyer gjithnjë tek ajo, se ne kishim kaluar një fëmijëri të vështirë.

Përfytyrova shtëpinë tonë të dikurshme, struktur midis kallamave e shelgjeve që harliseshin buzë një lumi të qetë. Ajo kishte qenë vatra e vegjëlisë sonë. e neve të shtatë fëmijëve. vëllezër e motra. Malli ma mbushi zemrën për atë shtëpizë prej plitharësh, me pak orendi të vendosura me rregull anës mureve të pastra të lyera me gëlgjere.

Unë u shkunda nga kujtimet.

— Viku, — e pyeta duke hedhur shikimin nëpër dhomë, — shumë ndryshime keni bërë këto kohë. I paskeni blerë të gjitha të reja, apo jo?

Asaj i ndriti fytyra.

— Po. Pse, keq?

— Keq sigurisht jo...

Viku u mbush me frymë, m'u ul pranë e ma vuri dorën në sup.

— Jeta shtron vazhdimisht kërkesa të reja, vëlla. Ndryshe atje ku ishim, ndryshe këtu.

— Pse?

— Si pse? — Sytë e Vikut sikur u errësuan një grimë. — Ti mendoke se është njëlloj?

Unë e lashë të vazhdonte.

— As që mund të mendohet se është njëlloj. C'ishte Pavlloja atje? Njëfarë kryetar dege i një ndërmarrjeje tregtare. Kush i vinte për vizitë? Shokët e rangut të tij e shumë-shumë drejtori apo nëndrejtori. Kurse këtu, vëlla, vijnë nga ministria, e njerëz jo dosido. Para ca kohësh e pruri rasti të na vinte njëri nga zëvendësministrat, nesër-pasnesër do të na e bjerë rasti të vijë edhe ministri. Kështu që, do, s'do, shtëpisë do t'i japësh fy-

tyrën që duhet... Edhe rrëthi i njerëzve ku punoj unë s'është si atje, në provincë.

— A, këtu s'puqem me ju! — u hodh Hasani.

— Më fal, motër, se si motër të kam, edhe andej njerëzia dinë të jetojnë, e të jetojnë mirë.

Viku sikur e humbi pak, se vërejtja e Hasanit i erdhi e papritur.

— Nuk them se jo. Por ama këtu i thonë kryeqytet!...

— Ju keni shpenzuar shumë brenda një kohe fare të shkurtër, Viku. Jeni sforcuar tej mase...

— Po. Veç kemi kohë që kursejmë, Çimi. Kemi llogaritur edhe qindarkën. Transferimi i Pavllos pritej, dhe ne kishim kohë që hiqnim mënjanë. Pastaj, këtu hyrje-dalje s'kemi shumë. Siç të thashë, vetëm shokët e punës të Pavllos. Te të tjerë as vemi, as na vijnë.

— Si, qenkeni mbyllur në qelqe ju? — ia prita unë me shpoti.

— Vikut i dogji shprehja, por s'e dha veten.

— Kush ua ka ngenë vajtje-ardhjeve sot, more Ndriçim!

— Nuk e di, — u hodh Hasani, — po ne andej bëhemë shumë me njëri-tjetrin. Ja, të thotë vetë Çimi.

— Po këtu bëhet tjetër jetë, more mik, — tha Viku me të qeshur dhe u ngrit. Nga aneksi u dëgjuva zhurmë enësh. Dukej se Viku nisi të merrej me përgatitjen e darkës. Pas pak ajo u dha midis perdeve të aneksit dhe tha:

— Më falni që u ngrita, po tani vjen Pavlloja dhe darkën ai e ha në orën tetë e gjysmë. Mbaron

së ngrëni e zhytet në materialet e zyrës. Është i mbytur në punë, Çimi, — m'u drejtua mua.

Unë i hodha një sy orës. Ishte tetë e njëzet.

— Juve po ju bëj një kafe, — iu drejtua Viku Hasanit.

— Lëre kafen, — i thashë, — Hasanin e kemi për darkë.

Vura re se shprehja e fytyrës së saj ndryshoi disi, si aty e pak më parë te dera, kur pa Hasanin.

— Ashtu? E po mirë. Pse jo?

Ajo u përpoq të vinte buzën në gaz, po buzë-qeshja nuk qe tamam e saj, domethënë jo ajo e Vikut të dikurshëm. që i jepte një ciltërsi e dëli-rësi gjithë fytyrës. Tani, për çudi, ajo buzëqeshje ishte ndryshe, si e kopjuar.

Viku u dha fund punëve në aneks, u kthye e u ul pranë vajzës.

— Lili, recito vjershën që mësove dje në kopsht.

Lili dukej nuk kishte qejf, por edhe unë e nxita:

— Hajde, Lili. Ta dëgjojë edhe xhaxhi Hasani.

— Jo, jo.

Vikut iu prish qejfi.

— Reciton jashtëzakonisht bukur, — iu drejtua ajo Hasanit. — Të gjithë thonë që është tepër e zgjuar.

Hasani miratonte duke tundur kokën, me buzën në gaz. Në fytyrën e tij nuk kishte asgjë tallëse. Kurse unë do të kisha dashur të kishte. Ose ndosh-ta dhe pati, por unë s'e kapa. Lëvdata të tillë të disa prindërve për fëmijët e tyre s'i duroja dot.

— Viku, — i thashë, — si Lili ka plot fëmijë në kopshte.

Ajo më pa drejt në sy.

— E nga e ditke ti? Po vizatimet e saj të fundit i ke parë?

Ajo nisi të kërkonte me nxitim në sirtarët e bufesë.

— S'ka nevojë, de! — e ngrita zërin unë.

— S'ka gjë, le të na i tregojë, — tha Hasani.

— Edhe unë kam një çamarrok që shkarravit tërë ditën.

— Ndriçimi ende s'i kuption disa gjëra, — tha Viku me një farë toni pajtues.

— Sikur të na sillje ndonjë gotë, Viku. Ë?

Ajo rrudhi vetullat.

— Unë thashë kur të vinte edhe Pavlloja...

Ajo hapi një kanat të bufesë dhe nxori një magnetofon të vogël, të bukur. Unë pashë Hasanin dhe më duket se e kapa atë që kërkova në fytyrën e sytë e tij. Shprehja e ironisë ishte e hollë, mezi dukej. Mua nisi të më vinte keq për Vïkun. Ajo gjithnjë kishte qenë e thjeshtë. Kurse tani...po vija re ca gjëra që s'më kishin rënë në sy më nărë. Ç'ishte ikjo punë kështu?

Ajo na vuri përpara nga një gotë dhe na i mbushi nga shishja, të cilën e futi përsëri në bufe. Solli pastaj një pjatë me ullinj e portokalle dhe djathë. I thashë të pinte një gotë me ne, por ajo kundërshtoi.

— Kam ecur shumë në frëngjisht, — tha pa iu drejtar askujt dhe shtypi ca butonë të magnetofonit. U dëgjua një zë i kulluar femre që shqiptonte ca tinguj hundorë.

— Jam unë, — tha. — Pejagogia më thotë se shqiptimin e kam të bukur.

Unë s'merrja vesh nga frëngjishtja dhe s'mund të gjykoja si e kishte shqiptimin ajo, veç nuk më erdhi mirë nga mënyra se si i tha ato fjalë.

— Na duhet gjuha e huaj, — vazhdoi, — sidomos neve mjekëve. Ju dini ndonjë? — pyeti Hasanin.

— Vetëm shqip, — tha ai me të qeshur. — Dhe jo aq mirë, se bëj ca gabime në të shkruar. Por kam simpati për ata që kanë vullnet të mësosjnë gjuhë të huaj. Ja, Ndriçimi eci mirë me anglishten andej. Shpesh e gjeja me libra në duar, futur nëpër zgëqe apo ulur mbi trungje. Nuk di si ece më vonë, Çimi, — më tha ai duke u kthyer nga unë.

— Po...jo dhe keq.

Ndërkohë gotat tona ishin zbrazur. Unë po matesh t'ia bëja me shenjë Vikut të na i mbushte përsëri, por ajo kishte ngjeshur veshin te magneto-foni, të cilit ia kishte ulur zërin dhe dëgjonte. Të isha vetëm, nuk do të kisha druajtje t'i thosha, por në prani të Hasanit pata frikë se do ta fyeja. Megjithatë, i vënë në pozitë të vështirë në sytë e mikut, s'bëra dot ndryshe e i thashë:

— Na e mbush edhe nga një, motë?

Ajo u shkund nga përhumbja si me qejf të prishur. Atë kohë në derën e jashtme u dëgjuan të trokitura. Viku e la shishen mbi tryezë dhe dolli. Nga korridori vinin ca zëra të paqartë. Unë mbusha gotat. Viku u kthyte në dhomë dhe unë e pyeta se kush kishte qenë.

— Më kërkuan te një i sëmurë.

Ajo u ul dhe u zhyt përsëri te magnetofoni.
Unë e pashë në sy.

— Hë? Nuk do të shkosh?

— Oh, Çimi. Sikur nuk ka mjekë poliklinika!

U ngrit me një mërzitje të dukshme në fytyrë,
mori shishen në dorë, hapi kanatin e bufesë dhe
na pyeti:

— Besoj s'doni më.

Hasani vuri dorën në zemër.

— Jo, besa...

Unë përpinqesha t'i shmangesha shikimit të tij.
Një si zjarrmi më vinte valë-valë. Nga magnetofoni u dëgjua zëri i një fëmije, copëra bisedash,
të qeshura, zhurma. Viku e fiku aparatin. Ora po
shkonte afër nëntës. Lili po merrej me një kukull.

— Eja të flesh, Lili, — i tha Viku vajzës dhe
e mori në krahë. Duke ecur, diç i pëshpëriti në
vesh. Lili na tha «natën e mirë». Ne ia kthyem
pëershëndetjen me ton gazmor. Pastaj në kuzhinë
ra heshtja.

Gjithnjë e më tepër po ndieja se mungonte në
atë atmosferë digka e ngrohtë dhe e afërt. Ato bi-
seda të thëna kalimthi kishin qenë vetëm sa për-
të përzënë atë heshtje të ngurosur. I takonte mot-
rës sime, si zonjë shtëpie që ishte, t'i jepte tonin e
duhur mikpritjes.

Dera e jashtme kërciti e në kuzhinë hyri Pav-
lloja. Ai gjithmonë më kishte bërë përshtypje me
trupin e tij të madh, me fytyrën e pastër e të lë-
muar si prej fëmije, me ata sy me ngjyrë të çelët
që, kur të ngjiteshin, të vështronin me aq vëmen-
dje, sa dukej sikur domin të të shponin tejpërtej.

Kur na pa bëri një përpjekje pér të vénë bu-

zën në gaz, por nuk di ç'e pengoi d'he buzëqeshja i doli e thatë. Edhe herë të tjera e kisha vënë re që, edhe pse buzëqeshjen e kishte të këndshme, përsëri, kur përpinqej ta vinte buzën në gaz pa dëshirë, ajo i dilte e shpëlarë, gati e shëmtuar.

— Pa shih, — bubulloj zëri i tij i trashë, — miq! Për besë...

Ne ishim ngritur në këmbë e prisnim të vinte të na jepte dorën, por ishim nxituar. Ai nisi të zbërthente pardesynë. Si la edhe këpucët në korridor, hyri bashkë me Vikun. Na dha dorën e na ftoi të uleshim. Unë e njoha me Hasanin. Këmbyem ca fjalë të përgjithshme e gjithshka u mbyll me aq. Ai hapi çantën, nxori ca fletë, të cilat se përsë i kontrolloi e na tha si me përzemërsi:

— Ju hani darkë. Unë do të vazhdoj punën për një material që duhet t'ia çoj ministrit që në mëngjes. Më falni!

I dha dorën Hasanit e doli nga kuzhina për t'u mbyllur në dhomë.

Viku nisi të shtronte darkën.

— Viku, — i thashë, — që kur ka filluar Pavloja kështu?

Ajo më shikoi me habi.

— Si kështu?

— Po ja, kaq maniak pas kohës.

— Ka shumë punë, Çimi. S'është e lehtë të punosh në Tregtinë e Jashtme. Kontrata, shifra, përgjegjësira, mijëra e qindra mijëra dollarë...

Mua më hipit inati.

— Dëgjo, Viku. Askush nuk ka kohë sot për ta humbur kot. Por...sa për të nderuar mikun, njeriu e gjen kohën.

Ajo u zu ngushtë.

— Po mirë, ja, do të hamë bashkë.

Ne s'jemi keq pér të ngrënë, pér pak sa s'i thashë, por u pérmbajta. Është diçka tjetër në këtë mes, diçka që s'ka të bëjë fare me anën materiale të jetës, por që është shumë më e rëndësishme se ajo, e kurrsesi nuk duhet harruar. Më hipi një dëshirë e papërbajtur pér të ikur. Por diçka e brendshme më pengonte të lëvizja.

Veç atë që s'e bëra dot unë, e bëri Hasani. Ai u ngrit, u drejtua nga Viku e fare shpenguar i tha:

— Mua do të më falni.

Vikut i erdhi e papritur.

— C'është ajo?! Ne akoma s'kemi filluar...

Unë ndërhyra me të shpejtë:

— Shkoi vonë, Viku. Hasani duhet të vejë edhe në spital.

Ajo nuk e zgjati. Dolëm në korridor. Atje i thirri Pavllos.

— Mos e shqetësoni, — i tha Hasani. — Të mirë u piékshim.

Ai i dha dorën e doli te shkallët. Pas tij dola edhe unë.

— Do të vonohesh? — më pyeti Viku.

— Jo, — i thashë, — sa ta përcjell pak.

Por menjëherë u pendova që i thashë ashtu. Do të kisha dashur t'i thosha se mua më kishte ikur dëshira pér të ngrënë darkë tek ata...Dhe jo vetëm pér atë natë, por edhe pér shumë kohë më pas, derisa ajo me të shoqin të ishin kujtuar se e rëndësishme në një darkë nuk është vetë darka, po diçka tjetër... E megjithatë ti, Viku, e ke ditur këtë, i

thashë me mend. Kurse duhej t'ia kisha thënë me zë. Por, për fat të keq, ne jo gjithmonë ia themi tjetrit atë që duhet t'i themi. Dhe bëjmë gabim. Bëjmë shumë gabim.

Dolém në rrugë. Ajri i ftohtë i natës të priste si brisk. I mbusha mushkëritë plot me atë ajër të pastër. Prisja që Hasani të thoshte diçka. Por ai heshtte. Heshtja nganjëherë flet më tepër se fjalët.

— Më fal, Hasan, — i thashë papritur.

— Çimi, he burrë, pse?...

Ai më zuri nga krahu.

— Nuk e pandehja.

Bëmë një copë rrugë në heshtje.

— Kthehu, — më tha Hasani, — ata të presin.

— Le të më presin, — i thashë.

Atë çast kryqëzuam shikimet. Në sytë e shokut pashë një dritë të pastër gëzimi.

— Shiko, — i thashë, — diku këtu është një restorant. Hamë e bisedojmë sa të çmallemi. Pastaj do të të përcjell.

Hasani më hodhi krahun e vazhduam të ecnim. Rruga ishte e pastër, e qetë, me ca gjethë të rralla. të saporëna. Në qiel qidheshin yjet dhe mbi pemët, shtëpitë e pallatet frynte një fllad i freskët mbrëmësor, sikur binte një flauri e ngarkuar me pluhur argjendi.

Thirrja e gjelbërimit

M'u bë sikur dikush ndezi një fener para fytyrës sime. Kur hapa sytë, ndjeva një flakërimë verbuese që më bëri t'i mbyllja sakaq. Nga dritarja e vogël e barakës më ra një gulsh rrezesh nga dielli në perëndim, që bëri të më dilte gjumi.

Hodha sytë nëpër kapanon. Frymë njeriu s'kishte. Edhe në atë mugëtirë binte në sy rregulli e pastërtia: krevatet, të bëra prej dërrasash, ishin të gjitha të rregulluara. Nga të gjitha barakat e djemve ajo jona mbahej më e mira. Kjo ndoshta për shkak të Lelit, që flinte në të djathtën time dhe që e kishim caktuar kujdestar. Ai s'e kishte për gjë t'i bënte kujtdo vërejtje sa herë prishej rregulli e pastërtia.

Vura duart nën kokë dhe nisa të mendohensha. Pas disa ditësh të gjithë ne vullnetarët, rrëth shtatëdhjetë djem e vajza, pasi kishim punuar dy vjet këtu, do të largoheshim. Pas nesh kanë ardhur pothuaj dhe kaq të tjerë dhe qyteza jonë, e ngritur në mes të një pylli më vidhë e plapoësh-të mbushur plot me barakë. Vitin e pare ne u mo-

rëm vetëm me shpyllëzim dhe me sistemimin e tokave të reja që ndeheshin sa të hante syri, kurse vitin e dytë, domethënë vjeshtën e kaluar, bëmë mbjelljen e parë të grurit. Ata që erdhën pas nesh, vazhdonin shpyllëzimin, që do të vazhdonte edhe disa vjet të tjerë.

Ne kishim ardhur aty nga uzina e ndërmarrje të qytetit për të punuar vullnetarisht. Mirëpo ato ditë midis nesh, aksionistëve dyvjeçarë, kishte nisur të flitej për një nismë. Do të shtyhej koha e qëndrimit aty edhe për një vit tjetër. Unë asnjëherë nuk e mora dot vesh se kujt i kishte rënë ndër mend të parit të bënte një propozim të tillë. Thannë se Lelit, azotikasit, po, sa herë e kisha pyetur, ai i ishte shmangur përgjigjes. Po, në fund të fundit, pak rëndësi kishte kjo gjë.

Në dhomë hyri Leli, me peshqirin hedhur krahe. Ishte vetëm me kanotierë e trupi i tij thanatik dukej si purtekë. Ai ishte i afruar e i dashur me njerëzit, i zgjuar e me humor sa s'ka më, por mua, që kur kisha marrë vesh propozimin e tij për shtyrjen e afatit të qëndrimit, sikur s'ma kishte qejfi të bëja muhabet e shaka me të si më parë. Se për biseda të këndshme e shaka Lelit s'ia gjeje shokun.

U ngrita, mora peshqirin dhe bëra të dilja.

— Pasdarke kemi mbledhje, — më tha Leli.

— E di, — i thashë pa qejf. Dola jashtë dhe shkova te muslluku që varej në një trung vlepë. Por nuk u lava. Hodha sytë përqark dhe thitha me gjithë mushkëritë airin e freskët, të ngarkuar me aromat e mrekullueshme që vinin nga pylli dhe që të futnin në shpirt një ndjenjë ëndjeje e leh-

tësimi. Kontakti me natyrën gjithnjë më ka shkak-tuar një kënaqësi të veçantë. Pylli dritëzonte planga-pllanga; një mjegull e hollë, si avull, varej në-për gjethishtet e tij; nëpër degëzat e bistakët e njo-më, ku kishin nisur të buisnin filizat e rinj, frynte gjithë pëshpërima flladi pak i lagësht, që vinte nga deti. Tërë pylli merrte frymë thellë, i heshtur e hijerëndë, ndonëse kishte filluar të dallohej harlis-ja e gjethit të ri, me lëngjet gurgulluese, të pë-rjetshme të pranverave përtëritëse. Barakat tonë, të kredhura mes drurëve e shkurreve, nxinin aty-kë-tu; nëpër ndonjë tel të vendosur mënjanë dallo-heshin rroba të ndera, fjolla të lehta të kaltra ty-mi lodronin mes drurëve e shkriheshin në tisin e hollë të mjegullës.

U rrrova shpejt e shpejt dhe u futa në barakë. Leli kishte dalë. Vesha pulovrin e trashë golf prej leshi, që ma kishte thurur e ngjyer me gjethe arre gjyshja, pastaj xhakaventon prej lëkure të zezë, fshiva shpejt e shpejt këpucët, futa në xhep pake-tën dhe çakmakun e, si i hodha një sy të fundit vetes në pasqyrë, bëra këmbë për nga sheshi i qy-tezës.

Ai ziente nga zërat e aksionistëve që gëlonin. Para mensës një grup vajzash e djemsh ia kishin marrë këngës «Mes Agimesh të zjarcta». Ca të tjerrë, më tej, luanin volejboll. Unë u afrova dhe kërkova me sy Ilirianën, se asaj i pëlqente volejbolli e luante edhe vetë, por nuk e pashë. Në kohën që gatitesha të pyesja Edlirën, një shoqe të saj, ma preu rrugën Meti. Me të isha në një skuadër.

— Hajde, ç'e paske humbur? Ku e ke mendjen?
— Te ti jo, — i thashë e bëra të ikja. Meti nuk

më pëlqente. Ai i bënte bisht punës e kishte qejf të hidhët ndonjë thumb, vend e pa vend.

— Prit pak, prit.

— C'kishe?

Ai m'u afroa me një pamje enigmatike në ftyrë.

— U dogjëm Pandi! Të gjithë paskan qejf të rrinë këtu edhe një vit...

— Të gjithë? Kush tha të gjithë?

— Në mos të gjithë, shumica. Po prapë njësoj është, të gjithë do të thotë edhe kjo.

— Jo, mor vëlla, — i thashë unë. — Secili ka arsyet e veta për të ndenjur a për të mos ndenjur.

— Tamam. Ashtu them dhe unë. C'arsye do të nxirrje ti, për shembull?

— Atë që është: punova dy vjet, sa qe detyra, e boll. Tani dua të punoj në zanatin tim. Edhe qyteti ka nevojë...

— Mirë, po do thonë se fshati ka më shumë nevojë.

— S'prishet puna për një a dy veta. Po tani më lër, Meti, — ia preva shkurt dhe i ktheva shpinën.

U nisa për te fjetorja e Ilirianës. Duhej të bise-doja patjetër me të.

Kapanonet e vajzave shtriheshin në një rresht të gjatë në skaj të pyllit atje ku fillonin tokat e reja, të posahapura, që humbisnin tutje, në largësi. Para kapanoneve shtrihej një lëndinë e vogël, anës së cilës kishte postate lulesh të rritura me kujdes nga vajzat. Vendi aty përqark më pëlqente shumë. Ndonëse marsi ende s'kishtë dalë, të mbyste harlisja e bimëve, bisqeve e gjithfarëlloj shkrresh që rrëthonin barakat si një kurorë e mbushur

me freski e fshehtësi. Matanë këtij gardhimi të dendur hapej një qiel i paanë, plot drita e reflekse me nuanca gjithfarë ngjyrash.

Përpara barakës ishin disa vajza. Njëra, sa po më pa, më buzëqeshi e i thirri Ilirianës, që, me sa dukej, ishte brenda.

Pas pak doli. E gjatë, e hajthme, me atë fytyrën e ëmbël, të rrethuar nga kreila të dendura gësh-tenjë, Iliriana vazhdimisht kishte diçka që të bënte përvete. Ajo kishte veshur një fustan të gjelbër me pika të verdha dhe një triko bezhë, që i shkon te shumë. Iliriana gjithnjë vishej thjeshtë e me shije.

Ne è kaluam zonën e ndriçuar nga llambat e rralla elektrike e dolëm në një rrah me lastarë, të spërkatur me një pikëlim vesor, që vezullonte zbehtë. Mugëtira copëzohej mes asaj bimësie të dendur, ndërsa nata tërhipej nëpër çeltinat. Këto pamje të përziera me zukatjet e flatrimet e befta të shpendëve e ndonjë fërfërimë gjethesh të ngjallnin një prehje në shpirt.

— Pse je kaq i heshtur? — më pyeti Iliriana.

— Është e vërtetë se mbledhja do të bëhet që të shtyhet aksioni?

Ajo më pa drejt e në sy.

— E, po qe për atë, çfarë?

— Si? Pse, gjë e vogël të duket?

Ajo qeshi.

— Jo po gjë e madhe!

Gjithnjë më vinte inat me të. Që në fillim ajo e kishte ndier vëten si në shtëpi aty, kurse unë mezi i kisha shtyrë javët e para. Më vonë u mësova me punën e me çdo gjë, por malli gjithnjë e më

shumë më hante për qytetin, për punën atje, për shtëpinë. Ja që isha më i ndjeshëm se ajo. Apo dhe ajo ndiente po të njëjtën gjë? I kapa dorën dhe e tërroqa nga vetja. Me atë veprim desha të largoja shprehjen e ironisë që sikur buronte nga tërë ftyra e saj. Me dorën tjetër i lëdhatova flokët e butë, të njomur nga lagështia e pyllit.

— Sa s'të shkon kjo pamje e zymtë, — tha ajo dhe përsëri vuri buzën në gaz.

Unë ia lëshova dorën. Më erdhi inat. Pse s'më kuptonte, xhanëm? Si mund të rrnim një vit të tè tèrë të ndarë nga njëri-tjetri? Se ne kishim vendosur që, me të ikur nga aksioni, të shpallnim fjesën. Mirëpo ajo kishte menduar të rrinte... Ajo ishte nëntëmbëdhjetë vjeçë, moshë kurjeta të duket èndërr e èndrra jetë, kurse unë isha njëzet e katër...

Nisëm të ecnim në një rrugë të gjerë, ku drurët, tanë të rralluar, merrnin ca forma të çuditshme; puhiza e natës u bë më e mprehtë, nga qielli, tanë krejt i zbuluar, kullonte një dritë e qashtë, si pluhur yjesh, të cilat kishin nisur t'i pulitnin sytë e tyre dridhërues. Nga lindja po ngrihej hëna, një hënë e madhe me lëmim floriri, aq e pastër dhe e ndritshme, sa dukej si e porsadalë nga një banjë avujsh të kaltëremë qiellorë... Vinin si gumëzhimë e mytur që matanë pyllit zërat e aksionistëve dhe oshëtimë e largët e detit.

— Pse më more këtu? Që të më mërzitësh me këtë heshtjen tënde?

Në zërin e saj ndjeva qortim e dhembje. Edhe mua më dhembte ajo heshtje. Po ç'të thosha? Kur m'u duk se i gjeta fjalët që më duheshin, fola:

— Ti, Iliriana, s'ke pse ta shikosh shtrembër dëshirën time pér të ikur. As ti e as kushdo. Dy vjet punova këtu jo më keq se të tjerët. Tani më thërret puna ime: korenti e telat. Më mori malli pér ta. Gjithnjë shoh në èndërr sikur jam në oficinë. Ka gjë të keqe këtu? Në këto toka do të vijnë të tjerë e të tjerë. Kështu èshtë rregulluar kjo punë. Kurse unë...nuk duroj dot më pa punën time.

— Të gjithëve na pëlqejnë punët tona në uzina. Por, nëse do të rrimë, do të rrimë të gjithë, përsëri pér të mirën e punëve.

— Jo. Unë do të iki!

— Këtu èshtë aq bukur, Pandi... Po e kalojmë aq bukur!

— Po kuçh tha jo, xhanëm?! Kush tha?

— Me ty s'u flitka sonte, — tha ajo e prekur dhe ktheu kokën mënjanë. — S'të kam parë ndonjëherë kaq të vrazhdë.

Unë s'iù përgjigja. Ndonjëherë na pëlqen që vajzat të na quajnë të vrazhdë, e kam fjalën pér ne, të rintjtë. Në atë moshë vrazhdësinë e barazojmë gabimisht me forcën dhe neve na pëlqen të na quajnë të fortë.

— S'është mirë, Pandi. Do të flasin keq pér ty. S'më vjen mirë.

— Le të thonë ç'të duan.

Ajo heshti një grimë. Pastaj tha:

— Nuk do të rri më. Eia më përcill.

Morëm rrugën e kthimit, pa folur. Hëna tani ishte ngritur më lart dhe drita e zbehtë, që derdhej mbi pyll, dukej si e ngjyer me pikëllim. Kur do të ndaheshim, më tha:

— Ti e vendose? — më pyeti Artani. — Do të ikësh?

— Pothuaj, — iu përgjigja unë pa e fshehur dot mërzitjen që më kishte hipur.

— Më mirë, qëndro, — më tha Artani. — S'po ia kalojmë keq, de! Ikën shpejt viti. Ç'është një vit pér ne?

Unë bëra një gjest të papërcaktuar me dorë dhe u thashë gjoja shpenguar:

— Nuk thashë se e kam vendosur.

U ndava nga ata dhe nisa të çapitja ngadalë, pa ditur as vetë ku të shkoja.

* * *

Ecja pas grupit të djemve që çanin shtegun e bisedonin me zë të lartë. Shtegu ishte i ngushtë, i anëzuar me shkurre e degë që të fshiknin fytyrën e të njomnin me pikla vese. Ai të nxirrte te kapanonet. Para nesh ecnин disa vajza. Kur mbaroi mbledhja, pashë se me to u bashkua edhe Iliriana. Unë desha ta takoja, por ajo nuk më priti, siç bënte gjithnjë. Isha si i hutuar. Ndjeja si nëpër tym të më mundonte një ndjenjë faji. Isha mes shokëve të mi e si i ndarë prej tyre. Ata ecnин të shkujdesur e të qeshur, zërat e tyre përhapeshin mes gjethishteve derisa humbnin thellë në pyll... Ata vazhdonin të ishin siç kishin qenë gjithnjë: të qeshur e të gëzuar, kurse unë... Fare befas, edhe pse midis tyre, e ndjeva veten të vëtmuar, të braktisur. Ndjenja e braktisjes qenka shumë e hidhur,

mendoja. Një si akullimë më vinte nga brenda, edhe pse fytyrën dhe veshët i kisha shpuzë. Unë isha ngritur në mbledhje dhe e kisha thënë mendimin tim. Isha ngritur fill pas Metit. Por pas nesh ishin ngritur të tjerë e shpejt gjithçka që kishim thënë unë e Meti ishte harruar.

U shkëputa nga djemtë e nisa të ecja shtegut të ngushtë, që i binte shkurt për te baraka e Ilirianës. Po s'kisha bërë as dy-tri hapa, kur ndjeva pas vetes zërin e Metit që më thirri. U ndala e u ktheva nga ai. Pështjellimi që më mbante mbërthyer, brenda një grime m'u kthye në inat.

— Ç'do? — e pyeta me zë të fortë.

— Mos u nxeh. Pse nxehesh?

— Kush po nxehet? Të pyeta, ç'do?

— Ç'dua! Hic, thashë ta lëmë për të ikur bashkë, kurse ti... Mirë, mirë.

Ai u kthye e iku. Në djall të vesh, i thashë me vete dhe vazhdova udhën. Ishte çudi vërtet se si prania e Metit po më bënte aq nervoz, thuajse unë nuk kisha shprehur të njëjtën dëshirë për të ikur.

Para se vajzat të shpérndaheshin nëpër barakat e tyre, unë i thirra Ilirianës. Ajo nuk u shkëput menjëherë nga grupi, bëri sikur nuk dëgjoi. Por pas thirrjes së dytë, pak të ashpër e këmbëngulëse, ajo m'u afrua. Në drithën e hënës, që depërtonte me mundim përmes të çarave të reve, fytyra e saj m'u duk e zbehtë dhe e lodhur. Nuk foli: qëndronte para, meje si ai që i ka thënë dhe i ka dëgjuar të tëra. Por unë ç'mund t'i thosha? Përse e kisha thirrur?

— Është vonë, Pandi. Po të jetë se ke diçka... bisedojmë nesër.

— Lira!

— Ik. Ik tani. Natën e mirë!

Unë i kapa dorën. E pashë në sy. Ajo u përpoq t'i shmangej shikimit tim. Në sytë e saj regëtinë ca dritëzime. Ajo ma shkëputi dorën, u kthye e nisi të largohej, në fillim me hapa të ngadaltë e pastaj me vrap.

Era fërshëllente nëpër drurë, drita e hënës u mek e u shndërrua në një mugëtirë të zberdhulët; hapësira sikur ishte mbushur me trishtim.

U ktheva në barakë. Hapësira e mbushur me tym duhani dridhei nga zëra të fortë rinorë, nga të qeshura që shpërthenin për hiçgië. Sa të cuditishme m'u dukën ato të qeshura! Gjithë ajo hare, që mbushte atmosferën rrëth shokëve të mi, tek unë ishte kthyer në pezm.

U shtriva në shtrat ashtu si isha e ndeza një cigare. Pranë më erdhi Leli e pas tii edhe Artani e Berti. Në sytë e tyre unë nashë një keqardhie të përzier me mirësi. dicka të ndritur e përsëri të zymtë, dicka si një shi përmes dritës së diellit.

— Ti kot... — tha Leli. — Kot, për nder.

E kuptova se ç'donte të thoshte, por unë nuk i ktheva përgjigje. Vazhdova të thithja duhanin, sikur aio të ishte gjëja më e rëndësishme atë cast.

— S'na e hape një herë zemrën, Pandi! Ama, shok!... — shfryu Artani.

Këtë radhë e ktheva kokën nga ai, por nuk folia.

— Po qan uzina për ty! — ma këputi Berti.

— Thuai, ore, aë më ka marrë malli për bulevardin, stadiumin dhe... për gjellën e mamasë!

U habita kur dëgjova Lelin të fliste në vendin tim tamam siç do të kisha folur unë:

— Ti, Berti, nuk bën mirë që dyshon në sin-qeritetin e të tjerëve. Pandi e tha para të gjithëve pse do që të ikë.

Mirëpo Berti nisi të queshte e të picërronte systë, ata sytë e tij të mbrojtur nga dy ledhe të dendura vetullash të zeza.

— E, Leli, — tha ai, — e psikologjiske njeriun ti!

— Dëgjo, — m'u drejtua Artani duke më parë në sy, — përse s'mendohesh edhe një herë?...

Shikimi i tij ishte i butë, i ngrohtë, mirëdashës; gjithnjë shikim të tillë kishte Artani. Unë s'fola. Po nga brenda kisha nisur të flisja. E ndieja vreten të prekur vërtet, por s'gieja forca ta ndryshoja vendimin. Sepse ishte i fortë edhe malli për uzinën, repartin. Do të isha i pasigurt të thosha të kundërtën. Pse ta fsheh, më kishte marrë malli edhe për mbrëmjet e bukura të qytetit, për shëtitjet moskokëçarëse mes rrymës së njerëzve, ku gëzimi ndehet tejemanë e sikur të mban pezull. Ja, këto ishin arsyet e mia, shkaktare të vendimit tim, të atij vendimi që ishte pjekur ngadalë e jo brenda një dite. Ndaj dhe i thashë Artanit:

— Jo, Artan. Nuk do të kthej mendje.

*

*

Kishte kaluar mesnata dhe s'kisha gjumë. Kuqisja e erës përijashta ishte e padurueshme. U ngrita, u vesha dhe dola. Era frynte vrunduj-vrunduj. Kli-

thte pylli e vajtonin drurët. Qielli ishte pus, i rën-
duar me re të zeza që sa s'çiknin majat e drurë-
ve; tutje, nga deti, shkrepnin vetëtimat si ca bli-
ce nevrike. Për çudi, bubullima nuk dëgjoheshin.
Lagështia e natës më rrëqethi deri në palcë, ndaj
u futa brenda me të shpejtë, që të ngrohesha në
mbulesa.

Nuk di ç'orë e natës ishte kur fillova të ndieja
një përrua zhurmash që vërshonte drejt meie
me shakullimë: zëra, britma, kujisje ere, bubulli-
ma, goditje të shpeshta të çangës. E përbimi to, si
uturima e detit në furtunë, ngrihej sokëllima e
rrebeshit, shungullonte çatia prej katramaje nga
litarët e shiut.

- Shpejt, shpejt!
- Kazmat! Merrni edhe kazmat!
- Fenerët! Fenerët!

Bëra një përpjekje të fundit pér të hapur qe-
pallat që më rëndonin, por nuk munda. Mes rrë-
mujës së përgjithshme arrita të dëgjoja një fjalë-
këmbim të shpejtë:

- Ta zgjojmë Pandin?
- Lëre. Q'ta zgjojmë kot.

Pastaj nëpër tèrbimin e natyrës, si një jehonë
e shurdhër, arrinte të vinte deri tek unë ndonjë zë
a britmë, që shuhej sakaq nga rrapëllima e erës.

Papritur u shkunda i tëri dhe hova me rrëm-
bim nga dysheku. U vesha e dola me të shpejtë.

Mezi arrija të orientohesha mes perdes së shi-
ut të rrëmbyer e cipës së zezë të natës. Më duhej
të ecja buzë kanaleve e të ndiqja me vëmendje
rrjedhën e ujit. Hidhesha nga një ledh në tjetrin

duke u përpjekur të ruaja ekuilibrin, që të mos rrëzohesha. Errësira i përpinte me kokëfortësi rrezatimet e dobëta, që mund të më orientonin disi. Kanalet e skuadrës sonë ishin të mira se në vazhdimisht kujdeseshim pér t'i mbajtur të pastra, pér t'i thelluar, por ato të parcelës eksperimentalë, që mbaja unë e Iliriana, me siguri që do të ishin bllokuar të gjitha. Vërtet që aty vendi vinte ca i ulët, por kohët e fundit, qysh se më ishte ngritur mendja pér të ikur, unë nuk i kisha kontrolluar. Iliriana shpesh më kishte thënë se ajo vetëm nuk ishte në gjendje t'i mbante si duhej. Ja ku më doli pér hundësh tanë tërë ajo moskokëçarje!

U futa në një kanal të zënë. Uji më erdhi deri në mes e ftohtësia më rrëqethi të tèrin, por shpejt u mësova: me lopatën që rëndohej nga balta u rropata ndonja dhjetë minuta të mira derisa e hapë. Po kështu bëra edhe në nja tri a katër vende. Ndërkohë errësira nisi të hollohej e të diktoheshin format e sendeve. Vetëm tanë fillova të shquaja siluetat e shokëve, zërat e të cilëve i dëgjoja mirë.

Kur shkova pranë Iliranës, vura re se po përpiquej të dilte nga kanali ku ishte fundosur. Me ndihmën e lopatës rrekej t'i jepte trupit përpjetë, por ca nga lodhja e ca ngaqë toka ishte e rrëshqitshme, ajo kthehej e binte përsëri në ujin e turbullt. Unë i zgjata lopatën time. Si doli nga kanali, u ul mbi lëdh e nisi të shtrydhte flokët.

— Si u rrëzove? — pyeta.

— Si! Bëlldum në ujë! Uh, mbarova së ftohti!

Iu ula pranë. Prisja që ajo të më pyeste diçka, po, pér çudi, nuk më pyeti. Thua jse që nga hera

e fundit që ne të dy kishim qenë në atë parselë, s'kishte ndodhur asnje ndryshim!

Shiu e uli dufin, por fëshfërima e tij vazhdonte e pandërprerë nëpër bimëzat e grurit dhe përmes gurgullimës së ujérave që rridhnin. E befas, si një dallgëzim i ngrohtë, nga toka u ngrit një këngë e furishme rinore, e çakorduar disi, por prapë e bukur, një këngë që zgjoi tek unë një zë deri atë kohë të fjetur.

Ajo ktheu kokën andej nga vinin tingujt dhe vështrimet tonë u kryqëzuan. Mua ma përshkoi trupin një drithërimë. Ajo këngë e largët, që vinte nga gjiri i hapësirës, prania e vajzës që dashuroja dhe gëzimi i fshehtë për shpëtimin e grurit, më bënë të ndieja një nyjë të çuditshme në grykë.

Kisha dëshirë të flisja, por më shumë kisha dëshirë të më fliste ajo. Ndoshta fjala do të ma shpërndante atë tronditje që më kishte pushtuar. Vura re edhe sytë e saj të veshur me tisin e një mallëngjimi.

U ngrita. Ajo më zgjati dorën e saj të lagur, të ftohtë. Unë tendosa trupin dhe e ndihmova të ngrihej, por ajo sesi e humbi ekuilibrin dhe do të kishte rënë po të mos e kisha kapur unë fort në mes. Qëndruam ballë njëri-tjetrit duke u parë në sy. Të ndaheshim ishte e pamundur, por edhe të rrnim ashtu, pafundësisht, ishte përsëri e pamundur. Dhe, i nxitur nga një valë e beftë, unë e përfshiva nga krahët pa ua shqitur shikimin syve të saj.

— Pandi, — më pëshpëriti ajo, — pse?

Por e mbyti një si gjyc dhe e la fjalën në mes. Unë iu afrova derisa fryma e saj e ngrohtë më përf-

shkoi faqet. Mbi buzët e saj të lagura mbështeta
të miat. Dhe pastaj, me duart të kapura fort, u ni-
sëm për te shokët.

* * *

Të nesërmen Meti iku. Me llogarinë mbaroi
punë shpejt, por magazinierin nuk e gjeti, megji-
thëse nuk la vend pa e kërkuar. Së fundi m'u lut
mua, që, kur të bëja dorëzimet e mia, të dorëzoja
edhe sendet e tij. Pasi e sigurova se do t'ia kryeja
porosinë, ai më tha ta shoqëroja një copë rrugë.
Unë pranova pa qejf. Ecëm një copë rrugë, më shu-
më në heshtje, deri në të dalë të pyllit.

— Kot që nuk vjen dhe ti tani, — më tha, —
makina ka vend.

— Jo, — i thashë, — e kam lënë për nesër.

— Si të duash. Po mua nuk më durohet sa të
hipi.

Makina u afrua duke përhapur stërkala balte
me rrotat e saj. Meti hipit. Ai më dha dorën dhe u
ndamë. Nuk di pse m'u duk sikur edhe duke zbrir-
tur tatëpjetë ajo po mundohej shumë, sikur po têr-
hiqte një peshë të rëndë.

U ktheva në kapanon me një ndjenjë rëndimi
në shpirt. Shokët, grupe-grupe, luanin domino apo
shah. Ndokush lexonte. Edhe unë u shtriva, me një
libër të lënë përgjysmë në dorë. Pas pak e mylla
librin me forcë, e vura nën jastëk dhe dola jashtë.
Ora po afronte njëmbëdhjetë. Duke ecur ngadalë,
çapita për nga qendra e qytesës.

Pylli shushurinte, i larë e i përtërirë nga shiu. Të dukej çudi se si ky pyll i vogël, tani kaq i qetë e i mbushur me dritë, i nanurisur nga flladet dhe cicërimat e pandërprera të zogjve, një natë më parë kishte uturirë e rrapëllyer si një përbindësh i llahtarshëm! Tani jeta në të gjallonte shtruar, e patrauar. Në drurët e mbushur me pikla të imëta, të ndritshme si lot, buisnin sythat ende të paçelur, gjithë lëng jete, kudo përhapeshin duhmat kundërmuese të humusit, barishteve e kërpudhave të pyllit. Ngado shpërthente gjallimi e mua më dukej se vetëm duart të zgjatja e gjithë ajo freski, njomështi e brishtësi e pranverës së hershme në pyll do të më vërvshonte nëpër damarë e do të çelte tek unë, do të vibronin tingujt e fshehtë... po të mos ishte... po të mos ishte diku brenda meje ai shqetësim që më kujtonte se do të ndahesha nga gjithçka aty.

Kur pashë në derën e magazinës drynin e madh, bëra të ikja, po më ndali zëri i magazinierit. Po të mos më kishte folur vetë, as që do të isha kujtuar se ishte ai, aq i hutuar isha.

- Kishe gjë me mua? — më pyeti.
- Po.
- Do të marrësh gjë?
- Jo, kam për të dorëzuar.
- Aha, po. Meti je ti? Met Hasani?
- Jo, — i thashë unë dhe sepse më kapi inati me atë njeri që s'më kishte asnje faj. Nuk jam Meti.
- Më fal, ashtu kujtova. Se më thanë që më kishte kërkuar. Nejse, ti ç'do të dorëzosh?

I thashë se kisha për të dorëzuar plaçkat e Me-

tit. Në fund shtova se pasdite mund të dorëzoja edhe unë të miat, po mund që t'a dorëzoja edhe të nesërmen.

Ajo mbrëmje m'u duk vërtet e çuditshme. Gjallëria e përshkonte qytezën tejembanë, përhapeshin zëra, gumëzhima, të qeshura, tinguj muzike nga altoparlanti i fshehir mes degëve. Gjallëria e përnatshme, por e mbushur me diçka të re, që unë s'e kisha vënë re kurrë më parë. Vallë më dukej kështu pse ishte nata e fundit që unë kaloja aty? Isha kudo e asgjékund, isha në mes të realitetit të njohur e përsëri si në tym; bisedat që më kapte veshi, të qeshurat, shakatë e këngët e gjithshka njerëzore më dukeshin çuditërisht edhe të afërtë e intime, edhe të huaja.

Leli dhe Artani më dolën përpara. Unë s'kisha nga ia mbaja.

— Me ç'duket puna, s'po të iket, — tha Artani i qeshur.

— Më iket, s'më iket, mori fund ajo, — i tha shë.

Ai më tërhoqi lehtë nga krahu dhe u ulëm në stolin me dërrasa të pazdruguara rrëzë një plepi.

— Edhe pse s'ka asgjë të parregullt, — tha Leli, — vrapë s'na vjen mirë.

— Të gjitha këto i kemi thënë, Leli. S'ka kuptim...

— Jo, — tha ai, — ka. Erdhëm bashkë, pse të

mos ikim bashkë? Po sikur të bënimi të gjithë si ti e Meti?

Në zërin e tij kishte qortim, këshillë, keqardhje prej shoku. Unë heshta.

— Sidoqoftë këtë kohë këtu ne s'kemi për ta gjetur më, — tha Artani dhe u ngrit. — Po vjen me ne?

Edhe unë e Leli u ngritëm.

— Jo, Artan, — i thashë unë, — desha të takoja pak Ilirianën.

Qortimi i tyre i butë përsëri më preku. Qeshë gati të thosha: «po kthej mendje, më duket», por s'di ç'më mbajti e s'e thashë.

Ajo doli nga mensa me dy shoqe e, kur më pa, m'u afrova menjëherë. E ndjeva veten më të lehtë. Edhe herë të tjera kisha vënë re se prania e saj u jepte ton tjetër gjendjes sime shpirtërore e mendimeve. Ndjeva kënaqësi kur pashë ftyrën e saj të ëmbël, të hijeshuar nga një buzëqeshje e lehtë, gati e padukshme. Kur u afrova edhe më, vura re mirë se ajo ishte një buzëqeshje ngjyer me trishtim. Befas ndjeva mall për buzëqeshjen e saj të gëzuar. Kur vallë do ta shihja edhe një herë atë të shpërthente e plotë si zambaku i majit?

— Po të kërkoja, — i thashë.

— E di, por nuk e kuptoj pse.

— Si pse? Nesër do të iki.

— Edhe këtë e di. Po ti për këtë qenke kaq i
gëzuar?

— Nuk jam i gëzuar. Kush tha se jam?

— Qysh? Të të realizohet një dëshirë e të mos
jesh i gëzuar?!

Ajo lëvizi supet dhe ktheu kokën mënjanë. M'u
duk e zemëruar ngaqë mendonte se nuk po trego-
hesha i singertë. Unë mbeta ngushtë.

— Ja që vërtet nuk jam i gëzuar, Iliriana.

— Nuk e besoi. Nuk ka arsyё të mos jesh.

Unë përsëri nuk dita ç't'i thosha. Si u mendova
pak, vazhdova:

— Bëjmë një shëtitje, Iliriana.

Ajo ktheu kokën me vrull nga unë.

— Pandi... Ti nuk duhet të ikësh!...

Asaj iu drodhën qerpikët dhe cepat e buzëve
ia përshkoi një ngërç i lehtë.

Unë e kapa për dore.

— Eja të shetitim, — i thashë përsëri, por ulët,
si me pëshpërimë.

— Jo, tha ajo, — ja, rrimë këtu. Nuk kam qejf
për shëtitje.

— Shëtitim dhe bisedojmë, — i thashë.

— Të bisedojmë? — Jo, nuk dua!

E pashë se po e mbyste hidhërimi. Dukej she-
shit se ajo bënte përpiekje të jashtëzakonshme për
ta mbajtur veten që të mos ia plaste të qarit. Qën-
droja para saj i turbulluar e gojëkyçur, tamam si
guhak. Ajo e vuri re çoroditjen time. Dhe nisi të
fliste vetë:

— Gjithë kjo që ke menduar, Pandi, është bu-
dallallëk. Unë nuk dua aë ti të ikësh, kupton? Edhe
të tjerët, shokët e tu e të mitë, nuk duan.

— E di, — i thashë në tym.

— Të gjithë mbajnë në gojë ikjen e Metit. Nësër edhe... tënden.

Shihja vetëm buzët e saj që lëviznin dhe sytë që i reflektorin shqetësimet e brendshme. Kishët një përkim të çuditshëm midis buzëve e syve; atë që nuk arrinin dot ta shprehni buzët e shprehni sytë.

Unë e kapa nga dora dhe e tërhoqa lehtë. Në kundërshtim nga c'prisja, ajo u bind lehtë, si fëmijë, ndonëse një shprehje acarimi i mbeti ende në fytyrë.

E kaluam fushën e basketballit, rrrethuar e tëra me radhë lastarësh të rinj, dhe u hodhëm në një shteg midis kaçubave e lianeve të dendura, të pyllit. Që aty dolëm në një rrëth të gjerë, plot bar të gjatë, ku shpesh ditën uleshim pér të bise-duar e ëndërruar. Nata në pyll i shpërfytyronte pamjet e ditës, shpërthente përmasat, dhe çdo bisk e lastar, trung e kurorë tanë merrte një pamje të mistershme, pafundësisht të ndryshueshme e të tjetërsuar, aq sa në çdo hap të dukej sikur nuk kishe shkelur kurrë në ato anë. Ne qëndruam pranë trungut të një vidhi të ri, e degëzat e tij të ulura, të njoma nga vesa, u drodhën lehtë. U ktheva nga Iliriana dhe në dritën e paktë, që depërtonte nga lart, me mundim u përpoqa ta shihja në sy. Dukej që priste të flisja unë.

I vura dorën nën mjekër dhe ia ngrita fytyrën ngadalë. Ajo bëri ta largonte, por butë, fare butë. Gjethet fëshfërinë e mbi faqe e flokë na ranë pikla vese.

→ Ikim, — tha ngadalë. — Ikim se u bë vonë.

Te lirishta pérpara barakës së saj u ndamë. U ndamë thjesht, qetë, pa fjalë. Nuk vrapoi, siç bënte zakonisht kur ndaheshim, por vazhdoi të e cte ngadalë e kokulur. Kishte diçka mallëngjyese në atë të ecurën e saj të njëtrajtëshme si të zvarritur.

Të nesërmen e ndjeva tërë rrëmujën dhe zallahinë e mëngjesit, por nuk u çova menjëherë. Tërë natën isha përpjekur e rrotulluar nëpër shtrat, i munduar nga ca ëndrra të çuditshme e të ngatërruara. Zgjohesha e flija e përsëri zgjohesha nga shqetësimi i vendimit të ri: vendosa të qëndroja.

Kur dola të merrja prashajkën, të gjithë kishin ikur, por zërat e tyre ende dëgjoheshin. Hodha systë nga pylli, nuk kisha të ngopur me atë hapësirë të gjelbëruar të qëndisur nga një mijegull e bardhë si lëpe velloje, të mbushur plot me prarimet e para të diellit mëngjesor. Ecja mes asaj hapësire dhe freskia e mëngjesit më mbushte të terin. Ishte një mëngjes gjithë bardhësi e dritë dhe unë ndihesha çuditërisht i lehtë e i gëzuar. Përfytyroja buzëqeshjet në fytyrat e shokëve dhe shoqeve, e kraharoni më zgjerohej, më bëhej njësh me ato hapësira, më dukej sikur gjiththçka shtrihej në një thirrje të përbashkët: në thirrjen e gjelbërimit.

Marti dhe xha Mihali

Saluatori i vjetër Mihal po i afrohej moshës së pensionit, po duart nuk i dridheshin. I kishte eshtake, me gishtérinj të gjatë, të hollë, tepér të ndjeshëm e të sigurt në lëvizjen e tyre. Systë xha Mihali nuk i kishte të fortë si më parë, kishin filluar t'i visheshin me një perde të hollë që ia pengonte deri-diku qartësinë e shikimit, por gishtat, ama, sado që vitet kalonin, ishin po ata që kishin qenë: shtojcë besnike e syve. Duke rrëshqitur lehtë e butë mbi tegelin e ashpër, ato mollëza të rreshkura dinin të lexonin më mirë se systë.

Xha Mihali ishte mjeshtër në zanatin e tij, por ai punonte bukur edhe në torno e frezë dhe ishte axhustator po aq i mirë. Por saldimin, ama, nuk e ndërronte me asnje lloj pune. Kishte qenë pesëmbëdhjetëvjeçar kur kishte kapur pincën për herë të parë. I ati mezi e kishte rregulluar në punë në një shoqëri italiane që merrej me shtrrim rrugësh e ndërtimë urash. Por ato kohëra të hidhura xha Mihali nuk kishte qejf t'i kujtonte.

Ishte fjalëpak, me një dritë të qetë e të vazhdu-

eshme, në sy, një dritë të ngrohtë dhe të paqtë, që i buronte nga thellësia e shpirtit. Nuk nxehet e nuk e ngrinte zérin kurrë e askush nuk e kishte dëgjuar ndonjëherë të lëshonte nga goja ndonjë fjalë fyeze. Të gjithë e donin dhe e respektonin. Edhe kur xha Mihali nuk ndodhetë në repart, punëtorëve u dukej sikur e kishin përpara syve.

Një ditë dhjetori, ndërsa hoqi maskën dhe ka-loi gishtërinjtë e tij të thatë e të ashpëruar mbi te-gelin ende të nxehetë, xha Mihali pa të vinte Saliu, sekretari i partisë i ndërmarrjes. Në fillim kujtoi se Saliut i kishte rënë rruga andej, por, kur vu-rë re që po i afrohej, xha Mihali la pincën dhe u ngrit në këmbë. Ai e donte Saliun se ishte njeri i drejtë, i arsyeshëm e i talentuar.

— Puna mbarë, usta Mihal!

Xha Mihali ia ktheu përshëndetjen duke i he-dhur një shikim disi kureshtar me ata sytë e tij ngjyrë hiri. Vetëm pasi këmbeu me ustanë e vietër ca fjalë për gjëra të përgjithshme, nisi bisedën për të cilën kishte ardhur.

— Do të të ngarkojmë me një detyrë, xha Mihal.

— Urdhëro, o Sali.

Saliu mori nga rafti aty pranë një copë letër zumparaje dhe nisi ta përsillte nëpër gishta.

— Puna është se... ti e di, në repartin tonë kemi një djalë të ri, që na është bërë problem. E kam fjalën për atë, Martin...

Kur dëgjoi këtë emër xha Mihali u ngrys.

— Soj-soj e kemi kthyer me të, xha Mihal, po prapë s'na ka dalë gjë. Nuk vjen kurrë në orën shtatë të mëngjesit dhe nuk ngulet në punë. Kështu

që themi... ta marrësh ti e ta mbash pranë. Vetëm ta mbash pranë.

Xha Mihali vetëm e shihte Saliun dhe mendohet. Propozimi i erdhë fare i papritur. Kishte dëgjuar të flitej shumë për atë djalë. E njihte dhe si fytyrë. Thoshin që kishte bërë një vit gjimnaz dhe e kishte lënë shkollën. Më pas kishte ndërruar dy a tri ndërmarrje. Së fundi, një vit më parë, kishte ardhur tek ata. Por, me ç'kishte dëgjuar, ai çunak gjashtëmbëdhjetë - shtatëmbëdhjetëvjeçar jo vetëm që nuk kishte filluar t'i hynte ndonjë zanati, po tërë vitin nuk kishte zënë punë me dorë. Të rinxjtë e këshillonin, e kritikonin, i vinin fletërrufe, mirëpo ai i tillë vazhdonte të mbetej. Për ditë të tëra nuk dukej në punë. Pastaj papritur ia beftë përsëri dhe ia fillonte avazit: bridhite nga një repart në tjetrin, ndalonte herë te njëri e herë te tjetri, bënte shakara, qyfyre e nuk shkulej derisa ta përzinin. Ja, ky ishte nxënësi që donin t'i jepnin.

— C'thua, usta Mihal?

Xha Mihali mendohet.

— Ti je komunist i vjetër, usta Mihal, dhe... të takon ta shikosh këtë edhe si detyrë Partie.

Xha Mihali u shkund. Pas supit të Saliut vinçi-urë po ngrinte një shasi traktori. Befas zhurma e uzinës, ajo gumëzhimë e pandërprerë, e copëtuar në qindra zhurma, që shtyheshin e kacafyteshin me njëra-tjetrën kush e kush të dilte mbi shoqet, ajo rrapiellimë e vazduar tingujsh që herë-herë dridhëtë xhamat, u përbloqet në një uturimë të vetme, u ngjesh e buçiti fare pranë veshëve të xha Mihalit. Ajo zhurmë kishte, zënë përherë, por tanë xha Mihali e dëgjoi shumë qartë. Dhe ajo sikur e

— Falemnderit, kam paketën time. — Dhe nga xhepi i xhakavendos nxori një paketë «DS».

— Hajde, ndize. Apo s'i begenis këto.

— Jo, ç'të kem pi unë.

Ndezën cigaret. Sytë e Martinit përsëri filluan të lëviznin sa andej-këtej; dukej sikur nga çasti në çast priste të vinte dikush.

— Ç'njerëz ke në shtëpi?

— Gjyshen, prindërit dhe dy motra.

— Ç'thuas, të pëlqen zanati i saldatorit?

Marti nuk u përgjigj, por bëri një gjest që do të thoshte: «çka». Atë kohë se nga ia behën nja dy djem pak më të rritur se Marti. Njëri ishte i gjatë, i thatë, veshur me një kostum doku tepër të përdorur, kurse tjetri, i shkurtër, me një xhatetë stofi të leshtë, me kuti. Kur i pa, Marti ktheu kokën mënjanë dhe lëshoi një shtëllungë tym duhani. Duket se nuk i pëlqeu ardhja e tyre.

— Puna mbarë, xha Mihal, — foli i gjati. — Vjmë nga organizata e rinisë e repartit. Me siguri që shoku Sali ju foli si është puna e Martit. Erdhëm t'ju themi, xha Mihal, se pér çdo gjë që mund t'ju dalë...do të na kini edhe ne pér ndihmë.

— Mirë, o djem, mirë.

— A nuk na lini rehat, more shpirt?

Këtë radhë foli Marti. Zëri i doli i tendosur dhe pak si i çjerrë, kurse në sy iu ndezën shkëndijat e zemërimit e të sfidës.

— Ç'i qepeni njeriut kështu?

— Mos na keqkupto, Marti, — ia ktheu djali i gjatë.

— Vijnë si shokë ata, or djalë, — e qortoi xha Mihali Martin.

Djemtë u larguan.

— Shokët e mi! — foli si nëpër dhëmbë Marti.

— Po, o djalë. Është gjë e madhe shoku. Dëgjo të të tregoj q'më ka ndodhur njëherë...

Po xha Mihali ende nuk kishte filluar ta tregon-te atë që kishte ndër mend, kur Marti brofi në këm-bë, flaku bishtin e cigares dhe tha prerë:

— Më mirë i lëmë për një herë tjetër historitë, usta. Të gjithë historira kanë qejf të më tregojnë.

Dhe u nis me hapa të shpejtë nëpër korridorin që formohej midis shasive të traktorëve, që prisnin të riparoheshin. Xha Mihali e ndoqi me sy dhe tundi kokën. U ngrit, mori në njérën dorë pincën, në tjet-rën maskën dhe hodhi përsëri vështrimin andej nga u largua Marti, që po qeshte me të madhe me diçka që i tregonë një djalë tjetër moshatar.

Punoi ndonjë gjysmë ore, por duart nuk i bë-nin. Një dyshim i hidhur zuri ta mundonte ustanë e vjetër: mos ishte nxituar kur pranoi ta mbante djalin?

Pas ndonjë ore Marti u kthye. Dukej i qeshur e i gëzuar, thuajse nuk kishte qenë ai që kishte i kur gjithë turinj pak më parë. Xha Mihali nuhati erë alkooli, por nuk i tha gjë. Ama përbrenda u ndez. Ende spurdhjak ai e kthente gota! Dhe brenda orarit të punës! Për xha Mihalin orët e punës do të thosh-in vetëm punë, asgjë tjetër. Ajo ishte e shenjtë. Po e lë kësaj rradhe, mendoi. Do të vijë dita t'ia them edhe këtë.

— Usta Mihal, — i foli Marti duke e vështruar me ata sytë e tij bojë qelli, gati fëmijnorë, — a më jep leje? Kështu më doli një punë.

Xha Mihali e humbi fare. Shkoi tek arka dhe bëri sikur kërkonte në të ndonjë vegël. Por duart, që gjatë punës nuk e humbisnin kurrë sigurinë e tyre, nisen t'i dridheshin. Marti po priste. Xha Mihali u kthyesh nga ai dhe i tha:

— Ora tani është dymbëdhjetë e gjysmë, kemi pushimin e drekës. Përse më kërkon leje?

— O, atë e di unë. Kur them për leje, domethënë se dua të iki fare.

Ustai ngriti sytë. Një mendim i qartë dhe i thjeshtë i rrëzelleu në tru.

— Mirë, ik. Nesër në ç'orë do të vish?

— Në ç'orë? Dihet ajo, në shtatë.

— Jo. Nuk të dua në shtatë, po në orën tetë. Dakord?

Marti e pa i hutuar.

— Si? Po pse në tetë?

— Kështu them unë. Se kur duhet ta fillosh ti punën, e kam unë në dorë. Nuk do ti të vish në tetë?

— S'dua! — tha Marti. — Si nuk dashkam?

— Ama, kur them në tetë, në tetë fiks. Dhe do të ikësh... — u mendua një hop ustai, — në orën dy e gjysmë. Dakord?

Mirëpo Martit i ra entuziazmi menjëherë. Si u mendua pak, i tha me një zë fare të qetë:

— E di ç'bëjmë, usta? Sa për në shtatë, në shtatë vij unë, s'e kam për gjë, por, po deshe atë orën falëma në fund. Domethënë të iki më përpara.

Xha Mihali hapi sytë.

— Kush tha se po të fal një orë?!

Ishte radha e Martit tani të habitej.

— Po ti...vetë the të vij në tetë!

— Po, thashë. Po unë, or djalë, nuk po të fal as orë, as minutë. Ti do të rrish në punë gjashtë orë, aq sa është rregulli.

Marti nuk ia ndante sytë fytyrës së ustait.

— A, gjashtë! Po kjo është mrekulli! Selimi më mbante plot tetë orë...

— Gabim ka bërë, tha xha Mihali. — Do ta bisedoj me të, pse e ka shkelur rregullin?

Marti ndenji edhe një grimë pa folur e pastaj, pa e përshëndetur, u largua.

Në mensë xha Mihali zgjodhi tryezën e fundit. Nuk kishte dëshirë të bisedonte me njeri.

— Të qenkan mybutur gjemitë, usta Mihal!

Ai që foli ishte Hekurani, një tornitor i bëshëm, flokëdrudhë e zeshkan. Ai vendosi pjatat me gjellë në tryezë dhe u ul.

— E mora vesh, e mora, — vazhdoi ai. — Dhe më erdhi keq, të them të drejtën. Ku vajtën e i rannë më qafë xha Mihalit, thashë me vete. Se ai djalë, ohu, do kohë të bëhet njeri, nëse do të bëhet ndonjë ditë. Ta dish ti, xha Mihal, ç'kam hequr unë me të! Se mua ma rrasën në fillim. Merre të mësojë tornon, më thanë. E po mirë, se kush e njihet. Ai sapo kishte ardhur. Po ç'hoqa më pas, se! Më thyente thikat, më prishte detalet, më fuste në ngatërresa... S'kisha hallin e planit, për nder të them, po me atë të vinte festia vërdallë. Kush nuk më kapte. Marti bëri kështu, Marti bëri ashtu. Një ditë nuk durova më dhe ia përplasa brigadierit, Tomit. Mor vëlla i dashur, i thashë, mos e kam djalë unë atë, apo si? Pula s'kam e hish bëj! Vajta dhe te Saliu e i

thashë: ma hiqni, o xhan i vëllait, dhe më lini të marr frymë! Ja, kështu.

Xha Mihali kishte mbaruar së ngrëni. Ai drodhi një cigare dhe e ndezi.

— Po nuk duket të jetë dhe aq i keq, o Hekuran.

— Hë-hë. Ditët e para ashtu thashë edhe unë. Po ti, po më dëgjove mua, shko thuaji Saliut sa s'është vonë. Le të merret ndonjë tjetër me të, thuaji. Se edhe moshën s'e ke.

Xha Mihali nuk po e dëgjonte më. Nuk donte ta dëgjonte. Se ato që po i thoshte tjetri ia kishte thënë e stérthënë edhe ai vetes. Po jo, nuk do të bënte ashtu. Nuk do të bënte. Të têrhiqeshe ishte gjëja më e lehti, por më e lehta nuk është gjithnjë më e mira. Ai u ngrit, pëershëndeti Hekuranin dhe shkoi të pinte një kafe. Kishte edhe dhjetë minutë kohë derisa të fillonte punën.



Të nesërmen Marti erdhi në orën tetë e shtatë minuta. Xha Mihali nuk e pa orën, po djali e ndjeu se ai e dinte mirë se sa minuta ishte vonuar.

— Nuk prisja ta shkelje që ditën e parë, o djalë.

— Nuk doja. Më vonoi autobusi.

— Nesër nisu më herët.

— Edhe sot herët u nisa, po ja, ndodhi.

— Thashë: nesër të nisesh më herët se sot!

Zëri i ustait për herë të parë djalit iu duk tepër i rreptë.

— Mirë.

Ustai i vjetër e vështroi në mënyrë hetuese. Marti ishte skuqur në fytyrë dhe merrte fryshtë duke dihatur. Siç dukej rrugën nga stacioni deri në uzinë e kishte bërë me vrap. Në shprehjen e fytyrës xha Mihali vuri re një si turbullim, që nuk arriti ta kuptonte nëse vinte nga pendesa që djali kishte shkelur fjalën e dhënë apo nga gëzimi, të cilin pa dyshim përpinqej ta fshihte, që puna nuk përfundoi aq keq sa c'e kishte pritur. Por shprehjen e rreptësisë xha Mihali nuk e hoqi nga fytyra as kur i tha atë që djali s'e priste:

- Ulu aty e çlodhu. Ose ik, bëj një shëtitje, pastaj fillojmë.
- Pse, s'duhem unë tani?
- Mos më bëj pyetje, po bëj ashtu si të thashë.
- Të shkoj deri te një shok? Sa vajta, erdha.
- Sa do të rrish?
- Po...dhjetë minuta.
- Tek ai mos rri shumë, se do ta pengosh në punë.
- Mirë, xha Mihal.

Dhe u bë erë. Xha Mihali e ndoqi me sy. Pastaj, me një shprehje të menduar në fytyrë, mori dy hekura jashtë përdorimit që i kishte hequr mënjanë për t'i mësuar saldimin çunit dhe i vuri mbi tryezën e punës. Në të vërtetë ishte i shqetësuar pakëz. Mos kishte bërë gabim me atë lëshim?

Pas njëzet minutash plot Marti u kthye. Xha Mihali ndieu një lehtësim të madh. Ndoshta nuk kishte bërë gabim për lëshimin. Në fund të fundit ai s'kishte bërë ndonjë lëshim, gjithnjë kishte vepruar brenda rregullit. Së pari donte ta mësonte atë të mbante fjalën. Një njeri që mësohet të mbajë fjalën,

nuk éshtë kurrë bosh, mendoi. Dhe pér herë të parë që nga dita e djeshme ustai sikur u lehtësua. Nga ai mund të presësh edhe gjëra të mira, mendoi. Dihet, jo që në fillim. Por që këtu duhet filluar: që ai të mësohet të mbajë fjalën. Ky éshtë tabani mbi të cilin duhet ndërtuar e ndërtuar... Ja, pra, nga duhej filluar: nga sedra e djalit. Nuk qenka e vërtetë që ai éshtë fare pa gjë, fare pa vlerë, siç më tha Hekurani...

Ustait të vjetër iu kthye gjallëria e mëparshme. Sendet pérreth, gjithë ato hekura, gjithë ato vegla e pajisje, pjesët e këputura apo të sharruara që duheshin ngjitur, gjithë ajo masë e pérhimët, e ndryshkur, gjithçka që i zinte syri, papritur u vesh me një dritë të ngrohtë. Edhe zhurmat e pandërprera, gjithë ato zukama, goditje e tinguj të pérzier sikur u kthyen në një ritëm të ëmbël e ledhatues pér veshin, sikur bashkë me atë rrapëllimën e tyre pérçonin edhe kuptimin e fshehtë se ato janë nën pushtetin e njeriut, se éshtë forca e tij ajo që i zotëron. Po, po. Me atë djalë ai do të merrej vesh. Duhej të merrej vesh.

Dhe nisi t'i shpjegonte. Thjesht, shtruar, pa u ngutur. Fliste dhe e shikonte djalin në sy. Dhe nëpërmjet syve ai kërkonte të gjente reagimin që mund të shkaktonin fjalët e tij. I shpjegoi pér një copë herë, jo dhe aq të gjatë sa ta mërziste, pastaj i dha veglat në dorë. Në fytyrën e djalit u vizatua një buzëqeshje e largët, disi tallëse, si e harruar aty qëkur. E megjithatë prapa asaj buzëqeshjeje ustai i vjetër dalloi një tronditje të lehtë, njëfarë trazimi që dali përpiqej ta fshihte. Jo dhe aq keq, mendoi xha Mihali. Kishte pritur që dali të tregohej shu-

Kaluan dy javë. Për Martin orët e punës ishin të njëllojta, të mbushura me shkëndija, me njollën e flakëruar të saldimit dhe me ndryshkun e heku-rave. Ai vinte çdo ditë në orën tetë dhe ikte në dy e gjysmë. Një herë, teksha bëhej gati të ikte, ia behu aty Saliu.

— Ku shkon ky? — pyeti ai xha Mihalin.

— Në shtëpi, — u përgjigj ustai, — ku tjetër? Marti rrinte e dëgjonte.

— I bëri gjashtë orë punë?

— Ik ti, ik, — i tha Mihali Martit dhe, si iku djali, u kthye nga Saliu. — Dëgjo, o Sali. I kërkojmë ne këtij të jetë në rregull me ne? I kërkojmë. Por ama edhe ne duhet të jemi në rregull me të. Sahatin unë s'ia vura në i bëri plot gjashtë orë punë apo jo, ama gjashtë orë këtu ka qenë, tek unë.

— Vëre të djersijë, xha Mihal!

— E di unë atë, e di.

Saliu iku dhe xha Mihali e kuptoi se nuk iku shumë i kënaqur. Megjithatë ishte i qetë; njëfarë ndjesie e brendshme i thoshte se nuk ishte në udhë pa krye me atë djalë.

Ato dy javë rrohdhën të qeta, pa ndonjë ngjarje të veçantë, po të mos quaje të tilla, natyrish, vonesat e bredhjet e Martit nëpër uzinë, vajtjen te njëri e te tjetri për pak «variacion», siç thoshte ai.

Por një ditë ai e zgjati aq shumë pushimin, saqë xha Mihali u shqetësua. Kishte ikur aty nga ora nëntë e gjysmë dhe në dymbëdhjetë ende nuk qe kthyer. U duk vetëm disa minuta përpëra se të fi-

llonte pushimi i drekës. Ishte aq i qeshur e i gjëzuar, sa thoshe se nuk e ndiente veten fajtor për asgjë. Bashkë me të ishte dhe një djalë tjeter, që kishte veshur një xhup dhe një shall gjithë ngjyra rreth qafës. Edhe ai, ashtu si Marti, qeshte kot së koti, duke zbuluar një palë dhëmbë të bukur, si rruaza, që i spikatnin në fytyrën e zeshkët. Djemtë qëndruan rreth katër-pesë hapa larg ustait dhe përpinqeshin të mbanin të qeshurën, që s'donte e s'donte t'u shqitej.

Me të ndier praninë e tyre, xha Mihali ngriti kokën nga hekurat që po stivoste.

— Ç'është?

Ishte i ngrysur. Djemtë iu afroan.

— Puna është se... po deshe, xha Mihal, falja Martit.

Dhe duke kujtar se xha Mihali nuk do ta pikaste, i shkeli syrin shokut. E papritur që të dy nisen të qeshnin me gulçime, si dy budallenj.

Xha Mihali donte të thoshte diçka, po fjalët se ku i ngecnin e s'po i dilnin. Nga shikimi i vrenjtur dhe nofullat e mbërthyera Marti e mori me med se ustai ishte nxehur.

— Pse s'flet? Nga humbe?!

— Ja, andej...

— Afrohu këtu. Hajde, hajde!

Marti nuk lëvizi nga vendi.

— Qasu, more, të thonë!...

Shoku e shtyu me bërryl. Marti hodhi ca hapa të druajtur dhe u gjend ballë ustait. Xha Mihali i afroi hundën te goja.

— Paske pirë?!

— Jo, xha Mihal...

— Turp! Turp! Dhe në orar të punës!

Xha Mihali e ndjeu se, po të vazhdonte të fliste ende, do t'i merrej goja, ndaj pushoi. Kur nxehej, gjë që i ndodhë rrallë, ai thoshte vetëm dy fjalë, kurse tani foli shumë. Ia kishte falur disa herë; tani duhej t'ia tregonte vendin mirë.

— Nuk desha, xha Mihal, po ja, ashtu ndodhi.

— Ik, djalë, ik. Shko në shtëpi!

— Falja, xha Mihal, — ndërhyri djali tjetër.

— Ik, more, ti! — iu hakërrye atij xha Mihali.

— Ç'do ti këtu?

— Po... ne jemi shokë, xha Mihal.

— A, e paske tërhequr ti nga hunda! Turp të kesh edhe ti! Hajde, thyej qafën!

Djaloshit iu shua përfundimisht buzëqeshja. Vendin e saj tani e zuri një seriozitet i ngathët dhe njëfarë pasigurie.

— Dhe sa për sot, — vazhdoi xha Mihali pa e parë Martin në sy, — nuk të njihet asnje orë punë.

Marti e shikonte i shtangur. Nuk i bëri aq shumë përshtypje vendimi i ustait sesa tërë ajo ash-përsi që papritur gjeti tek ai. Me mospërfillje i tha:

— Punë e madhe!

U kthye, kapi zeshkanin nga bërryli dhe ikën të dy. Xha Mihali i ndoqi një copë herë me sy. Pastaj u kujtua se diçka kishte lënë përgjysmë. Bëri të vendoste hekurat në pozicionin e saldimi, por duart nuk i bindeshin. Ç'do të bëj me të, mendoi, ç'do të bëj?

Të nesërmen xha Mihali pothuaj nuk i foli fare me gojë. Martit i vinte habi. Mbaroi një punë të lënë përgjysmë dhe e pyeti ustanë se ç'duhej të bënte tjetër. Xha Mihali i tha shkurt «Hëpërhë asgjë» dhe vazhdoi punën. Marti qëndroi në mëdyshtje, të rrinte aty apo të ikte? Ustai ishte i zemëruar dhe ai mund të ikte, se, si i thonë, «rroftë sebepi», madje ishte i sigurt se, kur të kthehej, ustai s'kishte për ta qortuar fare. Mirëpo, për çudi, ndryshe nga herët e tjera, mendimi se mund të ikte nuk e gëzoi. Madje ndiente njëfarë shqetësimi që xha Mihali as po ia hidhte sytë, as po çante kokën të dinte nëse ishte ai aty apo jo. Të paktën të më bërtasë ose të më shajë, thoshte me vete. Kjo heshtje kështu... qenka punë dreqi.

— Usta, të rri apo të lëviz pak?

Asnjë përgjigje.

— Usta, unë të pyeta...

— Bëj si të kesh qejf, or djali.

C'inat të thellë që paska! tha Marti me vete dhe përsëri ndjeu atë sëmbimin shqetësues. Fundja po rri e po e shikoj si punon, i dha karar me vete Marti dhe u ul në një arkë aty pranë. Xha Mihali i hodhi një shikim me bisht të syrit, po nuk e prishi terezinë. Në të vërtetë i erdhi mirë që djali qëndroi. «Pas pak do t'i flas», mendoi. «Nuk është mirë të mendoj se ka gabuar aq rëndë sa nuk mund t'ia fal.»

Marti nxori paketën e ndezi një cigare. Ndërkohë mendohej t'i zgjaste edhe ustait një. Po që se ia merrte, kjo do të thoshte se ishte zbutur. Mirë, por po sikur të mos ia merrte?

Ndërkohë dëgjoi një zë të hollë vajze që thi-

rri: «gjyshi!». Marti ktheu kokën. Ishte një vajzë rrëth dymbëdhjetë vjeçë, e zeshkët, me flokë të shkurtër e të drejtë dhe me shall pionieri në qafë. Vajza shkoi me vrap te xha Mihali dhe iu hodh në qafë. Në dorë mbante një libër.

— Linda, moj gocë e gjyshit! Ç'dole këtej?

— Ka dërguar letër Koçi, gjyshi. Ja.

Ajo nxori një zarf nga libri dhe ia dha. Xha Mihali u ul mbi një arkë dhe vuri syzet. Linda hodhi shikimin nga Marti.

— Ii, pi duhan, — i tha ajo. — Pse pi duhan? Marti s'ia vari.

— Gjyshi, — e pyeti ajo xha Mihalin, — ky është ai djali?

Po xha Mihali s'e kishte mendjen ç'i thoshte vajza; ai lexonte e herë-herë vinte buzën në gaz. Linda shkoi pranë Martit.

— Bëj një çikë më tutje, — i tha.

Marti i lëshoi vend dhe ajo iu ul pranë. Ndërkohë Marti lexoi titullin e librit «Lulja mbi shkëmb». E paska qejf leximin, mendoi dhe sepse ndjeu kënaqësi. Ai vetë lexonte shumë pak, po, kur e zinte një libër, s'e lëshonte më nga dora derisa ta mbaronte.

Vajza përpinqej ta shikonte në sy.

— Marti të quajnë ty? — e pyeti.

— Po.

— Gjyshi na ka folur pér ty. Në shtëpi.

— Ah! Ç'ju ka thënë?

— Pse ta them? Pyete vetë po deshe. Ja ku e ke.

— Punë e madhe që s'ma thua! Po pér të pyetur s'e pyes, ta dish.

— Qerratai... — pëshpëriti xha Mihali dhe fytyra i qeshi e tëra.

Linda i ngjiti gojën Martit te veshi dhe i tha me zë të ulët:

— E di ç'ka thënë? Që je tamam si Koçi...

Marti për herë të parë u kthyte i téri nga ajo.

— Kush është ky Koçi?

— Xhaxhai, pra, që punon në Koman. E di ti ç'punë bën ai? Tunele. Shpon tunele.

— Ehë. Domethënë... unë qenkam si ai. Dhe ai, nga ana tjetër, qënka si unë. — Marti qeshi lehtë.

— Si ka mundësi?

— Po kështu thotë gjyshi! — theksoi vajza.

Marti u nxeh.

— Ç'flet ti, moj? Për xhaxhanë, që s'punon, thotë ai?

Vajza ia plasi gazit. Xha Mihali ngriti sytë mbi syze dhe e vështroi.

— Ua! Po ai as për njërin nga ju nuk thotë ashtu...

— Dëgjoni. Dëgjoje, o Martin, dëgioje. — (Xha Mihali nganjëherë ashtu i thërriste, Martin.) Ai kroi zërin e nisi të lexonte: *Die bëmë plasien më të madhe që ka parë historia te ne. Tërmët, o baba, e çfarë tërmëti!* *Gjëmim më të fortë s'kisha dëgjuar kurrë.* Nga qelli binin aurë të mëdhenj, tamam si në përrallë. *Le pastaj pluhuri, që u narit mbi malet e u deshën nja du a tri orë të pastrohej.* Ishte një pamje që ç'të të them, as në ëndërr nuk e sheh njeriu. E morën edhe në film.

— E pamë në televizor, — tha Marti.

— Mirë, po tjetër është kur e sheh të gjallë. Koçin e kam minator, Martin. Është më i vogël

se i ati i kësaj. Në fillim s'donte të punonte në minierë. Po ja, i hyri në qejf. I thanë pér në Komani, shkoi. Kemi nevojë pér ty atje, i thanë. Shkoi, nuk e bëri dy. Le të rrijë ca vjet atje, i ri është.

Xha Mihali u ngrit, futi letrën në zarf dhe e la në një nga raftet e murit. Linda iu afrua dhe e pyeti:

— Gjyshi, vërtet ky Marti punon si xhaxhi Koçi?

Marti e ndjeu se po skuqej. Ku shponte në ca gjëra ajo shejtane!

— Po, bijë e gjyshit. Këtë djalë si Koçin e kam. Marti rrudhi vetullat dhe e përqendroi shikimin në ftyrën e xha Mihalit pér të parë nëse, veç fjalëve tallëse që tha, do të bënte edhe ndonjë shenjë tjetër apo jo. Mirëpo xha Mihali ishte serioz si zakonisht dhe Linda as që i vuri në dvshim fjalët e tij. Madje Marti ndjeu se ajo e shikonte me admirim.

— Gjyshi, — e pyeti ajo xha Mihalin, — ti ke thënë se ndonjë ditë do ta sjellësh në shtëpi Martin. Kur do ta marrësh?

— Çfarë?! — pyeti Marti me habi dhe e hidhëte shikimin sa te vajza, tek ustai. I dukej e pabesue shme aë ai të kishte thënë ashtu...

— Do ta marr, do ta marr. Po ti ik tani, se kemi punë.

Po vajza s'donte të ikte.

— Jo, dua të shikoj se si punon Marti.

— Ik tani, de. Ik! Një herë tjetër.

Martit i vinte të qeshte me atë vajzë të çuditshme. Dhe s'u mbajt pa i thënë;

— Qenke e lezetshme ti! Dhe në mësime kaq e shkathët je?

— Për mësime...çka! — tundi kokën ajo në një mënyrë mjaft të veçantë, duke qeshur me një tingull fëmijëror, nga ata që të bëjnë për vete. Edhe Marti qeshi.

Vajza ndeshi shikimin urdhërues të gjyshit që i thoshte të ikte.

— Ika, ika. — Ajo i zgjati dorën Martit. — Tani e mora vesh kush je. Kurse unë të mendoja ndryshe. Kur të vish në shtëpi, do të të tregoj albumin e fluturave. Ta dish ti sa lloje fluturash kam mbledhur! Kur të vish, shihi vetë.

Xha Mihali e mori për dore dhe shkoi ta përcillte. Marti nxori paketen, por e futi përsëri në xhep. Ishte ende me përshtypjen e këndshme të asaj çamarrokeje. S'kishte dyshim që xha Mihali, në bisedat familjare, e kishte krahasuar me atë Kocin. Po përse vallë ta kishte bërë, kur ishte krejt e kundërta? Duket i vjen zor t'u thotë ç'tip i kanë dhënë për ndihmës, tha me vete dhe për herë të parë ndjeu përbrenda t'i vinte turp që nuk ishte i ngulur e i dhënë pas punës.

Xha Mihali u kthye shpejt. Fytyra i ndriste; i kishte rënë vërtet një pamje rinore. I tha Martit se ç'punë duhej të bënte dhe u ul ta lexonte letrën përsëri.

*

* *

Marti vuri maskën dhe nisi saldimin. Xha Mihali i qëndronte pranë. Djali i kishte premtuar se do të bënte çmos që ngjitjen ta bënte mirë. Lëviz-

jet e duarve tani, ndryshe nga më parë, ishin më të shkathëta e më të sigurta. Flaka shkreptiu dhe u shua. Por shpejt shkreptiu përsëri, qëndroi. Tymi i athët bojëhiri të shponte hundët, veshët, sytë... Ja edhe fundi. Tegeli i përhimtë dukej tamam si e qepura e plagës pas operacionit.

Ustai lëshoi një psherëtimë kënaqësie. Mollëzat e gishtave të tij përshkuante tegelin butë, ngadalë e pa gabuar.

— Vazhdo!

— Nuk mundem më, usta.

— Vazhdo!

Marti ia nisi përsëri. Tegeli zgjatej e zgjatej. Eshtrat e thyera të shasisë ngjiteshin, përtëriheshin.

Në mensë shkuante bashkë. Marti nuk fliste. Në sy kishte një dritë të butë. Mbi piatat shihte flakë të shndritshme, luga sikur mbështillej nga ai tymi i athët... S'qenka dhe aq e vështirë, mendoi. Dhe ora s'qenka aq e giatë kur punoke. Sido-mos kur puna shkon mirë. Se, kur nuk shkon mirë, apo duhet t'i kthehet përsëri, ajo zgjatet e zgjatet pa fund...

Bisedat, zërat, të aeshurat, aio përzierie zhurmash e tingujsh cë vërbën gjallérinë e nië mense në kohën e pushimit të punëtorëve. Martit i dukej sikur i vinin nga larg e i rrëshqitnin pranë pa e prekur, pa e rrëmbyer në vorbullën e saj.

Në tryezën e tyre u ul Saliu. Ai fliste e aeshonte me xha Mihalin, madje i rrahu edhe shpatullat

ustait të vjetër. Ai diçka i tha edhe Martit dhe ky po ashtu atij. Diçka që s'kishte të bënte fare me punën, po me gjellët! Çudi, tha Marti me vete. Gjithnjë kishte kujtuar se Saliu vetëm për punën mund të bisedonte. Kurse tani atë as që e përmendi fare. Sikur nuk ishin në uzinë, por në një kamp pushimi, dhe ai interesohej se si ja kolonin ata të dy me të ngrënë e me të pirë.

Ja edhe zeshkani i qeshur, si gjithnjë.

— Marti, buçko, ç'more!

— Mish me patate.

— Sonte në gjimnaz ka mbrëmje. Do të vish? Të të lë t'i biesh edhe xhezit.

— Të shoh.

— Në orën pesë. Eja në shtëpinë time në katër dhe dalim bashkë. Mirë?

— Mirë.

Zeshkani iku. Marti dhe xha Mihali u ngritën. Edhe rrugën e kthimit e bënë bashkë. Pa folur asnje fjälë. As kur filluan punën. Hiq, domosdo, rastet kur ustai i bënte ndonjë vërejtje.

— Ora dy e gjysmë, usta.

— Vajti? Mirë, ik.

Marti gati po ikte, kur ai e ndali:

— Na, Martin, shiko...Sikur të më vije sot në shtëpi? Linda, ajo çamarrokja, sa bie fjala për xhaxhanë e saj, të kujton edhe ty.

Martit i erdhi e papritur. Edhe iu bë qejfi, por edhe u shqetësua: mos vallë atje, në bisedë e sipër, xha Mihali do t'u tregonte të gjithëve që ai ishte krejt ndryshe nga Koçi? Sa turp do të ishte!... Jo, jo, më mirë të mos shkonte.

— Sonte, xha Mihal, do të shkoj në mbrëmje.

— E po mirë, nesër. Apo mbase duhej të kisha ardhur unë i pari tek ti? Po do të vij, do të vij.

— O, s'ka rëndësi ajo.

— Jo, po nejse. Kështu, nesër. Le që e llafosim prapë, këtu do të jemi.

Të nesërmen ai shkoi në shtëpinë e xha Mihalit. Linda kishte dalë ta priste në rrugë, bashkë me një shoqe, ndonëse shtëpinë ai e dinte. Me t'u ngjitur te shkallët e hyrjes e ndjeu veten disi ngushtë, por, kur pa fytyrën e qeshur të ustait, u çlirua. Në dhomë ishin edhe e shoqja e xha Mihalit dhe eëma e Lindës. Së pari e pyetën për njerëzit e shtëpisë dhe, kur ai u tha se babanë e kishte naftëtar, ata treguan shumë interesim. Biseda rridhete e ngrohtë e megjithatë Martin e mundonte shqetësimi: vallë, e meritonte atë pritje të përzemërt?

I nxorën dheëmbëlsirë, që i shijoi shumë. Xha Mihali i dha një cigare, por ai nuk e ndezi.

— Shkollën e vazhdon? — e pyeti gruaja e ustait.

— Këtë vit jo, — tha Marti me njëfarë turpi.

— Por vitin tjetër do ta vazhdoj. Do të regjistrohem natën.

— Edhe Koçi e vazhdon të mesmen dhe na shkruan se shkon mirë.

Marti u turbullua. Vetiu hodhi sytë nga ustai.

— Më nxjerr mallin e Koçit ky, — tha ai dhe qeshi. Pastaj u kthyte nga Marti: — Si ti ka qenë

dhe ai, i hedhur e çapraz, po ta shohësh tani ama, s'e njeh fare! E ke qejf topin?

— Si jo, xha Mihal!

—Ja, tamam një kokë!

Të gjithë qeshën. Linda i tregoi atij albumin e saj të fluturave, por ai nuk pa ndonjë gjë të vëçantë: qindra flutura të ngulura në gjilpërka. Megjithatë, Lindës i tha se ajo kishte bërë një gjë të bukur, pér të mos e fyer. Ajo pastaj i tregoi fletoret, të shkruara pastër e bukur.

Kur u ngrit të ikte, xha Mihali dhe Linda e përcollën deri te stacioni i autobusit. Për shumë kohë djalit nuk iu hoq nga mendja pritja shumë e ngrohetë që i kishin bërë.

* * *

Marti u bë gati shpejt e shpejt dhe arriti në punë në orën tetë pa pesë. Xha Mihali, si gjithmonë, i dha punë. Në orën dymbëdhjetë i kontrolloi me imtësi të gjitha ngjitjet që kishte bërë. Gjatë punës nuk e kishte ndërprerë asnjëherë. Marti i ndiqte me vëmendje lëvizjet e ustait dhe priste që ai të thoshte mendimin e vet. Por xha Mihali ishte, si gjithnjë, i heshtur. Shikonte, kruante me thua ose me thikë tegelin, i shkonte mollëzat, krahasonë. Gjithnjë asnjë fjalë. Madje asnjë ndryshim në fytyrë, as ndonjë shtrembërim buzësh, thuajse kontrollin e bënte një automat. «Siç duket nuk po i pëlqen puna», mendoi Marti. Mirëpo pikërisht kur i kishte humbur të gjitha shpresat se ustai, në mos do t'i

thoshte ndonjë fjalë të mirë, të paktën nuk do ta qortonte, ai u habit kur dëgjoi:

— Të lumtë, o djalë!

Sytë e ustait vezullonin nga një dritë e ngrohtë, që Marti nuk ia kishte vënë re kurrë më parë.

* * *

Ditën tjetër xha Mihali nuk vajti në punë. Ai kishte shkuar në një fshat malor, ku ndërtohej një rezervuar i madh uji.

Marti nuk dinte ç'të bënte, të rrinte aty apo t'i thoshte përgjegjësit të repartit se me cilin nga saldatorët e tjerë do të punonte. Dha e mori ndonjë gjysmë ore dhe së fundi vendosi të punonte aty. I pavarur ishte, punonte sa të donte dhe mund të bënte pushim sipas dëshirës. Sapo mori këtë vendim, edhe vetë u çudit se ç'zell ndjeu pér të fillouar menjëherë nga puna. Të kishte qenë aty ustai, me siguri do t'i kishte pëlqyer ta shtynte edhe ca. Dhe nisi të vazhdonte ç'ishin lënë përgjysmë, kurse pér të marrë punë të re do t'i thoshte përgjegjësit. Rregulloi pjesët që do të ngjiste, vuri elektrodën në pincë, mori maskën dhe shtypi sustën. Flaka shkreptiu. I përpirë në punë, nuk vinte re si rridhëte koha. Ishte krejt i përqendruar në të. Rrallë e tek mund t'i vinte ndonjë mendim që nuk kishte lidhje me punën. Rëndësi kishte vetëm ajo flakëza nervoze, para ftyrës së tij, ai diell i vogëlth, ngjitja e mirë, e fortë dhe e shpejtë. Ishin plot gjëra që duheshin bërë njëherësh.

Aty nga ora nëntë Marti shkoi te zeshkani dhe të dy vajtën në bufe. Tjetri iu lut për një konjak po Marti nuk deshi.

— Ta paska mbledhur xha Mihali, — e ngacmoi ai.

— Nuk është puna te xha Mihali. Nuk dua vëtë. Le që kam aq punë për të bërë...

— E di, Marti, që ke filluar të ndryshosh?

— Pse, gjithnjë njësoj do të rrnimë?... Hajde pykë, hajde!

Kur u kthyte te vendi i punës, gjeti aty përgjegjësin e repartit dhe një burrë të shkurtër dhe fare të imët, me ca flokë të zez e të rrallë si furçë. Nga mënyra si fliste dhe nga gjestet që bënte, Martit iu duk shumë i rrëmbyer.

— S'kishim ç'të bënim, — i tha përgjegjësi, — na e kërkuan, ua dhamë.

— Keni saldatorë të tjerë.

— Të gjithë kanë punë nëpër duar.

— Po ç'kusur kemi në?

— Eja njëherë nesër.

— Jo, more shpirt, se e kishim për dje! Kurse ju më thoni për nesër. S'është mirë kështu, shok i dashur.

Përgjegjësi thirri pranë tij Martin dhe e pyeti nëse e dinte se ku i kishte lënë xha Mihali ca pjesë që kishte për t'i ngjitur atë ditë. Marti u mendua pak, pastaj shkoi pranë një arke të madhe, nga ku nxori ca hekurishte. Përgjegjësi i tha se të nesërmen do të bënин çmos t'i mbaronin. Po ky djali? Jo, jo, ky ishte i ri, dhe nuk mund t'i bënte dot. Ata biseduan edhe pak e u larguan.

Në kraharor ndjeu një si shtrëngim, tamam siç e ndjen veten para se të zhytesh në ujin e ftohtë. Kishte dëshirë që t'ia hynte punës për t'i salduar ato pjesët që kërkonte ai burri. Marti e kishte parë shpesh xha Mihalin tek bënte atë lloj ngjitjeje. Madje disa herë kishte bërë edhe vetë. Kishte nja dy vende që donin kujdes, shumë kujdes, por sidqoftë ishte gjë që bëhej. Po të ishte se do të ngekte, do të kërkonte ndihmën e Lefterit, saldato rit që punonte aty afër. Sa për ndonjë shpjegim të vogël, Lefteri edhe herë të tjera e kishte ndihmuar.

Marti ndezi cigaren e dytë. Ende s'po ia niste, ende s'po guxonate. Në mesoren e ngushtë që të nxirrte tek axhusteria vuri re dy djem që ia bënin me shenja. Ishin shokët e tij. Ja ku u bashkua edhe zeshkani me ta. Po Marti s'veshtroi më andej. Dëshira po i kthehej në nxitje të fortë e nxitja e fortë në...vendim. «Po, — tha, do t'i futem.» Dhe, sa tha kështu, u lehtësua. Nuk e kishte më atë shtrëngim në kraharor. Tani kishte vetëm një dëshirë: nga dora të nxirrte punë të saktë e të bukur. Që ai burrë nervoz të mos i binte më më qafë përgjegjësit me ato gjeste prej kapadaiu. Po nuk ishte vetëm kjo. Jo, ishte edhe diçka tjetër. Deri tani as ai vetë nuk e kishte ditur se kjo diçka ekzistonte, ndonëse kishte qenë atje thellë, brenda tij, e kishte ngacmuar herë-herë, por ai s'ia kishte vënë veshin, se të tjera dëshira e kishin tërhequr. E gjerë, e thellë dhe shumë e bukur ishte kjo ndjenjë e re. Ishte e fortë, e ngrohtë, e rrëmbyer; ishte rreze dielli që vërshon nga të çarat e reve ndërsa syri i kaltër i qiellit hapet e hapet.

Çuditërisht, zelli që e pushtoi i ngjante inatit,

E dinte mirë se mjeshteria e saldatorit, si çdo mjeshtëri tjetër, ka shumë këçka, që s'ua del dot mbanë menjëherë dhe se me tre muaj punë ende mund të quhesh fillestar. Por ai i kishte thënë vetes se do të punonte pastër e bukur sikur të ishte vetë xha Mihali. Ai e merrte me mend cila do të kishte qenë fjala që xha Mihali do t'i kishte thënë para se Marti të merrte atë vendim: «Matu mirë para se t'i futesh diçkaje, djalë, por, po iu fute, dili mbanë si burrat». Si burrat... Fjalë e bukur edhe për të, edhe pse ishte fare i ri.

Flakëza shkreptiu duke shpérndarë shkëndija të egra, inatçore, që goditnin me forcë xhamin e maskës. Gjithë mendimet e tjera, gjithçka që nuk kishte të bënte me ato që kishte përpara syve po i humbiste dhe po i mbetej vetëm dëshira për punën, që ta kryente sa më mirë dhe sa më shpejt.

Jo larg tij kishin qëndruar disa punëtorë që po e shikonin. Kishte kohë që Marti nuk e kishte ngritur kokën. Tani ai hoqi maskën, lëshoi pincën dhe mori frymë thellë. Kishte punuar goxha dhe i pihej një cigare. Atë çast se si ia tërroqën vëmendjen njerëzit që kishin ndaluar disa hapa larg tij. Por shikimin e kishte të topitur, të veshur me ca reflekse të kuqe, siç i kishte ndodhur shpesh kur kishte punuar pa pushim. Ai nuk po i dallonte menjëherë se cilët ishin ata. Më pas e përqëndroi vështrimin dhe perdja nisi të hollohej... Dhe s'vonoi të shqu-

ante qartë fytyrën e njohur, të butë e të ashpër, të ustait. As vetë s'e kuptoi se si pati për atë njeri të njëjtin mall që shpesh ndiente edhe për të atin. Vetëm pas kësaj mungese të shkurtër e kuptoi se sa i afërt e i dashur i ishte bërë ai njeri. E më fort e ndjeu kur ustai, papritur, u dha përpara tij. Ai nu k priti që xha Mihali t'i afrohej, por u derdh vetë drejt tij, për t'i dhënë dorën e për ta pyetur se si ia kishte kaluar andej. Ustai i zgjati të dyja duart e kapi nga krahët dhe e tërroqi drejt vetes si djalin e vet. Dhe, si duke pëshpëritur, i tha vetëm dy fjalë:

— Marti, o djali i xha Mihalit!

Kopshti me mollë

Ela papritur nisi të mos shoqërohej më me Bert Plepin. Mua m'u duk e çuditshme. Kisha menduar se ata i lidhte një miqësi e fortë, nga ato që nuk para prishen lehtë. Të them të drejtën, edhe m'u bë pak qejfi. Sepse Berti nuk më pëlqente. Ai kishte një mani, donte si e si t'i vinte të tjerët në lojë. Sidomos ata që i pandehte syleshë. Dhe kënaqej kur në kurriz të ndonjë të ngrati të tillë bënte ndonjë «numër».

Elës me siguri do t'i kishte mbetur qejfi për ndonjë gjë nga ai, se ishte e ndjeshme dhe prekej lehtë.

Nuk them se nuk e kisha pasur zili Bertin për shoqërinë e tij me Elën, sepse më parë ajo shoqërohej me mua. Ela ishte e gjiltër dhe miqësohej shpejt, por kishte ama dhe atë tjetrën: po ashtu, shpejt e papritur, ajo i jepte fund asaj miqësie.

Atë ditë që unë mora vesh se ajo e kishte prishur shoqërinë me Bertin, ne kishim katër orë mësim. Kur ra zilja, rrëmbyem çantat dhe dolëm në korridor gjithë zhurmë, jo si të ishim maturantë, por si nxënës të viteve të para. Mes gjithë asai lë-

vizjeje kërkova me sy Elën. Kisha dëshirë që rru-gën deri në shtëpi ta bënim bashkë. Ne ishim fqinjë dhe vetëm një gardh me ferra e tela i ndante obo-rret tonë. E njihnim njëri-tjetrin që fëmijë. Unë isha tre vjet më i madh se ajo dhe, kuptohet, një herë e një kohë unë nuk e kisha quajtur atë si shoqen time por, kur ditën e parë të fillimit të gjimnazit u gjetëm në një klasë (ata tre vjet unë kisha ndërruar dy shkolla e kisha bërë një vit punë si çirak te një kasap), kuptohet që ndërrpoi puna. Të mos harrojmë që këto kanë ndodhur vite më parë.

Në korridorin e gjerë e pashë midis një grupi vajzash të klasës dhe i thirra. Ajo ktheu kryet.

— Qëndro pak!

Ajo u nda nga ato.

— Ç'kishe?

Në shtëpi do të shkosh?

— Jo. Do të dal pak me Blertën dhe Almën.

— Doja të të pyesja diçka.

Ajo u bë kureshtare. Madje m'u duk se një purpur i lehtë i mbuloi fytyrën, por vetëm për pak çaste. Ashtu e kishte ajo, turbullohej shpejt edhe po shpejt e zotëronte veten. Vajzat si ajo gjithnjë dinë ta zotërojnë veten. «Në shumë raste ne bëhemë si guhakë përpara vajzave», më thoshte një ditë Maksi, një shoku im tornitor, «kurse ato përpara nesh, në po ato raste, bëhen tepër të mençme». Nuk di nëse e kishte mirë Maksi apo jo, por unë ndjeva se asgjë nuk do të shkonte siç e kisha parashikuar.

— Fol, — tha ajo qetë.

— Jo këtu, — i thashë, — për në shtëpi është

shpejt. Bëjmë një shëtitje të shkurtër dhe bisedojmë.

— Për se do të bisedojmë?

— Po... them se kemi pasur aq shoqëri, sa të bisedojmë pér diçka që më shqetëson. — Dikush po na shikonte si me dyshim. Duket, shprehja që kisha marrë, tërhiqte vëmendjen e të tjerëve.

— Po ti pse u skuqe kështu? — më pyeti Ela.

— Unë? Çne!

Por, tekxa thashë ato fjalë, e ndjeva se vërtet po skuqesha.

Ajo deshi të qeshte, por u përmbajt. Unë vazhdova i nxehur:

— Në qoftë se nuk ke qejf të bisedojmë, ik.

— Ela! — i thirrën shoqet nga larg.

— Shko, — i thashë, — se po të presin.

— Jo, — tha ajo, — nuk shkoj.

Në sy i lexova dëshirën që midis nesh të rivendosej sa më parë mirëkuptimi.

— Më thuaj ç'kishe pér të më thënë!

— U pendova. Një herë tjetër.

— Jo, nguli këmbë ajo, — tan!

Dhe u tha vajzave që po e prisnin se nuk do të shkonte me to. Pastaj u kthyte nga unë. Bluja e syve të saj dukej sikur pérhapej në gjithë pjesën e sipërme të fytyrës, endte atje një tyl të rimbët e lëpihej në mollézat pak të bymyera, që i jepnin gjithë fytyrës një hijeshi të veçantë. Bukuria e saj në ato çaste ishte e gjallë dhe tepër rrëmbyese, ndryshe nga herët e tjera, kur dukej si bukuri statuje. Vetullat iu harkuan dhe balli i lartë, krejt i lëmuar, iu vrenjt. Ishte tamam një nga ato çastet kur asaj i vlonët dëshira pér t'iu imponuar tjetrit. Një prir-

je e tillë, natyrisht, nuk është e mirë, veçse tek ajo nuk mbante gjatë, si te vajzat kryeneçe. E tillë ishte Ela.

Nisëm të çapiteshim ngadalë drejt qendrës së qytetit.

— Fol, — më tha ajo, — apo duhet të të ndjek pas?

— Do të flas. Por më parë eja të hamë nga një akulllore.

— Nuk dua akulllore, po ti më thuaj ç'ke për të më thënë!

— Ela, nëse nxiton, ik!

Por ajo nuk iku. Vazhdoi të ecte krah meje. Morëm një rrugë të ngushtë, rrethuar me ca ndërtesa të vjetra, të larta, mbeturinat e qendrës së qytetit që po rindërtohej. Sa herë kaloja në atë rrugë, vetja më dukej personazh i ndonjë filmi me ndodhi të vjetra. Po tani jo. Prania e Elës i shuan-te ato përfytyrime. Ajo ishte kontrasti i gjithçka-je të vjetër.

Me nga një kaush akullore në duar dolëm në rrugën më të bukur të qytetit tonë. Ela e lëpinte akulloren me qejf, si çupat e vogla, pa ua hedhur më sytë vitrinave. Dukej se po i pëlqente shëtitja në atë mesditë të ngrohtë prilli. Ishte ditë e shtunë, një ditë disi më e ndryshme se të tjerat, se, duke qenë afër me të dielën, gjithmonë më ngjalte një ndjenjë të këndshme.

— Ç'thua, nisemi për në shtëpi? — e pyeta.

— Ou! Akoma nuk po kujtohesh se kishe për të më thënë diçka?

Mes rrjedhës së njerëzve, tezë Maria! Unë

ktheva kokën mënjanë që të mos më njihte. Kush ndalej e u përgjigjej pyetjeve të saj!

— Ela, pse nuk shoqërohesh më me Bertin?

Ajo ktheu kokën nga unë.

— Çfarë?!

Tani ndodheshim përpara ndërtesës së madhe të turizmit. Kalimtarët aty ishin më të rrallë. Në lugun e gjatë të mbjellë me lule luanin disa fëmijë Një vogëlushe u rrëzua e klithi. «Do të ngrihet vëtë apo do ta ngrejë ai bullafiqi?» — pyeta unë vreten. Ela, syhapur, priste të flisja. Por unë vetëm përsërita:

— Të pyeta për Bertin, përse nuk shoqërohesh më me të?

Ajo kafshoi buzën dhe u skuq.

— Po ty ç'të duhet?

Kujtova që ky qe fundi i bisedës, se ajo foli shumë prerë, gati me ashpërsi. Dhe mendova se fill pas këtyre fjälëve do të më kthente shpinën e do të ikte, pa dëshiruar që rrugën deri në shtëpi ta bënim bashkë. Fundja le të ikte, atë që kisha për t'i thënë, edhe pse në formë pyetjeje, ia thashë. Ajo me siguri e kuptoi që unë nuk po i kërkova llogari, porse i bëja të ditur, fare tërthorazi, se e miratoja veprimin e saj. Ajo e dinte mirë ç'mendim kisha unë për Bert Plepin.

— Për atë mos më pyet më, — tha dhe uli systë.

— Nuk e di, s'të siguroj dot. Mbase do të të pyes.

— Jo, — tha ajo me vendosmëri dhe përplasi këmbën në tokë.

— Pse?

Por nuk m'u përgjigj. Edhe unë s'e ngava. Të paktën hëpërhc. Shtegu ishte çelur dhe rifillimin e një bisede të dytë, në një kohë më të përshtatshme, do ta kisha më të lehtë.

Pjesën më të madhe të rrugës për në shtëpi e bëmë pothuaj në heshtje. Ato pak fjalë që këmbyem ishin për provimet që po afroheshin dhe për universitetin. Ajo èndërronte të vazhdonte përkimi. Këtë èndërr të sajën unë e dija prej kohe. Por mendoja se ajo nuk kishte punuar sa duhej përtta realizuar atë. Jo se ajo nuk ishte nxënëse e mirë, por në të tria maturat që kishte shkolla kishte të tjerë shumë më të mirë. Ndaj ajo kishte frikë se nuk do t'i jepnin degën që dëshironte por ndonjë degë tjetër. Sepse nuk kishte mësuar sistematikisht dhe notën mesatare nuk e kishte më tepër se nëntë. E tillë ishte Ela: e zgjuar, me dëshirë përtta zgjeruar horizontin dhe, për çudi... jo me shumë vullnet përtë mësuar mësimet e shkollës.

Ne iu afruam /shtëpive. Para se të ndaheshim, ajo më tha:

— Do të vij të marr pak detyrat e matematikës.
— Mirë.

Prita të më përshtendoste e të ikte, por ajo nuk lëvizi nga vendi Dukej se edhe diçka tjetër donte të më thoshte, por sepse ngurronte.

— Shiko, — më tha së fundi, — më mirë e mësojmë bashkë analizën. Edhe trigonometrinë.

Unë nuk iu përgjigja menjëherë.

— Në qoftë se do, mirë, — i thashë.

— Duhet të bëj çmos ta ngre mesataren, Gimi.

— Mirë, Ela, por...

— Çfarë?

Tani nisa të ngurroja unë. Dhe jo pa shkak. Prindërit e saj nuk e kishin me sy të mirë shoqërimih tim me të. Unë isha djali i një karrocieri, ne kishim një shtëpi të thjeshtë dhe jeta që bënim ishte po ashtu, e thjeshtë. Ndërsa familja e Elës ishte ndryshe. I ati deri vonë kishte një dyqan privat bonbonerie në qendër të qytetit. Ai tani punonte magazinier, po dikur e vriste lart. Kurse e shoqja, e ëma e Elës, e mbante vete tamam si ato zonjat e dikurshme. Nuk duroja dot sidomos atë pamjen e saj mëshirëmadhe, kur më shikonte veshur me ndonjë rrrobë të re.

Po përveç këtyre e ëma e Elës nuk më kishte me sy të mirë edhe për një arsyet tjetër: unë kisha lënë dy shkolla (teknike të dyja, në Berat e në Vlorë), ndërsa para se të futesha në gjimnaz kisha punuar si qirak te një kasap, gjë që më kishte ulur fare në sytë e saj. Ndonjëherë kishte rënë rasti të më thoshte si me tallje «kasap me shkollë». Mua, më vinte inat, po s'kisha ç'bëja. Nuk kisha dëshirë të më merrte inat Ela. Shumë gjëra që nuk shkonin tek e ëma, ajo nuk i vinte re ashtu si unë.

Unë ende qëndroja përpëra saj, pa ditur nëse duhej t'i jepja shpjegime për ngurrimin tim për të mësuar me të apo jo.

— Po fol, de! — më nxiti Ela.

— Dëgjo, Ela. Unë jo se s'dua që të mësojmë bashkë. Sinqerisht, do të bëja çmos që ty të të ngrihej mesatarja. Mirë, po a është dakord mamaja jote?

Buzët iu hapën pakëz kur dëgjoi ato fjalë dhe brenda syve i regëtiu një dritëz habie por edhe fyerjeje.

- Mamaja s'ka pse të ketë kundërshtim. Unë e respektoj atë, por edhe ajo mua. E para kjo.
- Po?...
- Dhe e dyta: ajo vetë më ka thënë...
- Çfarë?
- Që... Agimi është më i mirë në mësiime dhe në këtë periudhë ndihma e tij, domethënë jotja... do të më vlejë shumë. Po unë mësoja me Bertin dhe s'kisha...
- E kuptoj. — Unë heshta një grimë. — Atëherë ndryshon puna. Në qoftë se vërtet të ka thënë.
- Ti dyshon?
- Jo, Ela.
- Atëherë eja pasdite. Mësojmë tek unë. Mirë?
- Mirë. Aty nga ora katër.

Që atë ditë filluam të mësonim bashkë. Shkoni më kopshtin me mollë, uleshim rrëzë ndonjë pemë, mbi ndonjë shkorsë apo mbi barin e gjelbër, të butë si flokë fëmije, dhe hapnim librat e fletoret. Më parë kujtonim ndonjë ndodhi nga shkolla, bënim ndonjë shaka apo dhe hapnim ndonjë bisedë serioze. Unë isha më i përmbajtur dhe nuk para flisja vend e pa vend për dëshirat që më vlonin në shpirt, por Ela... Ela nuk përmbahej. Ajo sa s'fluturonte kur binte fjala për universitetin, për degën e saj të ëndërruar! Ç'ngjyrë e ç'sprehje merrte fytyra e saj ato çaste! Sytë i mbusheshin

me një lloj përmallimi të thellë. Mua më pëlqente ai ekzaltim i saj në ato çaste, i cili më rrëmbente dhe më fuste në shpirt gjësim, por, që të them të drejtë, edhe më brengoste pakëz. Gëzimi i saj e bënte më të afërt largimin. Veç unë me gjithë shpirt doja që ajo të shkonte në universitet. Ndoshëta e ardhmja nuk do të na largonte aq nga njëri-tjetri, por mund të na afronte edhe më. Sepse... sepse... unë e doja Elën dhe nuk do të dëshiroja kurrë të ndaheshim.

Herë-herë eëma vinte te ne dhe na sillte ndonjë gjë pér të ngrënë. Dhe qëndronte aty derisa nisnim të hanim. Mua më ngekte në fyt ajo e ngrënë, por s'kisha ç'bëja nuk doja të fyeja Elën.

Një ditë, teksha mësonim, na erdhi Berti. Që në shkollë i kishte thënë Elës se edhe ai do të vinte të mësonte me ne, por ajo nuk kishte pranuar.

Më kujtohet mirë ajo pasdite. Ishin ditët e fundit të prillit dhe kopshti i mollëve, me atë gjellbërim të harlisur, dukej sikur merrte frymë. Në të gjithë hapësirën shpërndahej një aromë dehëse, aroma e barit të njomë, e lulave dhe e ajrit të lagësht. Pranvera gufonte e tëra, depërtonte tek unë nëpërmjet gjithë shqisave dhe më bënte ta ndieja veten të lehtë e të gëzuar, si pjesëz e saj, e barit, e drurëve të ripërtërirë, e flladit të lehtë... Isha krejt i përhumbur. Shikoja me bisht të syrit Elën, ulur, fare pranë meje, e përqendruar në zgjidhjen e ndonjë derivati të vështirë. Flokët ngjyrë gështenjë, të dendur, i vareshin supeve. Në gushën e bardhë, si qelibar, vezullonte butë një medalion i artë. Unë nuk ia ndaja shikimin. Nga flokët e saj

buronte një aromë e lehtë, krejt e veçantë, e bërë njësh me aromat që buisnin nga kopshti.

E kisha fare pranë Elën, vajzën e ëndrrave të mia, njeriun për të cilin mendoja më shumë, që u jepte ngjyrim e freski ndjenjave të mia.

Ajo shpejt e nuhati gjendjen time. Unë nuk i dhashë ndonjë shkas. Na tremb frika se mos me një nxitim të parakohshëm prishim gjithçka, humbasim gjithçka.

— Ela, — i thirra gati me të pëshpëritur.

Ajo shkëputi sytë nga libri dhe më vështroi në mënyrë pyetëse.

— S'të duket çudi që së shpejti do të ndahemi përgjithmonë?

— Ndoshta nuk ndahemi.

— Si kështu?

— Mund të jemi në një fakultet.

— Jo. Ti e di që të tria kërkesat unë i kam vënë për matematikë.

Ajo heshti një grimë.

— E di. E megjithatë them se nuk do të ndahemi.

— Ti u beson parandjenave?

— Nganjëherë...

— Domethënë jo shumë.

— Jo shumë.

— Në c'gjë beson ti shumë?

Ajo u mendua pak para se të fliste.

— Në gjérat që preken, që shihen, që dëgjohen.

— Po në ato që ndihen?...

Ajo u skuq lehtë dhe puliti sytë.

Frynte një fllad i lehtë, i ngarkur me frymë-marrjen e gjetheve të gjelbra. Një tufë rrezesh di-

elli binte mbi flokët e saj. U dëgjua klithma e një shpendi, pastaj një flatrim i mprehtë çau ajrin. Kopshti me mollë sikur u drodh, sikur u zgjua nga dremitja.

Ajo hodhi shikimin mënjanë. Fletorja i rrëshqiti nga prehri dhe i ra mbi bar. Unë e ngrita dhe ia vura përsëri në vend. Ne kishim mësuar mjaft dhe tani çdo bisedë tjetër, veç mësimet, ishte e justifikuar.

— Ela, unë të pyeta...

— I lëmë këto, Gimi, Vazhdojmë.

— Jo, — i thashë. Dhe ia kapa dorën me vrull. Ajo bëri një si përpjekje për ta qiruar, duke lëshuar një «oh» të lehtë, por së fundi e la. Shikimi i saj ndeshi timin. Dhe nuk e shkëputi menjëherë. Koka iu var paksa nga unë, por kjo s'vazhdoi veç një grimë; me një lëvizje të vrullshme ajo e shkëputi dorën e saj nga dora ime.

— Mos, — belbëzoi. — Jo kështu!...

— Ela!...

— Eja, se do të ikim. Nuk...

Ajo bëri një lëvizje për t'u ngritur, por unë ia kapa dorën përsëri, këtë radhë më i vendosur, më me guxim. Shikimi i saj tani ishte qortues.

— C'bën?

— Ela, unë... Shiko, kam dashur të të them...

— Mos, Gimi! — tha ajo e zbehur në fytyrë dhe me një lëvizje të beftë e shkëputi dorën. Po pikërisht atë çast unë e kapa nga supet dhe afrova fytyrën time fare pranë fytyrës së saj, duke arritur të shihja se si dridheshin qerpikët ndërsa ishte si në pritje të një dikçaje të frikshme. Unë vura buzët mbi buzët e saj, por ajo e lëvizi pakëz

kokën dhe putha cepin e tyre. Për disa sekonda qëndruam të dy ashtu, të ngrirë, të palëvizur, të dy pa frymë. Nuk di sa zgjati ai çast, sa kohë qëndruam ashtu, në harrim të gjithçkaje, veç asaj që po ndodhte mes nesh, por di se ai qe një çast deri atëherë i pangjashëm me asnje tjetër, puthja e parë, dashuria...

E para u shkund ajo. Mblodhi librat dhe bëri të çohej, por... ngriu në vend. Nga deriçka që lidhëtë kopshtin me oborrin e shtëpisë u dëgjuan hapa.

— Dëgjo, Ela! Sonte... këtu. Vetëm dy minuta.

— Mos! Hesht!

Dhe menjëherë u ngrit në këmbë. Drejt nesh po vinte Berti, me trup të gjatë, fytyrë të hijshme zeshkane, me ataq sy të thellë që gjithnjë sikur kërkonin të tallnin dikë, të ironizonin për diçka. Ela ishte prishur në fytyrë sa s'bëhej. Një fletore i ra nga dora. Ajo u ul, e mori, e shkundi dhe u kthyte nga unë duke më folur gjoja shpenguar:

— Hajde, pra, Gimë.

Ngadalë edhe unë u çova. Me gjak të ngrirë prisja ç'do të thoshte Berti. Ai i hodhi një shikim Elës, pastaj mua.

— Për kokë të babait vend ideal për të mësuar! Më vjen shumë keq që s'më pranoni dhe mua.

Vura re mirë se Ela po përpiqej me të gjitha forcat t'i jepte vetes një pamje të shkujdesur, të qeshur.

— Ku ke nevojë ti të mësosh me të tjerë!

— Pse? Ku hanë dy, mund të shtohet edhe një lugë...

E dija se do të fillonte dhe me zor e mbajta veten pa iu hedhur në fyt.

— Deshe gjë që erdhe, Berti? — e pyeti Ela gati me inat.

— Po, doja përfundimin e një probleme. Po pse, mos ju prisha qetësinë?

Me të thënë këto fjallë, qeshi nën zë dhe u kapërdi. Në tërë qëndrimin e tij kishte diçka që të neveriste.

Asnjëri s'iu përgjigj.

— Qetësi e shqetësuar... — vazhdoi ai dhe më shkeli syrin, pa e shqitur ndërkokë atë nënqeshjen e tij tinëzare. Unë e ndjeva se po skuqesha flakë.

— Ç'do të thuash? — i fola ashpër, ndërsa iu afrova pak. Ai ishte ndonjë pëllëmbë më i gjatë se unë.

— Asgjë. Vetëm atë që thashë. Fola gjë gabim?

— Bën mirë të shikosh punët e tua, Berti, — ia ktheva po me atë ton. — Apo jo?

— Punët tona? Secili punën e tij... Dakord. Po, kur padashur të venë sytë në punët e ndonjë tjetri, ç'duhet bërë?...

Unë edhe Ela u pamë në sy. Ajo m'u duk e shqetësuar.

— Berti, — iu gërmusha unë, — në qoftë se kërkon të përzihesh në gjëra që s'të takojnë, ka.... edhe ndryshe!

Dhe, ashtu i nxehur siç qeshë, mund të bëja edhe ndonjë proçkë, por shikimi qortues i Elës më frenoi. Berti ma njihte forcën time prej demi, në fizkulturë e në raste të tjera, por unë kurrë nuk isha treguar brutal me njeri. Ai nuk e dha veten para Elës, ndonëse e dija që y tremb. Ela ndërhyri me të shpejtë:

— Léri këto, Gimi! — Pastaj u kthyte nga Berti:

— Ti nuk ke asnje punë me ne. Të lutem, ik!
— Si urdhëron!

Sytë e tij ishin bërë të shndritshëm, si të dhel-prës. Unë edhe Ela ecën drejt derickës së oborrit. Ai na arriti.

— Shikoni, — tha, — mua s'më fshiheni dot. Ja kështu.

— Përse? — e pyeta unë dhe u ktheva nga ai.

— Berti, shiko punën tënde, — i tha Ela me të butë. — Në qoftë se ke ndër mend të marrësh ndonjë njeri nëpër gojë, nuk do të kesh asnje të mirë nga kjo.

Ai hodhi dy-tri hapa, ndaloj dhe tha:

— Mua as më trembni, as më fshiheni dot. Ki mendjen, Ela!

Pa e shqitur nga fytyra atë buzëqeshjen e tij të pështirë, nxitoi hapat dhe u zhduk prapa qoshes së shtëpisë. Unë edhe Ela ndenjëm për disa çaste pa lëvizur.

— Ç'bëre, — më tha ajo pas pak, e skuqur flakë në fytyrë.

Unë heshta.

— Vajte dhe i the «mos u përziej në gjëra që s'të takojnë».

— Po ç't'i thosha?

— Mirë, mirë...

— Eja sonte, Ela. Atje...

— Jo.

— Unë do të jë pres...

— Ik tani! Ik!...

U pamë sy më sy. E kuqja tani po i kthejë në zbehtësi, sidomos tek ato mollëzat e saj aq të hijshme, dhe ishte gati t'ia plaste të qarit. E kup-

tova: atë e mundon frika. Me siguri mendonte se Berti do të na hapte telashe. Edhe unë e kisha atë frikë, por nuk kisha si e qetësoja Elën. Këtej e tutje ai ishte superior karshi nesh: ishte dëshmitari i vetëm i së fshehtës sonë.

Ela ende qëndronte aty, përpara meje, e hutuar dhe e shqetësuar, në pritje të ndonjë fjale qetësu-ese nga unë, shkaktari i hallit, pa qenë në gjendje të isha dhe mbrojtësi i saj. Në sytë e kaltër të Elës që tani, ndërsa hijet po dendësoheshin, kishin marrë ngjyrën mavi të thellë të detit, unë pa- shë dritëzën e një dëshire të fshehtë të luftonte me frikën.

— Ela, unë do të të pres, — i thashë me të shpejtë. — Atje bisedojmë.

Dhe u bëra erë, duke marrë me vete kujtimin e fytërës së saj me atë përzierje hutimi, frike dhe dëshire, që e bënин atë të magjishme e të bukur, ndërsa një degë e gjelbër i lodronte mbi kokë.

Ecja si nëpër èndërr, me këmbët si të marra hua, me ndjesinë e një lumturie të thellë që më mbushte me një gëzim të pamasë, ku Berti e gjithçka që lidhej me të humbte si një cikërrimë... Më vinte të këndoja, të thërritja yetëm emrin Ela. Rruga ishte plot me njerëz; ndokush më përshtëndeste, ndokush më fliste, por unë s'njihja njeri, isha i shurdhër, i shterpët nga fjalët, i verbuar nga drita që më mbushte të tërin nga brenda. Unë isha plot me të fshehtën time që, edhe pse i kishin vjedhur një copëz, ishte e plotë dhe e bukur, gjithë magji, me ngjyrat e kaltra të qiellit dhe të syve të Elës, me gjelbërimin e harlisur të kopshtit të mollëve dhe të kuqen e buzëve të saj... Aromat e

fundprillit ishin dehëse, por më dehës ishte kujtimi i aromës së flokëve të saj. Yjet në qellin e hapur vezullonin butë, por gjithsesi nuk kishin të krahasuar me vezullimin e syve të saj. Dhe pyesja veten: a ka dashuria, vallë, caqe të tjera, të tilla që t'ua kalojnë ndjesive pas puthjes së parë?

Qielli ishte mbushur me yje. Atë mbrëmje prilli, të bukur dhe të freskët, po më mblidhej një ankth në gjoks. Prisja pranë gardhit, me fytyrën të tendosur të gjethishtet. Mund të kishte kaluar rrëth gjysmë ore që kurse kisha zënë vend aty. Shpresa dhe zhgënjimi luftonin pareshtur tek unë, isha si ajo dega që tundet nga stuhia dhe nuk dihet nëse do të thyhet apo jo. Nuk di pse më pëlqente aq shumë të shikoja yjet, duke u përpjekur të kujtoja ndonjë emër të tyre nga mësimi i astronomisë. Por ata më ishin bërë të dashur edhe pa emra, se ishin si unë, vëzhgues e pritës. Veç ato ishin në një pritje të përjetshme, kurse unë në një pritje fare të shkurtër, por gjithë drithërimë: a do të vinte, vallë, Ela?

Kopshti me mollë tanë nxinte, me konture të tjetërsuara, i huaj e i ftohtë, i fshehtë e i shkretë, fare ndryshe nga disa orë më parë, kur pluhurima e artë diellore shpërndahej butë përmes gjethishteve dhe mbushte tërë hapësirën e gjelbëruar, binte mbi barin e njomë e mbi lulet e verdha e të kaltra e derdhej edhe mbi flokët e Elës si një kurorë e praruar. Një zog fluturoi me shpejtësi mes degëve: nga larg u dëgjua klithma e përvajshme e gjonit, zogut të natës, që kërkon. Edhe ai ishte në pritje, në pritje e në kërkim të vëllait, që kushedi pse nuk

e takonte dot kurrë. Nga kopshti erdhi klithja e mprehtë e një zogu: civik-civik, civik-civik... Kë thërret, vallë, ti, zog i natës? A të dëgjon, a do të të vijë?

Në thellësi të kopshtit me mollë m'u bë se dëgjova një zhurmë. Mbajta vesh. Diçka jehoi mbytur, humbi, fëshfériu përsëri. Zhurma u dëgjua më e shkoqur dhe unë e kuptova: ishte zhurmë hapaş, hapaş të nxituar. Tëmthat më rrahën me forcë dhe nëpër damarë sikur nisi të më rriddhe hekur i shkrirë. Një degë e thatë krisi. Përmes lëpesë së mugilluar të kopshtit pashë një siluetë të afrohej. Ishte ajo. Bari fëshférinte e fëshférinte dhe degëzat e njoma po ashtu fëshférinin, por më fort, më ashpër. U shfaq Ela pikërisht te vendi ku mësonim dhe aty qëndroi në mëdyshje, duke parë me hamendje në drejtimin tim.

— Ela! — i pëshpërita unë.

— Shsht!

Ajo pothuaj i bëri me vrap ato pak metra. Mezi merrte frymë. Unë, nga ana e këtejme e garrdhit, u tendosa i téri.

— Prit se po vij, — i thashë.

— Jo, — tha ajo si me frikë. — Mos lëviz. Erdha sepse e dija që prisje. Po nuk do të rri.

— Rri pak, Ela. Fare pak...

— As edhe pak. Ne...ti...bëre budallallëk qëparë, Agim. Më fute në një telash, që...

— Pse? Si?... — mezi belbëzova unë ngaqë m'u zu pështyma në fyt.

— Dy orë gjyq...Tani sa mbaruan...Ik tashti. Atë që ndodhi...le ta harrojmi. Bashkë nuk do të mësojmë më.

— Ela! — gati thirra unë. — Prit...

Dhe u bëra gati të kaloja kopshtin me mënë, përmes një shtegu të hapur prej kohësh. Por zëri i saj autoritar dhe i trembur njëkohësisht më bëri të ngrija në vend:

— Mös! Je në vete? Mos, të them!

— Si është puna, Ela?

— Ik, Gimi, se do të dyshojnë.

— Unë... të dua, Ela. Të dua vërtet.

— Mirë, Gimi, po mblidhe mendjen. Në shtëpi e pata pisk, dhe për fajin tënd. Apo s'të bëhet vodë ty?

— S'kam për t'ia harruar atij Bertit!

— Ik, Gimi. Zëre se s'ka ndodhur asgjë midis nesh.

— Si?! Nuk thua të vërtetën. S'ka se si.

— Shsht! Mos bërtit, se na dëgjuan të gjithë!

Ajo fërgëllonte si në ethe. Frymëmarrja e saj kishte diçka që të kujtonte trazimin e gjetheve të mollëve kur frynte flladi.

— Ik, Gimi. Natën e mirë!

— Po si...s'do të mësojmë më bashkë?

— Në shtëpi më thanë prerë: jo. Kanë frikë se mos ne.. ti...

Ajo e la fjalën në mes. Unë u mpiva i téri. Fytyra e Bertit më përsillej përpara syve dhe më shqetësonte.

— Pse erdhe, Ela?

— E dija që më prisje. Më vinte keq...

— Ah, të vinte keq! — i thashë me inat dhe, si ia kapa dorën, ia lëshova me forcë. Ajo ktheu kokën nga ana tjetër. Dukej se vuante. E merrja me mend se vuante shumë.

— Si éshtë puna, Ela, ç'ka Berti me ty?

Ajo u mendua një grimë e pastaj foli:

— Një ditë, në klasë, ai deshi të më... Po ik tani, ik!

Nuk di pse ngulmonte tē ikja unë i pari, kurse vetë nuk lëvizte. Qëndronte në errësirë gati e padukshme, si një mëze e shqetësuar, e gatshme pér tē rendur me shenjën më tē parë tē rrezikut. Unë isha në një mëdyshje: ta kaloja apo tē mos e kaloja shtegun.

— Natën e mirë, — tha ajo pér së dyti dhe pa pritur që t'i q ktheja përshëndetjen, iku me vrap, përmes drurëve.

Kopshti me mollë dremiste duke kundërmuar aromat e mrekullueshme tē pranverës. Kënga e trishtuar e zogut tē natës civik-civiik mbushte hapësirën dhe arrinte deri te veshët e mi e impreh-të dhe e hidhur, jehonë e pritjes së përjetshme, shpresëkotë.

Unë u shkunda. Dhe mora vendim: pér Elën, pér dashurinë tonë, duhej luftuar edhe me vetë Elën. Sepse ajo kishte frikë, frikë nga prindërit e saj, nga vetja.

Të nesërmen në mëngjes dola herët nga shtë-pia. Zura vend në një qoshe rruge dhe prita. Pas pak e pashë tē vinte. Por nuk ishte vetëm. Pér çudi tē çudive ishte...me Bert Plepin. Nuk desha tē më shihnin. Mora një rrugë tjetër pér në shkollë.

Gjatë konsultimit s'ia hodha sytë asnjëherë. Diçka sikur ishte krisur e thyer tek unë. Nuk mund t'i falja që ajo kishte pranuar fa shoqëronte Ber-ti.

Por më pas shikimet tona u ndeshën, madje

m'u ul në bankë. Më sqaroi se Bërti e kishte rruajtur kur kishte dalë nga shtëpia dhe ajo nuk kishte mundur t'i shmangej shoqërimit të tij. Po kryesorja ishte se ajo kishte vendosur të vazhdonte të mësonte me mua, fshehur mamasë. Nuk do të mësonim më në kopshtin e saj, por në shkollë. Edhe po ta merrte vesh mamaja (që me siguri do ta merrte), ajo do të vinte se do të vinte.

Kështu, disa pasdite në javë ne mësonim në shkollë. Për t'iu shmangur dyshimeve të kota hynim në ndonjë klassë ku kishte edhe të tjerë që mësonin e znim ndonjë qoshe. Unë isha i lumtur. Vërtet përreth nuk ishte gjelbërimi i kopshtit me mollë, por prania e Elës më bënte ta ndieja veten vazhdimi~~sh~~ si midis gjelbërimit, si midis freskisë e njomështisë së barit

Por një pasdite ndodhi diçka që, edhe pse e kishim menduar, e kishim harruar krejt; papritur në klasë hyri Neta, mamaja e saj. Për dreq ne ishim edhe fare vetëm. Vërtet që ishim duke mësuar, por kjo aspak s'do të ishte një argument që të na e lehtësonte «fajin».

— Ela, — bërtiti ajo, — s'ke turp që më gënjen?
Ela e shikonte si me frikë, e skuqur flakë në ftyrë.

— S'po të gënjej, mama. Ne po mësojmë.
— Po mëson! E shoh, e shoh! Hajde, çohu! Eja!
— Ku?
— Në shtëpi, ku?
— Jo, mama. Kur të mbarojmë. Kemi akoma.
Ftyra e Netës u bë e bardhë, si çarçafi. Sytë iu hapën, pastaj iu picërruan, si t'ia vriste një drtitë e fortë.

— Eja, të them! E pacipë! Je e vogël, mashalla, të të marr nga dora me zor?

Ela zuri të mblidhë librat e fletoret. Gishtat i dridhesin. Stilografi i ra përdhe e u thye. Ajo u ul, e mori, e pa të thyer dhe as i kushtoi vëmen-dje. E éma u tèrbua.

— E theve?! Domosdo... Pika neve, për ty...

Ela i kishte kyçur buzët.

— Dhe ti, djali i Sofisë, — m'u drejtua për herë të parë, — të lutem shumë, të lutem shumë, me çu-pën time s'ke asnë punë. Dëgjove? Ndryshe do të të vij në shtëpi e bile do ta ndjek edhe ndryshe!

Pas kësaj ngjarjeje ne nuk mësuam më bashkë. Ela filloi të mësonte me një shoqe të klasës në shtëpinë e saj, në dhomë. Megjithatë, kur takoheshim, bisedonim, por asaj i kishte humbur lirshmëria; më përgjigjej shkurt e si me frikë, por jo pa ngrohtësi. Një ditë i thashë se në mbrëmje e prisja te shtegu i kopshtit me mollë dhe se ajo duhej të vin-te patjetër.

Dhe erdhi. Ishte errur dhe qelli ishte mbushur me re të dendura. Gjithë pasditen kishte rënë shi dhe pritej të fillonte përsëri. Kopshti me mollë nxinte i téri, i zhytur në një heshtje të thellë, të lagësht. Kur dëgjova fëshfëritjen e hapave të saj, unë, ndryshe nga çdo herë më parë, u hodha drejt e në kopsht. Ela u tremb. Nuk deshi të afrohej, por iu afrova unë, i vendosur. Ajo e tronditit foli:

— Ç'bën, u marrose?

— Ela, — i thashë dhe e kapa nga dora, — nuk mund të rri pa ty!...

— Oh, Gimi, i lëmë këto tani.

Dukej e frikësuar, e mérzitur. Unë s'duhej të thosha asgjë që t'ia rëndonte atë gjendje.

— Po mëson mirë?

— Ç'ka. Jo si me ty.

— Vërtet mësoje më mirë me mua, Ela?

— Po, Gimi. Ti ke një aftësi të veçantë, të vështirën e bën fare të thjeshtë.

— C'e do, me ty s'po e bëj dot.

Nga shtëpia e saj u dëgjua zhurmë, zëra. Ajo u drodh. Dhe me të shpejtë më tha:

— Dëgjo, nesër do të mësojmë bashkë. S'më hyjnë në kokë disa gjëra.

— Ku?

— Në shkollë, ku? Ika. Natën e mirë!

— Dëgjo, Ela...

— Nesër në shkollë bisedojmë.

Dhe u bë erë. Unë qëndrova pa lëvizur. Përballë meje kopshti me mollë, dëshmitari dhe ndihmësi i vetëm i dashurisë sonë. Nuk vura re se kishte fillouar shiu. Ishte një shi i butë, i shtruar, shi pranvere, shi jetëdhënës. Gjethet e mollëve shushurinin butë, pëshpëritnin èmbël, këndonin ca melodi të fshehta, si melodi kujtimesh. Pika të mëdha kullo-nin nga gjethet e më binin në flokë, më lagnin ftyrën, trupin, e megjithatë nuk ikja; e kisha të pamundur t'i largohesha asaj lagieje pranverore, asaj shushurimës magjike të kopshtit me mollë.

Nga mesi i gushtit dolën të drejtat e studimit. Mua për matematikë, siç kisha kërkuar, kurse Elës për agronomi. Ajo u trondit shumë; thoshte se çdo gjë do ta kishte besuar, por, që t'i jepnin atë degë, kurre. Prindërit e saj bënë çmos t'ia ndryshonin degën, por s'u bë gjë.

Një ditë e pyeta se si do të bënte.

— Mua m'u mbush mendja, — tha, — por mama ja nuk do kurrsesi. Shfrym e ulerin sikur ka ndodhur hataja.

— Po a do të shkosh?

— Po s'u bind ajo, s'kam sesi.

— Po ti shko, — i thashë unë.

Ajo vuri buzën në gaz.

— Si të shkoj? Po të hollat? Duhen të paktën tri mijë lekë në muaj.

Kishte të drejtë; kjo s'më kishte shkuar ndër mend.

— E ndajmë bursën time bashkë, — i thashë i vendosur. — Do të bëjmë si të bëjmë.

Ajo në fillim qeshi, por, kur më pa mua krejt serioz, edhe ajo u bë serioze.

— Nuk bëhet ajo, Gimi, po rri.

— Jo, me gjithë mend e kam, Ela. Ti duhet ta vazhdosh shkollen se s'bën. Agronomia është e bukur. Singerisht të flas.

Por ajo nuk e ngau më atë bisedë.

Në 1 shtator fillova fakultetin. Nuk mbaj mend se për sa ditë me radhë shkova në Institutin Bujqësor për të pyetur nëse kishte ardhur Ela apo jo. Por çdo herë merrja përgjigje negative, madje një shoqe e klasës më tha se Ela nuk do të vinte.

Dasha t'i shkruaja letër, por ishte e pamundur, se do të binte në sy të prindërve të saj. Kështu aë shkova vetë. Bëra çmos që Ela ta merrte vesh ardhjen time. Me një çun të vogël i dërgova një pusullë, ku i thosha të takoheshim në kopsht.

Ajo erdhi. Mbrëmja ishte e butë, e ngrohtë, gjithë yje e dritëzime. Ishte vjeshtë e kokrrat e mo-

llëve zverdhnin, por ishte vjeshtë e parë, thuajse verë, kopshti mbante erë e njomishte, ishte i téri i gjelbër, i bukur e madhështor si dhe në pranverë. Ela më rrinte përballë dhe unë, i mbështetur pas trungut të mollës, e kundroja i përmallur. Ajo dukej e qetë, e çliruar nga ai farë ankthi që e kish-te munduar më parë.

— Domethënë vendose?

— Po, Gimi.

— Po paratë? Sido që të vijë puna, unë të kam thënë, Ela: jam gati ta ndajmë bursën bashkë.

— S'do të jetë nevoja, Gimi, — më tha ajo du-ke më parë në sy. Në sytë e saj kishte një dritë të ngrohtë, të bukur. Unë iu afrova më pranë; fytyra e saj ishte e mbushur me mirënjojhe. Ela e dinte se puna s'do të vinte kurrë që ta ndihmoja unë më të holla, por megjithatë më ishte njëlloj mirënjohëse. Se ajo e dinte që unë isha i singertë, se e bëja atë që thosha.

— Sa mirë bëre, Ela, — i thashë më të pësh-përitur.

— Të mos kishte qenë këmbëngulja jote, ndosh-ta s'do ta kisha vendosur, — tha ajo.

— Pse, c'bëra unë?

— Ke bërë shumë, Gimi. Shumë...Ti...je shumë i mirë!

— Edhe ti, Ela. Ti je vajzë e mrekullueshme. Edhe si agronomë, e mrekullueshme do të jesh!...

I afrova fytyrën pranë dhe buzët tonë u çikën. Koha, qelli, kopshti me mollë, gjithçka jashtë nesh e brenda nesh u shkri në një, mori formën e lumturisë, të një lumturie që s'do të njihte fund.

Një grindejo e zakonshme

Gori kapërceu një hendek të thellë, të mbushur me barishte të dendura, u ngjit në një sukë dhe hodhi shikimin në atë drejtim nga mendoi se mund të ishte fshati. Nata ishte e thellë, pa yje, një natë e mbushur me fishkëllimat e pikëlluara që krijonte era e acartë duke u fërkuar pas degëve të zhveshura të drurëve.

Djaloshi liroi pak gjalmin e pushkës, që i kishte zbritur deri te gusha, dhe mori frymë thellë. Përpjekja kishte qenë nga më të ashprat që mbante mend qysh se kishte shkuar në çetë. Ajo nuk kishte zgjatur më shumë se dy orë, por atij i ishte dukur se s'kishte vazhduar veçse pak minuta, aq shpejt ishte zhvilluar. I kishte mbetur në mend ngjarja e fundit kur ai, bashkë me xha Kason, kishin arritur të depërtonin prapa vijës së armikut. Ai ishte pëleshur trup me trup me dy ndihmësmitralierët, kurse xha Kasoja ishte vërvitur si një djalë i ri, mbi mitralierin. Ai mitraloz i mallkuar kishte kositur tre nga shokët dhe e kishte vonuar sulmin nga krahu i majtë për më shumë se një çerek ore. Xha

Kasoja kishte marrë pikërisht atë për t'iu futur një aksioni të tillë. Dhe ai e kishte justifikuar besimin e xha Kasos. Të atij plaku trim, që kishte mbetur aty.

Djali mori një rrugë të ngushtë, që gjarpëronte anës një kodre të butë, mbuluar nga një bimësi e zhveshur, e rrahir nga era dimërore. E ndjeu se po i afrohej fshatit. Malli e pushtoi të tërin. Një dallgë e fuqishme ia kapiti gjymtyrët dhe e bëri të ndalonte pak, sa t'i qetësohen në rrahurat e zemrës. Kishte njëmbëdhjetë muaj në mal dhe kjo tanë ishte hera e parë që kthehej në shtëpi. I kujtohej mirë ajo ditë kur kishte ikur. Ishte prill dhe natyra vezullonte nga shkëlqimi i diellit pranveror. Zjarri i betejave, netët pa gjumë, lodhjet nga marshimet e gjata, dhembja për shokët, nuk kishin mundur t'ia fshinin nga kujtesa atë pranverë lamtumire.

Shpejtoi hapat. Fshati flinte në qetësi të plotë, i harruar në atë skaj të botës, i mbrojtur vetëm nga velenxa e qiellit të arnuar me re të zeza e nga një hënë e zbehtë. Ja udhëzat e njohura, që i kishte bredhur këmbëzbathur, ja kasollja e Pilo Qorrit, muzikantit të verbër, ja edhe sheshi i vogël, tri rrapiet e mëdha dhe dy rrugët që ndahen: njëra që të shpie sipër, te kisha, tjetra te shtëpia e tij. Diku u dëgjua e lehura e një qeni, që u pasua shpejt nga të tjera, më të largëta. Lart në kodër një drithëzë e zbehtë dallohej në errësirën e natës si një sy i përgjumur.

Gori qëndroi përpara portës së madhe prej dru lisi, që e kishte ngritur ai me gjyshin dhe të kushëririn, Apostolin, apo Sollin, si i thoshin

shkurt, aty e tri mote të shkuara. Sapo iu kujtua i kushëriri, ndjeu një si therje në zemër. Ah, Solli, mërmëriti gjithë maraz. Na qenke bashkuar me Ballin! Paske rënë brenda nga ato gënjeshtrat e dënglat e tyre, nga ato fjalët e mëdha se edhe ata kanë dalë malit për liri e për atdhe, se edhe ata do ta luftojnë italianin... Si, more Solli, paskëshe qenë kaq sylesh e mendje firifiu?! Dhe në fis të kemi mbajtur për të mençur e trim! Të rruat mençuria e trimëria, na fëlliqe konakun, o i poshtër, haram!...

Gori trokiti fort. Pastaj thirri, një herë, dy, tri. Së fundi nga oborri u ndien zhurma, zëra, kërciti dera e hyrjes dhe nga e çara e portës ai pa një dritë të kuqërrreme të lëpinte hapësirën e hajatit të ngushtë. U shkëmbyen fjalët e para; kërkëllinë cérçivetë e hekurta dhe ai u gjend në krahët e xha Kozit, gjyshit të tij tetëdhjetëvjeçar, kockëfortë e ende trupdrejtë, që e puthi Gorin si dikur, kur kishte qenë fëmijë. Pak më pas një trup i njojmë e i butë, që fërgëllonte e dridhej si në ethe, u ngjesh pas tij; ishte e motra, Katina, vogëlushja pesëmbëdhjetëvjeçare.

— Trim i gjyshit! Ma jep pushkën!

— Mbahesh mirë, gjysh?

— Ç'ka, çka. Jo keq, nipçe. E kam zbutur pleqërinë, ia kam mësuar huqet.

Në hajat doli nëna, edhe ajo me kandil në dorë. Fytyra e saj e hequr dhe e pikëlluar, e vrarë ngajeta, ndriste e tëra; sytë, edhe pse të thatë e si të ngurosur, digjeshin nga një mall dhe dashuri e madhe.

Në korridor iu mblodhën rrrotull tre a katër ka-

lamaj, që i gjëzoheshin dhe i hidheshin përqark. Erdhi gjyshi që i përzuri e që pastaj, me çap të lehtë, si prej të riu, u fut në dhomën e zjarrit. Katina iu afrua përsëri dhe ai, si në endërr, ndjeu fjalët dhe frymën e ngrohtë të saj:

— Ka ardhur edhe Solli.

Gori u shkund i téri.

— Solli?!

— Po. Është aty.

— Ku?

— Në odën e zjarrit. Te ne.

— Mos, moj! Kur e pruri kokën?

— Në të errur. Është aty edhe Pilo Qorri.

Pranë tyre erdhi nëna. Në fytyrë dukej shumë e merakosur. Vetëm tanë e kuptoi atë farë reshtjeje që sikur i mbështollti njerëzit e shtëpisë, përvèç Katinës, me të ardhur ai. Nëna deshi t'i thoshte diçka, por u përbajt, sepse ballë tyre u dha nusja e Banit, xhaxhait të tij, të cilën e thërritin Nao. Ajo iu sul Grigorit gjithë përzemërsi.

— Të keqen Naoja! Si më je, o shpirt?

Ajo, trupmadhe sic ishte, e puthi pllaq-plluq, me zhurmë e si me inat, po Gori e ndjeu se e puthi me mall, pa shtirje.

— Hajde në odë, bir, — i tha nëna.

— Po...dua të lahém pak.

— Merr gjymin me ujë të valë, Katinë. Mbush vedrëⁿ me ujë të ftohtë!

Nëna dhe Naoja hynë në dhomë. Katina, e lehtë si flutur, solli ujin e ftohtë dhe vrapi për të sjellë të ngrohtin. Po Gori rrinte si i shushatur. Mälli i gjatë, i mbledhur në kraharor përmuaj e muaj të tërë, iu tret si vesa e mëngjesit. Gjithçka mori

tjetër ngjyrë. Shtëpia, ajo shtëpi e ngrohtë dhe e dashur në të gjata, tani i ngjante e ftohtë dhe e shkretë. Aty, disa hapa larg, në dhomën e zjarrit të shtëpisë së tij kishte ardhur edhe Solli, tradhtari. Ai, që para dy muajsh ishte bashkuar me çetën e horrave të Hasan Cenoziut. Sikur i ranë me një dackë ftyrës kur i dhanë atë lajm. «Ah, more Solli! Që të kam dashur aq shumë... Se si vëllezër e shkuar vëllezërve kemi qenë. Kemi luajtur, bredhur e ngrënë tok gjithë jetën, këmi bërë lloj-lloj çamarrokllëqesh, të mira e ndonjëherë edhe prapësira, po ashtu, tok... Njëzet e një vjet që të njoh e njëzet e dy që më njeh ti... Si binjakë kemi qenë, more Solli, që kam pandehur se të njihja mirë, siç njoh edhe veten time...»

Katina, te dera e qilarit, po i thërriste. Atë kohë doli nëna. Ajo iu afrua me të shpejtë dhe i tha me zë të ulët:

— Të keqen nëna, Gori, mos bëj ndonjë të pabërë!

— Mos ki merak, nënë.

— Yt atë nuk deshi ta qaste. Po hall më banë, tët gjysh!

— Mirë, nënë, mirë.

— Shko, shko në postrehë të lahesh!

Zëri i saj ishte i butë, i ngrohtë, i mbushur me dhembshuri, ashtu siç kishte qenë gjithmonë. Ai u shkund, vuri buzën në gaz dhe hyri në postrehën ngjitur me konakun e madh.

E motra i hidhte ujë të vakët duke çuçuritur pareshtur. I tregonte se si para ca ditësh në fshat kishin hyrë ballistët dhe kishin bërë batërdi e zullume, por në shtëpinë e tyre nuk kishin ar-

dhur. Nga Solli. Në sheshin e fshatit ballistët i kishin hedhur thumba babait për punën e Gorit, e madje një nga ata larot kishte dashur ta rrhitë, po kishte ndërhyrë një tjetër dhe pastaj komandanti i tyre, vetë Hasan Cenoziu, i kishte bërtitur ballistik. Se ai e kishte marrë me qejf Sollin. Ajo vazhdoi t'i tregonte se xhaxha Bani, atje në dajlan të peshkut, ku punonte, e kishte mallkuar Sollin dhe kishte thënë se nuk donte t'ia shikonte më surratin, po ja që giyshi e kishte qasur Sollin në shtëpi, madje kishte therur edhe kaposhin e kuq. Se giyshi thoshte se edhe Balli për të lufthuar të huajin kishte marrë dyfekun dhe kishte dalë në mal. Se edhe Balli, edhe komunistët, për vatanin luftonin. Ajo i tregoi pastaj se u kishte ngordhur viçi, se çatia e haurit ishte rrëzuar dhe se giyshi nuk hipte dot në të, kurse babai, i sëmu-rë siç ishte, nuk kishte fuqi ta rregullonte. I tha se xhaxha Bani vinte rrallë, i lodhur e i dërrmuar nga gjuetia e peshkut atje në dajlan.

Zëri i saj ishte i ëmbël e i ngrohtë, por, kur foli për Sollin, ai iu ashpërsua dhe Gori i ndjeu regëtimat e shpirtit të së motrës. E vogël ishte vërtet, por edhe ajo kuptonte.

Katina iku. Ai u vesh, ngjeshi gjerdanin, doli në mesore, ku mori pushkën e varur në mur, të cilën e hodhi në krah dhe çapiti për nga dera e dhomës. Ai qëndroi për një grimë. Nëna, me po atë pamje të merakosur, doli te dera dhe i tha të hynte. Ai mendoi që me siguri atë do ta kishte nisur giyshi për të parë përse po vonohej. Ajo e pa me habi, por nuk e pyeti përse e kishte hedhur pushkën krahëve.

Dhoma llamburiste nga dritat e dy llambave të mëdha me vajguri të varura në qoshet e oxhakut. Sa u dha te dera, vështrimi i tij i përfshiu të gjithë ata që ndodheshin në dhomë: gjyshin, shtruar këmbëkryq në qoshe, babanë, që rrinte shtrirë në qoshen tjetër, mbuluar me velenxë; pranë tij Pilo Qorrin, si gjithnjë, me atë mandolinën e vjetër në prehër. Përballë tij, pranë gjyshit, i kapar-disur, qëndronte Solli. Ai rrinte gjysmë shtrirë, mbështetur në dy jastëkë vënë pas murit dhe këmbë mbi këmbë. Te pragu i derës Gori mbajti hapin dhe qëndroi një grimë në mëdyshje, por forca e një inati të verbër e tërhoqi brenda. I dha dorën Pilo Qorrit dhe i foli me përmallim. Kishte shumë kujtime të bukura nga xha Piloja. Muzikanti ia mbajti kokën në kraharor dhe ngashërimi i atij plaku të mirë, që e njoihu djalin vetëm nga zëri, iu ngjit dhe atij. Pastaj i dha dorën gjyshit dhe në fund të atit.

— Mirë se erdhe, o trim, — i tha i ati dhe e puthi. Fytyra e tij e verdhë, prej të sëmuri, e pikëlloi djalin. Si e mori veten nga ajo dobësi e çastit, ai hodhi shikimin nga gjyshi. Atij i qeshnin systë ende të padobësuar nga pleqëria. Duart e thata, kockëforta, i lëvizte pareshtur.

— Eja, trim i gjyshit, ulu!

— Lëre, o Kozi, — i tha Pilo Qorri. Lëre të më ulet këtu.

— Hajde, Gori, hajde, — tha gjyshi pa ia vënë veshin kërkesës së Pilo Qorrit. — Eja ulu këtu dhe jepi dorën tët kushërirri. Apo nuk e sheh?

— E shoh, gjysh, e shoh.

Gori u ul midis të atit dhe Pilo Qorrit,

— Si më ke qenë, o bir? — pyeti i ati me zë
të dobët. — Si ke kaluar andej?

— Mirë, baba.

— Luftojnë këta, Llukan, luftojnë, — tha Pilo
Qorri.

— Qysh jo? Hasmi do luftuar, — u hodh gjyshi.

Në dhomë hynë nëna, Naoja, Katina dhe dy
tre fémijë. U bë pak zhurmë po shpejt ra heshtja,
një heshtje e ngrirë dhe e rënduar nga vështrimet
që njerëzit i hidhnin njëri-tjetrit me shqetësim.
Në dhomë, një frymë kërcënimi qëndronte pezull.
Gori hodhi shikimin nga Solli. Ai ende qëndronte
po ashtu, i rehatuar si ndonjë pasha. Pranë këmbë-
ve faqorja e rakisë dhe pjatat me meze. Dukej
se ia kishte qejfi ta mbante veten për burrë me
ato mustaqe si dy xhufka misri të zeza dhe me
atë shikimin prej fodulli që ia cingëriste nervat
Grigorit.

— Jepi dorën tét kushëriri, — i tha gjyshi Grigo-
rit, këtë radhë me një ton më urdhërues. — Apo
nuk dëgjove?

— Djali si të dojë, baba, — ndërhyri me të
shpejtë nëna.

Gjyshi nuk iu përgjigj asaj, por, duke e parë
Grigorin në sy, i tha për të tretën herë:

— Hajde, jepini duart njëri-tjetrit.

Grigori e kuptoi se me atë kërkesë naivë pla-
ku donte të parandalonte ndonjë ngjarje të papël-
qyer.

— Dora i jepet shokut e vëllait, o gjysh, e jo
huzmeqarit të armikut.

Gjyshi e shikoi me habi.

— Si the, huzmeqarit të armikut?!

- Po, gjysh, ashtu thashë.
 — Mbaje gojën ti! — iu hakërrye Solli.
 — Të keqen nëna, Gori!
 — Avash, nipçë, avash, — iu drejtua Gorit gjyshi. — Edhe Balli do t'u bjerë italianëve.
 — Jo, gjysh, jo. Ky... të ka gënjenyer. Ballistët sot luftuan krah italianëve, kundër nesh.
 — Gënjen! — bërtiti Solli. — S'është e vërtetë!
 — Ku e di ti? Apo mos ishe edhe ti?...
 — Prit, prit! — ndërhyri gjyshi. Dhe, duke zgjatur qafën e tij të hollë e gjithë rrudha drejt Gorit, e pyeti: — Luftuan krah italianëve, the? Kundër jush?
 — Po, gjysh.

Sytë e rrumbullakët, të rrudhur të plakut u turbulluan. Fjalët që po dëgjonte nga i nipi i ngjajnin të çuditshme dhe dukej se po lëkundej fort midis besimit dhe mosbesimit.

— Demek derdhën gjak shqiptari. Gjak vëllai... Po kësaj ç'i thua ti, o Pilo, — iu drejtua gjyshi muzikantit të verbër.

— S'më duket çudi, xha Kozi. Ai që del për të grabitur, me hasmin do të bashkonetë.

— Armiq jeni ju, more! — foli Solli dhe ktheu faqoren e rakisë. Dhe duke përtypur një copë mish vazhdoi: — Po kështu do ta quani Ballin ju, që të mbuloni veten.

— C'do të prisnim nga këta ne, gjysh, — vazhdoi Gori pa ia varur Sollit, — cilët kanë në krye këta? Bejlerët, Cenoziun, harbutin që e njohin të gjithë. Qysh do ta luftojnë këta italianin, o gjysh,

kur mbajnë shpresë të lëpijnë ndonjë kockë nga ai?

— More, Gori, — hungëroi Solli, — ti ma di kokën! S'duroj shumë unë!...

Dhe ktheu faqoren; piu disa gllënjkë.

— Mjaft pive! — i foli me inat gjyshi.

— E shikon atë pushkë, o gjysh? — vazhdoi Gori. — Është e një plaku që na u vra sot. Na u vrannë edhe të tjerë, po me të unë isha lidhur shumë. Në moshë të babait ishte. Xha Kaso i thoshim. Fëmijë nuk kishte, po nipër e mbesa plot. Luftoj që ta gjëzojnë ata lirinë, thoshte. Që ta gjëzojë populli...

Zëri i Gorit ishte i ngrohtë, i mbushur me dhembje e krenari.

— Sa për trima, ne shqiptarët jemi, dihet ajo, — foli Llukani që, ashtu pa fuqi si ishte, më shumë dëgjonte se merrte pjesë në bisedë.

— Këta janë trima dhe të mençur, — iu përgjigj Pilo Qorri dhe zgjati dorën për të prekur kokën e Gorit.

— Të mençur këta, more Pilo Qorri?! — shfryu Solli. — Do të thuash të mençurit e komunizmës, të rusit?

Gori u ngrit. Ai i dha të kuptonte gjyshit që, edhe pse ishte në shtëpinë e tij, nuk do të rrinte aty në qoftë se nuk do të ikte Solli.

Plaku e ndjeu veten ngushtë. Tani s'kishte nga ia mbante: zgjidhja i takonte atij. Ai trazoi zjarrin pa e pasur mendjen, dukej se mendohej.

— Prit, Gori, — foli së fundi gjyshi. — Mos u rrëmbe.

— Pér ne tē dy nuk ka vend nē këtë shtëpi.
O unë, o ai.

— Fjalë me vend, — tha Pilo Qorri.

— C'thua, Pilo, se dhe ti je i rrashur: tē jetë hedhur vërtet Balli kundër vatanit?

— Tyke qenë krah tē huajit, janë dhe kundër vatanit, o Kozi. Duan tē huajin që mos u ikë kamxhiku nga dora. Kamxhiku sjell flori. Kështu them unë.

— Po ti, Llukan, c'thua? — iu drejtua plaku tē birit.

— Yt nip dhe im bir thotë tē vërtetën, baba.
Ai s'na ka gënjer kurrë.

Llukanin e zuri kolla. Plaku iu drejtua Sollit:

— Ti, Solli hiqma atë qylaf!

Solli drejtoi trupin, shtyu pjatat dhe rrokullissi faqoren e rakisë.

— Si the?

— Hiqe qylafin, tē thashë. Me ballin s'ke më punë!

Solli u ngrit ngadalë, i ndezur e i egërsuar.

— Gjysh, jo deri këtu...

— Flake qylafin, tē them! E vure nē kokë, u bë ajo, iku, po tani unë them kështu. Hiqe qylafin!

— Jo, — sokëlliu Solli. — Mos i kam buzët akoma me qumësht?

Ai rregulloi qylafin nē kokë, gjerdanin, koburen që i varej nē brez dhe, si i dha gioksit përpara, i vështroi tē gjithë me përbuzje. Vetëm tani Gori e vuri re veshjen e tij: çizme, xhaketë meshini tē zezë, kilota kaki dhe dy gjerdanë kryq e tërthor kraharonit.

— Këtë, o Gori, nuk kam për të ta harruar, —
tha Solli dhe doli nga dhoma.

— Do bësh mirë, — ia ktheu i qetë Gori.

Katina vrapoi tek i vëllai, i mori pushkën dhe
e vuri te këndi i dhomës. Gori u ul pranë gjyshit.

— Sill ca dru, ti, keçe, — i tha gjyshi Katinës,
— dhe ca raki, ti nuse! Nga ajo e forta.

Jashtë kishte aguar.

Natë kujtimesh

Eshtë e treta pusullë që më dërgon brenda këtyre ditëve që kam ikur nga ti dhe banoj në shtëpinë e prindërve. Edhe unë ndiej të kem një shtytje të fortë pér të të shkruar dhe pér këtë s'do të më mjaftonin shumë e shumë faqe. Por do të shkruaj sa të mundem dhe ashtu si mundem. Do të doja ta nisja me fjalën «i dashur» në krye (e cila grua që e dashuron burrin nuk do të donte?...), por nuk mundem, dora me ngec dhe zemrën ma shtrëngon pezmi.

Janë orët e vona të natës dhe gjithë bota ka rënë në qetësi. Qetësi e thellë. Njerëzit që gjatë ditës janë lodhur, tanë flenë.

Fle edhe vajza jote dhe imja dhe ndoshta në ëndërr shikon babin e saj të dashur. Babin e dashur që gjatë gjithë jetës së saj trevjeçare më shumë e pa nëpër ëndrra, sesa në të vërtetë. Por... babai është baba dhe pér fëmijën ai gjithnjë mbetet i dashur.

Vetëm unë nuk mund të fle. E lodhur nga punët në shkollë, se pata mësim edhe pasdite, dhe nga

përkujdesjet për Elonën, që ka qenë e sëmurë, por mbi të gjitha e shqetësuar nga mendimet nëse ia vlen të hedh në letër gjithçka që më zien në tru dhe në zemër për jetën tonë bashkëshortore, hodha tej ngurrimin dhe iu futa kësaj pune. Këtë e bëra vetëm e vetëm që ty mos të brejë shqetësimi se jam treguar e padrejtë ndaj teje. Po jo vetëm kaq. Duke shpërfaqur dhembjen time, do të përpinqem njëkohësisht të sistemoj edhe diçka, sado të vogël, në atë pështjellimin tënd që ti për herë të parë po e pohon tanë. Kurse në të vërtetë ai ka nisur të bëjë krye e të ushtrojë pushtet mbi ty qysh vitin e parë të martesës sonë.

Të martesës sonë...që ishte aq e bukur. Ndërsa lumturia ime qe aq e madhe, sa më mirë të mos e kisha ndeshur, sesa të ndieja tanë boshllëkun e humbjes.

Dikur më thoshe se së bashku ne do të njihnim vetëm një ndjenjë, gjëzimin. Dhe unë të besoja. Të besoja ty, dashurisë, vetes sime. Si të mos besoja? Dashuria është edhe besim. Pa këtë them se ajo kurrë nuk mund të kuptohet.

Ti më shprehe dashurinë, por unë nuk vendosja. Dhe jo pse s'të dashuroja. Por sepse, ashtu si e kuptoja unë atëherë jetën, e kisha të vështirë të ngrihesha mbi mentalitetin tim: për ty nuk don-te as im atë, as im vëlla.

Nuk e harroj kurrë se atë mbrëmje, kur të dhashë fjalën, kur pohova se edhe unë të dashuroja, ti shkëlqeve i téri, sikurse edhe unë. Sepse dashuria, them, është nga ato ndjenja të thella, që të mbush me aq shumë dritë. Ishte dashuria që na bëri, atë mbrëmje e më vonë, të rrëzëllonim...

Ndonëse ti nuk kishe nevojë për atë rrëzëllitje, sepse ishe i pashëm dhe tërheqës për sytë e mi. sepse ishe ti ai, dhe askush tjetër, që unë kisha filluar të dashuroja.

Eshtë e vërtetë që më tërhoqe me shikimin e parë, por në dashurinë time për ty unë nuk u nissa vetëm nga ana e jashtme. Ishin një grumbull arsyesh: mënyra jote e vecantë e të folurit, e rrjedhshme e plot figura, edhe pjekuria e mendimit për jetën e për njerëzit, humor i... me një fjalë gjithçka e vecantë që e kishe vetëm ti. Krijova bindjen se ti i njihje më mirë jetën e njerëzit dhe do të mbështetesha e sigurt tek ti, sepse ti ishe më i gjerë se unë, kapje më shumë gjëra. Të dashurova, veç mos kujo se të adhurova.

Atë mbrëmje m'u lute që të më merrje në shtëpinë tënde për të më njobur me prindërit e tu. Me prindërit e tu, të cilët ti i adhuroje. Me nënën tënde dhe me babanë tënd të moshuar, inxhinierin e shquar mekanik. Të më njihje gjithashtu edhe me dy motrat e tua, të cilat, edhe pse të martuara, rrinin pothuajse në shtëpinë tënde. Unë nuk e pranova propozimin tënd. Dhe kuptohet, që s'kisha si ta pranoja, përderisa prindërit e mi nuk ishin dakord për ty. Ti atëherë më kërkove të shkonim në shtëpinë time, të të njihja unë me të mitë. Por unë e kisha edhe më të vështirë.

Edhe atë natë, edhe shumë kohë më pas ti më kërkajoje shkaqet përsë prindërit e mi nuk të donin ty. Unë nuk të dhashë shpjegim të qartë, sepse nuk doja të të fyeja, pavarësisht se vetë fakti në njëfarë mënyre për ty ishte fyes. Madje për ty ishte fyes edhe i vjetruar, dhe mendimi që një

vajzë t'i vërë në dijeni prindërit kur njihet me një djalë dhe të marrë pëlqimin e tyre për ndonjë hap të mëtejshëm.

Sidoqoftë gjithçka përfundoi ashtu siç deshëm ne. Unë, vajza e poçarit, apo e qypabërësit, hyrà nuse në shtëpinë e inxhinier Kumanit, duke bartur me vete, siç u shprehën motrat e tua, vetëm një vleftë, bukurinë. Vetëm babai yt gjëzoi, kurse nëna dhe motrat e shumë nga farefisi yt buzëqeshnin si me zor e u përgjigjeshin urimeve të dasmorëve sikur t'u përgjigjeshin ngushëllimëve. Një dasmë ku urimi i ngjan ngushëllimit është si ajo dita që gdhihet e mbushur me re.

I vetmi ishe ti që rrezatoje aq gjësim e lumturi, sa mua filloj të mundonte një ndjenjë faji: mos nuk isha e denjë për të ngjallur tek ti gjithë atë lumturi? Ndaj dhe unë isha si e nemitur, e mpirë, jo sepse dashuria për ty nuk më mbushte me lumturi, sikurse edhe ty, por sepse atë mbrëmje për herë të parë unë ndjeva një shqetësim që më kapte kur mendoja se në sytë e të tjerëve nuk kisha kurrfarë merite për të zënë një vend të atillë nderi si, bie fjala, të jesh nuse e atij djali me kaq merita, bir i asaj familjeje me aq e kaq merita etj.

Kur hymë në dhomën tonë, aty nga ora 3 e mëngjesit (hareja ende vazhdonte e pandërprerë), ndërsa unë u plasa në një karrige e dërrmuar siç isha nga lodhja, t'i m'u afrove, më ngrite pakëz kokën dhe më vështrove në sy. Por mua më ishte errësuar shikimi, sepse lotët e mi, të fshehur deri atë kohë diku thellë, më shpërthyen papritur dhe u mbyta në dënesa. As fjalët, as lutjet e as dhetet e tua për një kohë të gjatë nuk arriten të më

qetësonin krejt. Ishte e para herë që pësoja një tronditje të atillë gjatë gjithë jetës sime njézete-dyvjeçare.

Megjithatë dashuria jote ma ktheu sigurinë, që aq shumë i duhet lumturisë për të qenë e plotë. Ditët e para pas dasmës rrodhën të mbushura me atë bukuri dhe dritë që është e aftë ta krijojë vetëm dashuria. Në shtator unë fillova punën në shkollë dhe, duke iu kushtuar në një pjesë të mirë punës së përditshme me nxënësit, e largoja mendjen nga ai qëndrim i ftohtë e përbuzës që gjeta në shtëpinë tënde, sidomos nga motrat e tua. Ato ndikojnë në njëfarë mase edhe te nëna jote. E megjithatë qëndrimi yt ishte kryesori, e ndoshta gjithçka do të kishte shkuar në rregull po të mos kishe filluar të ndryshoje ti. Gjithçka tjetër mund ta kaloja anash apo ta kapërceja me durim, por qëndrimin tënd, nga dita në ditë të tjetërsuar, kurresesi jo. Sepse vetëm ti, afërsia dhe dashuria jote më mbanin mua në atë shtëpi.

Qysh muajt e parë ti fillove të vije vonë e më vonë në shtëpi. Nuk them se vije i mërzitur apo se tregoheshe i ftohtë, por mungesa jote e gjatë ma kishte ndrydhur aq shumë shpirtin, saqë s'e ndieja veten të aftë për t'u çelur e për t'u gëzuar. Ti kishe shumë punë në uzinë, se atje ju ishit duke përgatitur disa projekte për tipa të rinj makinash bujqësore që kërkoheshin me ngut. Në bisetat që kishim bërë, — dhe ti kishe qejf që mjaft nga problemet e punës t'i bisedoje me mua, gjë që, s'kam si e fsheh, më kënaqte pa masë — unë dija se shokët e tu të punës kishin mbështetur shumë shpresa në aftësitë e tua si inxhinier, autor i di-

sa shpikjeve. Krenohesha me ty, ishe aq i ri dhe aq i zoti. Edhe të tjerë e pohonin: puna jote si inxhinier ishte e shkurtër, as pesëvjeçare, në krahasim me të tjerë më të vjetër në uzinë, e megjithatë ti kishe aftesi të rralla për të krijuar vazhdimisht gjëra të reja e të bukura. S'ka dyshim, kjo ishte një dhunti. Mbi të gjitha ti kishe vullnetin dhe zellin për ta zhvilluar atë. Kushedi sa herë kishte ndodhur që unë të zgjohesha natën dhe të ta hiqja librin që të kishte rënë mbi fytyrë. Dashuria për punën te ti ishte gjëja më e bukur.

Rrokullisja e marrëdhënieve tona filloj qysh atë natë kur unë u shtrova në maternitet. Ishte vonë, e mua kishte kohë që më kishin nisur shqetësimet. (Babai yt kishte rrëth dy muaj që kishte vdekur.) Nëna dhe motrat e tua më thanë të nisesha me to, por unë ngula këmbë: jo e jo. Bashkë pothuaj kishim ditë që s'ishim parë. Ti e dije në ç'gjendje isha e megjithatë nuک ishe kujtar ndonjëherë të më pyesje si e ndieja veten, të më jepje zemër. Sepse unë kisha frikë nga lindja, shumë frikë. Ty ndoshta as që të shkonte mendja se unë mund të kisha frikë, dhe për këtë s'të vë faj, por sidoqoftë diçka duhej të kishe marrë me mend. Unë dëshiroja (gjithnjë kisha ëndërruar për këtë) që të më çoje ti në maternitet, sepse më ishte ngulitur që, po të më çoje ti, gjithçka do të shkonte mbarë. Ndoshta se ishte lindja e parë. Gjë e kotë, vërtet po ja që ndodh. Është dëshirë e lashtë, e natyrshme, qëjeta të vijojë rrjedhën e vet pa hapur plagë. Para se të kapërceja atë prag, unë doja të mbaja në zemër urimin dhe fjalën tënde, sepse edhe ti doje që ne të bëheshim tre...

Po ti nuk erdhe. Najda më çoi në maternitet. Edhe kur lindi Elona, unë përsëri të përfytyrova ty. Atëherë e ndjeva sa fort kisha pasur nevojë për shikimin e syve të tu, për buzëqeshjen e fjalën tënde.

Kohët e para pas lindjes kaluan shpejt, të mbushura me mijëra përkujdesje pér foshnjën, që me praninë e saj u dha shtëpisë dhe ëndrrave të mia një dritë të re. Ato kohë pér mua ishin të mbushura me gjëzimin e amësisë, që zbeh e çngjyros gjithë ndjenjat e tjera. Nisi të më topitej dëridiku pakënaqësia që më shkaktohej kur ti përsëri vije vonë në shtëpi. Megjithatë kishte edhe raste që pezmatohesha nga ndonjë romuz i nënës. (Ti kurrë s'e more mundimin, t'i hyje kuptimit të këtyre marrëdhënieve. Pa u thelluar, gjithnjë fajin ma hidhje mua. Por gjyko: A kisha faj unë që tani, lehonë, nuk mund t'u rrija dot mbi kokë, si më parë, punëve të shtëpisë dhe të përkujdesesha si më parë pér nënën tënde, që vuante nga aq e aq sëmundje? Ku ishte ndihma e atyre motrave të tua aq «të dhembshura», që tani vinin te ne vetëm pér të dhënë urdhra e pér të komanduar?)

Dy javë kishin kaluar nga lindja e Elona, kur midis nesh ndodhi e krisura e parë, pér punën e këmishës sate. Ti këmisha kishe plot (e ç'veshje nuk kishe ti me tepri), por ato ishin bërë të gjitha të palara. Një javë apo më tepër unë kisha ndenjur e dergjur në shtrat me temperaturë. Ti e dije se c'lindje të vështirë pata. Elona tërë ditën nuk kishte pushuar së qari. Edhe unë po tërë ditën isha marrë me të e me miekimin e puçrrave të saj, që i kishin mbushur trupin. E veç kësaj, sa e zin-

te gjumi, laja ndonjë plaçkë të saj, ashtu, duke m'u dridhur gjithë shtati. Ti erdhe si suferina dhe hyre drejt e në kuzhinë. Për të ngrënë s'deshe; kërkove vetëm një kafe dhe the se pas pak do të shkoje për të festuar ditëlindjen e drejtorit, që do ta bënte të madhe, se mbushte dyzet e pesë a pesëdhjetë vjeç dhe, sa i dhe fund kafesë, më kërkove një këmishë. Unë të thashë se nuk kishte të larë, por, e shqetësuar natyrisht, për veshjen tënde, të thashë të vishje, në vend të këmishës, njérën nga bluzat golf. Të thashë se ai golfi i hollë ngjyrë hiri të shkonte shumë, për shembull, me kostumin bojë kafe. Po ti nuk pranove. Dhe jo vetëm kaq, po nise të bërtitje. Në fillim jo fort, por fjalë pas fjalë, pas çdo përpjekjeje që bëja unë për të të bindur, me të butë, që edhe pa këmishë do të dukeshe i veshur me shije, ti fillove ta ngrije zërin. Unë u ngrita të shkoja te vajza, po ti më kape nga dora dhe më mbajte në vend. Ndjeva një dhembje therëse te kyçi i dorës. Me zor e mbajta veten të mos bërtitja. Duhej të isha bërë dyllë e verdhë. Ti i kishe sytë të ndezur nga inati dhe vazhdoje të bërtisje, të më shaje, të më fyeje. Unë në mënyrë të par-vetëdijshme ktheva kokën nga vendi ku zakonisht rrinte babai. (Ai kishte vdekur, po mua m'u duk se do të të fliste ty, do të hidhej e do të më mbronte. Sepse, kur ndodhë të më thoshte ndonjë fjalë pa takt ndonjëra nga motrat e tua zakonisht Najda, ai hidhej e më mbronte. Ai kishte zemër të madhe dhe për humbjen e tij unë kam qarë ashtu sic do të kisha qarë edhe për babanë tim.) Por... në vendin ku rrinte ai, te divani pranë dritares, tani rrinte këmbë mbi këmbë, duke pirë duhan,

motra jote e vogël, Najda. Pranë saj, në kolltuk, rrinte nëna, me pamje të shqetësuar. Ndërkaq Najda foli. Më foli e më foli Najda, pikërisht ajo që vete s'i fuste kurrë duart në ujë (sepse i acarohej reumatizmi!) e që kishte kthyer në shërbyese vajzën e saj dymbëdhjetëvjeçare e shpesh edhe të shoqin, atë Rustemin e butë e shpirtmirë. Ti ma shkunde dorën me téré fuqinë dhe ma lëshove me forcë pas murit. Unë prita, gojëkyçur, që të më jepje edhe shpulla fytyrës, por atë ditë ti nuk arrite deri aty. Shkova në dhomë e mbëtur në lot dhe nisa të merresha me vajzën. Pas pak erdhe ti. Pa më folur, pa më hedhur madje as sytë, nise të visheshe. Dhe u veshe pikërisht ashtu si të kisha thënë. Te dera u ndale e më the se do të vije vonë. Asnjë fjalë më tepër. Unë shtrëngova vajzën në gjoks. Ajo pinte e dukej sikur shikonte nga ti. Por ajo nuk shikonte askund, sepse s'ishte më shumë se dy javëshe.

Të nesërmen nëna u keqësua nga tensioni dhe ndenji shtrirë në kuzhinë. Motrat e tua, Najda e Landa, sapo kishin pirë kafet e pasdarkës. Unë kisha vënë vajzën në gjumë dhe hyra në kuzhinë. E ndjeva menjëherë fryshtë e ftohtë. Sidomos te Najda. Kurse Landa ishte ndryshe. Tregohej e afërt dhe e dashur me mua kur tek ajo fliste vetja e saj, dhe e largët, disi e huaj, kur fliste zakoni. Por jo rrallë më trajtonte edhe si motër. Edhe kur mbante ndonjë qëndrim të çuditshëm me mua, krejt ndryshe, bie fjala nga ai, i një dite më parë, unë e kuptoja; ishte prania e Najdës që ia diktonte atë qëndrim, se nuk donte t'ia prishte asaj. Se Najda e kishte përcaktuar një herë e përgjithmonë qëndrimin ndaj me-

je, gjithnjë e gatëshme në çdo rast për të më dhënë leksione, për të më mbajtur vazhdimisht me mësimet dhe këshillat e saj në lartësinë e detyrës si amvisë dhe si grua e mirë e vëllait të vetëm. Edhe atë ditë e gjeti rastin: kisha harruar t'i jepja nënës ilaqet në drekë. Unë paskësha bërë një gabim fatal, të pafalshëm. Dhe jo se nuk e dija, por nuk dojatë vlerësoja seriozisht sëmundjen e nënës. Asaj néné aq të lavdishme, zonjë grua, që kishte lindur, irritur e edukuar fëmijë të atillë...meritat e të cilëve i njinte gjithë qyteti. «Mirë, thoshte Najda, le të mos e vlerësojë atë si njeri», fundja atyre aq u bënte, se unë veten tregoja, por të paktën të kisha aq sens humanizmi sa të mos e çoja veten, dashje pa dashje, deri në krimin e rëndimit të sëmundjes... duke e zvarritur mjekimin, kur edhe për një njeri të panjohur unë duhej të kisha bërë të kundërtën, e të tjera e të tjera. Me një fjalë unë gati kisha guxuar të vrisja nënën. Po ndërhyri Landa dhe Najda e frenoi vrullin. Atë kohë erdhe ti. Unë rrija në kuzhinë, me kokën ulur. Sapo e more vesh përse bëhej fjalë, ti e çove më tej, duke më folur edhe më rëndë. Më the se unë edhe gjatë sëmundjes së babait nuk kisha treguar kujdesin e duhur për të, se në familjen ku isha rritur, ndoshta nuk ishte zakon të vlerësohej seriozisht një sëmundje e gjérat liheshin të rrakulliseshin si të donin, po tek ju ishte ndryshe, dhe ishte detyra ime të mësohesha me ato zakone, t'i respektoja e t'i zbatoja pikë për pikë. Kuptohet, Najda mori vrull të ri, por në anën time edhe Landa e ngriti zërin më me forcë. Pak fliste ajo, por tregonte më tepër logjikë se ju të dy. Përsëri, thek-

soi Najda, dhe e miratove ti, se unë isha e prirur, pér shkak të një kryeneçsie të pashpjegueshme, të mos i zbatoja këshillat tuaja të vlefshme pér mirëmbajtjen e shtëpisë, të foshnjës dhe të burrit, pér mungesën e taktit në sjellje: pér shembull, nuk cohesha në këmbë kur vinin motrat e tua, apo rrija e ngrysur në fytyrë... (A kisha vallë mundësi të buzëqeshja kurdoherë e para kujtdo, aq më tepér kur isha aq e lodhur dhe e dërrmuar nga punët e shtëpisë, nga kujdesi i pandërprerë pér një foshnjë dhe një plakë të sëmurë, nga të bërit e pazareve, pér të cilat ti s'kujtoheshe kurrë?...)

Hiq vërejtjet pér kujdesin ndaj Elonës, ti pér gjithë të tjerat ose heshte, ose i pranove. Përgjithësisht ti ishe i prirur të pranoje çdo gjë që thoshte Najda, kurse Landa, pér ty, s'ishte aq e ngritur sa ajo. Sepse nuk ju vinte juve të dyve pas avazit. Kurse në të vërtetë Landa, edhe pse një punonjëse e thjeshtë banke, ishte shumë më e gjerë dhe më e ngritur se Najda. Ti kishe besim të verbër, të patundur, edhe në gjykimet e qëndrimet e nënës sate ndaj meje. Pér marrëdhëniet e mia të përditëshme me të nuk do të zgjatem këtu, sepse e di që gjithsesi s'do të mundem të të bind pér asgjë. Duhen faqe të tëra. Megjithatë unë nuk i vë faj asaj. Ndikonin shumë tek ajo mosha, sëmundjet e, mbi të gjitha, bindja se do të mbetej gjithë jetën «zonjë».

(Gjithë këto që më vlonin në shpirt, i bisedoja me Irenën, që ti e njeh mirë. Bisedonim në pushimin e gjatë apo në ndonjë orë që e kishim pushim të dyja. Ajo më dëgjonte, më këshillonte, më qëndronte si motër. Pikërisht ajo Irenë, që ti

e quaje të cekët, pa interesa, interesohej për gjithçka që kishte të bënte me njeriun. Ajo më jepte zemër dhe kujdesi i saj më shpëtoi disa herë, për të mos rënë në dëshpërim të thellë.)

Sidoqoftë gjërat nuk u rrrokullisën teposhtë aq shpejt sa do të kishin dashur njerëzit e tu. Nëse martesa jonë qëndroi në këmbë edhe për aq kohë sa qëndroi, kjo qe pér shkak se herë-herë ti shkundeshe nga trulloja, e flakje tëj atë mbishtresë të imponuar dhe bëheshe ai që kishe qenë, i dashur e i afërt. Të rralla vërtet, por kanë qenë çaste të paharruara ato kur, ti hapje derën e dhomës sonë dhe, ashtu siç vije nga puna, me ato erërat e vajit e të grasos (që pér mua ishin të mrekullueshme sepse ishin të tuat dhe më kujtonin dashurinë tme të parë e të fundit, ato takimet tonë të fshehta) më afroheshe, me përkëdhelje. Jo, ato nuk mund të ishin kopje e ditëve të dikurshme. Sepse lumturia është e vetmja gjë që nuk mund të kopjohet. Ajo vazhdimisht buron e rrjedh dhe, siç thonë, uji që rrjedh bëhet gjithnjë e më i pastër. Jo, unë e ndieja, isha e sigurt me gjithë fuqinë e shpirtit se ato çaste ishin dashuria vetë, e gjallë dhe e vazhduar, që buronte nga zemrat, pa pasur nevojë për kujtime. Dashuria rikrijon veten gjithnjë në formë më të lartë e më të bukur.

Por mjerisht ato çaste qenë të rrallë. Gjithçka nisi të pështjellohej keq e më keq në marrëdhëniet midis nesh, kur ti u zhyte përfundimisht dhe krejtësisht vetëm në punën tënde. Edhe tanë të them se unë u gëzova me gjithë shpirt që ti nise të studioje gjithnjë e më tepër literaturë për prodhimin e një makine të re bujqësore. Ishte e qartë

se puna që ti i ishe futur kishte të bënte me pasionin tënd, me aftësitë e tua, me ëndrrën tënde, që një ditë edhe ti të nxirrje gjëra të bukura nga duart e tua. Që nga koha që kur të kisha njohur, nuk mund të të kuptoja pa atë pasion. Dhe kur një ditë më the se së fundi, pas aq e aq mundimesh, kishe arritur që bashkë me grupin e punës ta konkretizoje tipin e makinës së re që do të prodhonit, unë u gëzova me gjithë shpirt. Ty mbasë s'të kujtohet. Atë mbrëmje unë kthehesha nga çerdhja me vajzën në krah, kur ti na arrite në rrugë. Ishte vjeshtë, frynte një erë që vërtiste në ajër gjethë të rëna pemësh. Pasi më fole gjatë se ç'kishit diskutuar në byronë teknike, ti i re me këmbë një gjethëje të tharë dhe the: «Kështu do të fishkeshin edhe ëndrrat tona, po ta shkëputnim veten nga pikësynimi, nga pasioni ynë. Telk unë një gjë e tillë s'do të ndodhë kurrë...» Unë të shihja e mallëngjyer. Dhe me gjithë zemër të urova sukses. Vallë cila grua, që e dashuron burrin me shpirt, nuk do të gëzohej rër sukseset e tij?

Por më pas, në pasionin tënd, me dhembje nisa të vija re diçka fort të hidhur: në zjarrin e tij ty të shtynte jo dashuria për punën, për krijimin, por diçka tjetër, ambicia e sëmurë për karrierë. Për t'u bërë kryeinshinier, siç u shprehe një natë. Deri me parë unë kisha jetuar me ndjenjën e respektit të thellë e të sinqertë për pasionin tënd, për lodhjen, ëndrrat, pagjumësinë dhe shqetësimet e tua të vazhdueshme; kisha ndier, sikur ta jetoia vetë, gëzimin e kriimit, bukurinë që të fal përfytyrimi i asaj që nesër do të lindë... Gjithçka e bukur që kisha vënë re në marrëdhëni e tua

me punën m'u zvordh e m'u çngjyros. Më trullo-si zhgënjimi i hidhur; me një dritë tjetër u veshe ti; puna, pasioni yt i veçantë për të nuk paskësh qenë qëllim, por mjet për të arritur një qëllim! Veçse këtë të vërtetë ti kurrsesi nuk doje që ta merrnin vesh të tjerët. Dhe nëse m'u shfaqe, e bëre se doje të dije nëse unë do ta miratoja këtë lloj egoizmi apo jo; nëse dilte kështu, mirë, do të më kishe krah për të mbështetur një ambicje të tillë; nëse dilte e kundërtat, s'prishte shumë punë, nga kundërshtimi im s'do të vinte kurrë ndonjë e keqe, se mendoje që kur të arrije suksesin e ëndërruar, këto përpjekje titanike nuk mund të mos përligjeshin në sytë e mi.

Disa mbrëmje më vonë, pasi m'i kishe shprehur hapur pikësynimet e tua, më the: «Im atë ka qenë mekaniku më i zoti i qytetit. Vërtet kishte mbaruar një shkollë me emër në Evropë, por s'ishte e gjitha kjo, kryesorja ishte dhuntia që kishte. Megjithatë, të shquhesh kur askush s'të konkurron, s'është ndonjë zotësi kushedi cfarë; gjithë puna është të shquhesh kur rrëthohesh nga konkurrentë...» Duket qartë sa të kishte verbuar ambicja, e vëtmja forcë që të vinte në lëvizje. Ndërkaj për ty unë isha pengesë me kundërshtimet dhe ankesat e mia, por dhe ndihmë sepse çdo gjë ta bëja gati. Nga nëna s'prisje asgjë dhe s'mund të prisje. Ishte ajo që kishte nevojë për ty, për prani-në tënde, e megjithatë s'bënte zë. Cila qe nënë dhe s'u sakrifikuva?

Megjithëse e dija që do të vonoheshe, çdo pas-dite të prisja, rrija me shpresë se nga çasti në çast do të vije, prandaj nga mamaja shkoja rrallë, më

shumë shkoja nga Hajria (ti zor se e njeh komshien e katit të katërt), së cilës ia pëlqej bisedën. Ajo është gazmore dhe shpesh më bënte t'i harroja pér pak kohë hallet që kisha. Mirë unë, po vajza që të priste e të priste? Me ditë të tëra ajo nuk të shikon-te, por tashmë ajo kishte filluar të rritej dhe të përmallohej pér ty, pér babin e saj. Por as pér të nuk kujtoheshe shumë, vetëm kur hyje në dhomë të bin-te ndër mend se kishe një vajzë. I afroheshe të shtrati, e puthje pak në faqe e aq. Vallë, nuk mund të ktheheshe nga puna të paktën dy-tri mbrëmje në javë më herët, sa pér t'u çmallur me vajzën?

Gjeta rastin dhe hapa një bisedë me ty. Ishte fund vjeshte dhe binte vazhdimisht një shi i ftohtë, që ndihej deri në dhomë. Ti hyre me dy libra në duar, u zhveshe shpejt e shpejt, ndeze abazhurin e nise të lexoje. Pér vajzën as u kujtovë t'i hidhje sytë. Atë kohë unë të pyeta qetë se deri kur do të vazhdoje kështu. Dhe mendoja se kisha të drejtë të ta bëja atë pyetje. Ti, pa i shkëputur sytë nga libri, ma ktheve me tallje së ç'doja të thosha unë me atë «kështu». Unë të shpjegova se përse nuk pajtohesha me moskokëçarjen tënde pér shqetësimet e lodhjet e mia të përditshme, të cilat ti i merrje të gjitha si detyra vetëm të miat, që vetvetiu duhej t'i kryeja vetëm unë, por ti m'u hodhe në grykë. Më the se opinioni i shoqërisë pér një njeri kërkon vite që të formohet. Dhe gjëja më e rëndësishme pér mua në këtë fazë, the, është një opinion pozitiv i qëndrueshëm. Ti e di, vazhdove, që vetëm me punë mund të çaj. Biografinë familiare të keqe s'e kam, por jo dhe të shkëlqyer. Im atë i ka mbaruar studimet jash-të dhe gjatë luftës qëndroi asnjanës. Vetëm me punë

dhe sidomos me «emër» unë duhet të shkëlqej. Më the se unë paskësha qenë një meskine, shpirtngushtë dhe egoiste që s'më kishe njojur më parë për të tillë. Dhe m'u kërcënove duke më thënë se, po qe se nuk më pëlqente rruga jote e jetës, së cilës ti i ishe futur për të mos u têrhequr asnjëherë, atëherë edhe unë të hapura i kisha të gjitha rrugët, duke nënkuptuar me këtë ndarjen tonë. Unë nuk fola më. Me duart që më dridheshin mezi arrita të zhvishesha dhe u shtriva. Zemërimi që më pushtoi, kur mendova se ti s'doje të kuptoje në radhë të parë vetveten, pastaj mua, m'i largoi lottët që gati me gufan. Nuk doja të tregohesha e dobët përpara teje. Sepse edhe pa këtë për ty unë isha një kriesë e dobët, e shtypur nga meskiniteti, e paaftë për të kuptuar e justifikuar «veprime kardinale në jetë», siç ishe shprehur një herë tjetër, Unë isha e paaftë të kuptoja se punët dhe ladhjet e mia të përditshme ishin si të qdo gruaje tjetër, as më pak e as më shumë, pra krejt të zakonshme dhe as mund të mendohej se kishte diçka të përafërt me sakrificën. Për sakrifica i pari duhej të radhiteshe ti. Unë isha një trëndafil (i dëshirueshiëm për lulen dhe shqetësues për gjëmbat), që duhej vetëm të zbukuronte dhe të mos prishte asgjë në rrugën e jetës sate... Dhe për disa ditë i mbajte premtimet, vije më shpejt, kujdeseshe për vajzën e për nënën, kryeje ndonjë punë në shtëpi apo në pazar ajo thjesht këmbenim ndonjë bisedë të zakonshme, gjë e harruar prej kohe në shtëpinë tonë. Dy a tri herë dolëm shëtitje, shkuam në teatër, bëmë ndonjë vizitë e pamë së bashku, pas aq kohe, programet televizive. Ato ditë unë rilinda.

Më vinte të mos besoja se ishim pikërisht ne ata që kishim qenë të larguar. Ato ditë dashuria jonë ndriti me gjithë zjarrin e saj, ishte e kthjellët, e bukur.

Ato ditë edhe në shkollë e vinin re ndryshimin tim. Irena më afrohej, më qëndronte pranë gjithë gaz. Edhe Najda, për çudi, u soll mirë me mua ato ditë. Nuk më shkonte ndërmend se ato paske-shin qenë dhe të fundit. Se s'kaloi edhe fare pak kohë dhe ti u bëre ai që ishe, vije vonë e më vonë. gjithnjë i lodhur e i zyntë, dhe skicoje e llogaritje edhe duke ngrënë. I thoshe nënës dhe Najdës se makinë kishte dalë e mirë, e megjithatë ajo duhej përmirësuar apo duhej bërë një tjetër, më e avancuar. The se në uzinë kishte ardhur edhe zëvendës-kryetari i komitetit për ta parë. Dhe e kishte lavdëruar grupin e punës. Një mbrëmje Landa të tha në sy se për ty kishte dëgjuar të flitej jo mirë, se i qepeshe drejtoret vend e pa vend dhe në një mbledhje e kishe përkrahur për diçka për të cilën ai vetë kishte bërë autokritikë. Pikërisht atë mbrëmje, kur shkuam në dhomë, unë të thashë me të butë të kishe kujdes në ca gjëra, se njerëzit nuk hanë bar dhe një ditë do të arrijnë t'i kuptojnë motivet e qëllimet e vërteta që e shtyjnë njeriun të shfaqet me këtë apo atë sjellje, - në këtë apo atë veprim. A thua se të tjerët, shokët e tu, nuk dyshonin se tek ti s'kishin të bënин me ndërgjegje të kulluar, si mundoheshe të paraqiteshë ti në sytë e tyre, por me diçka tjetër?

Këtu menjëherë ti shpërtheve. The se të gjithë synojnë të ngrihen më lart se janë. Jeta është luf të, the, e dihet se disa do të jenë fitues, disa jo.

Dhe unë dua, vazhdove, të radhitem ndër fitimtarët. Kjo është logjika e jetës, që e mëson të mençurin të jetë ai që duhet të jetë.

Unë tundja kokën me hidhërim. Të kundërshtoja me forcë, ndonëse me fjalë e replika të rralla. Flisja me ty e përpara syve më dilnin nxënësit. Nxënësit e mi të mirë, të dashur ë të zgjuar. Dhe pyesja veten: cili prej tyre do të mund të bëhej si ti? Cili prej tyre do t'i fliste shoqes së jetës me po ato fjalë si dhe ti? Sillja nëpër mend fytyrat e tyre dhe e kisha të vështirë të përcaktoja ndonjërin. Jo, ata ishin që të gjithë të mirë e në punë e sipër do të bëheshin edhe më të mirë. Isha e sigurt për këtë.

Ndoshta fola më pak se herët e tjera, por ama nuk të lëshova pe. Të kërkova dy gjëra: të përcaktoje me përafërsi se kur pak a shumë mendoje se do të ktheheshe në jetën normale dhe, mbi të gjitha (dhe këtu ngulmova), t'i thërrisje mendjes e të kuptoje se, edhe sikur së fundi ta arrije ambicjen tënde, të bëheshe kryeinxhinier apo edhe drejtor, përsëri ambicja jote, pérderisa kishte një pikënisje jo të mirë, do të rrëmbente vrullshëm e më vrullshëm e do të vinte një ditë që ti nuk do të mund t'u bëje ballë troshitjeve të saj; ti do të shkëputesh si brettcosa nga sqepi i lejlekut dhe do të plandoseshe poshtë... U përpoqe përsëri të filozofje diçka pér «logjikë jetësore», por më kot. E vetmja gjë që mund të bëje ishte të mposhtje shqetësimin që të ngjallën fjalët e mia. Ti ngrite dorën lart pér të më goditur, por as atë s'e bëre. Dora të ngriu në ajër. Përse? Nuk e di. Dhe nuk kam dashur ta dì.

Ti deshe t'i jepje fund bisedës, por unë jo. Le
të bërtitje... I kisha marrë parasysh të tëra. Dhe
vazhdova. Të thashë se do të isha e lumtur vetëm
kur puna jote do të ishte sakrificë pér hir të diçka-
je të pastër, të bukur. Dhe do të isha një bashkë-
shorte jo e mirë, e denjë pér ty, po të mos sakri-
fikoja edhe unë. Nga këto fjalë ti jo që nuk u zbu-
te, por more më tepër zjarr: the se tek ti këto
shkriheshin të dyja: përfitimi që kishte shteti dhe
ai që kishe ti. Edhe kjo ishte në «logjikën e jetës».
Nëse unë sakrifikova diçka, kjo përsëri ishte shumë
larg nga të sakrifikuari gati gjithçka... Siç bëje
ti). Dhe shtove se, pavarësisht nga cili qëllim shty-
heshe në atë sipërmarrje, pér mua s'duhej të ndry-
shonte asgjë; unë duhej të vazhdoja, si dhe më pa-
rë, me atë detyrë që çdo grua ka në shtëpi pas
punës, pra që të jetë në vartësi të burrit e të fë-
mijëve.

Logjikë e bukur, s'ke ç'thua! Asnjëherë s'ma kishe
shprehur kaq hapur këtë pikëpamje.

Kaluan ditë e javë. Nëna po keqësohej. Unë
kisha shumë punë në shkollë. Ti, po, si pérherë.
në shtëpi vije vetëm sa pér të fjetur apo pér të
studiuar. Atë mbrëmje mua papritur m'u mor-
ën mendtë e isha përpjekur te dollapi. Ndoshta
sepse kisha qenë tepër e lodhur. Te ti nxori krye
ajo ndjenja e bukur, e fashitur prej kohe: shqe-
tësimi pér të tjerët. Që aty zuri fill një fry-
mëzim i befasishëm, më the se e ndieje edhe ve-
të se e kishe shkelur shumë me ato «mërgime» e
vonesa pa fund. Ca ngaqë isha pa fuqi e ca nga
mungesa e dëshirës, unë nuk ta ushqeva bise-
dën. Ti premtove me të madhe se të nesërmend

të vije në shtëpi menjëherë pas punës. Unë u gëzova, por faqe teje nuk e dhashë veten. Ishte bërë aq kohë që nuk kishim ngrënë. drekë së bashku.

Por premtimi që të nesërmën plasi si flluskë sapuni, ora po shkonte pesë dhe ti ende s'kishe ardhur. Nga posta e lagjes mora në telefon uzinën. Lashë Elonë ë te Hajria dhe shkova atje. Disa herë isha matur ta bëja atë gjë, por s'di ç'më kishte mbajtur. Ndoshta përbuzja që kisha ndier për ato gra që dilnin për të kërkuar burrat kur vonoheshin. Portieri më tha se, me sa mbante mend, ti kishe rrëth dy orë që kishe dalë nga uzina. Unë u nisa të ikja por, pa bërë ende dhjetë hapa, më lindi një mendim dhe u ktheva. Pyeta portierin nëse ishte brenda sekretari i partisë. Më kujtohet mirë se, apo e bëra këtë pyetje, u pendova. Dhe uroja me zemër që ai të thoshte «jo», por nuk ndodhi ashtu. Ai tha «po» dhe më tregoi menjëherë dhomën e tij. Kështu, desha s'desa, shkova. Ai më priti si motër, si të më njihte prej kohësh. Ndërkohë bluaja me vete se si do ta filloja bisedën. Vetëm si do ta filloja. Po me të hyrë në zyrën e tij, sidomos kur ai më dha dorën, unë u bllokova. Dhe papritur e pakujtar, pa e ditur as vetë pse, ia plasa të qarit. Ishte një e qarë e beftë, me dënessa e ngashërimë. M'u desh njëfarë kohë të qetësuesha, ta mblidhja veten. Sekretari i partisë, që më tha se quhej Sotir, mjaft i shqetësuar me pyeti kushedi për të satën herë se si ishte puna. Unë ngurrova gjatë para se të shprehja ato që më zienin në shpirt. Së fundi ia thashë.

Unë: Shoku Sotir, do të më vinte rëndë nga vetja po qe se fjalët e mia do të dukeshin si ankim për tim shoq. Ju them sinqerisht se nuk kam ardhur të ankohem. Madje nga shtëpiä nuk jam nisur me mendimin për të ardhur te ju. Kjo ndodhi rastësish. Më kuptioni, besoj. Dua vetëm të sqaroj diçka.

Ai: Sigurisht. Mos kini druajtje. Pyesni për çdo gjë.

Unë: Shoku Sotir, më thoni hapur, ju lutem, a punon im shoq brenda tetë orëve? Dua të them a e shfrytëzon kohën?

Ai (i habitur): Pa dyshim. Inxhinierët si ai i kemi të rrallë.

Unë: Atëherë mos merr përsipër më shumë dhe detyrohet të punojë pa masë edhe jashtë orarit?

Ai: Po... ç'është e vërteta, punë kemi shumë. Domethënë të gjithë inxhinierët dhe teknikët i kemi shumë të ngarkuar.

Unë: Nuk di sa punojnë të tjerët jashtë orarit, shoku Sotir, por im shoq vazhdimisht kthehet në shtëpi natën vonë. Më kuptioni drejt, nuk jam në kundërshtim që të punojë sa më shumë, të japë maksimumin, por më kuptioni, si grua, si nënë fëmije dhe si nuse me vjehërr të sëmurë...

Ai: Keni të drejtë, shoqja Veronika. Keni shumë të drejtë. Që kur më thatë se kush ishit, e mora me mend për se kishit ardhur. Na ka rënë edhe neve në sy që Aleksandri, si të thuash, ia kushton punës edhe atë kohë që, kuptohet, duhet t'ia kushtojë plotësimit të nevojave të tjera të familjes, çlodhjes e kështu me radhë. Unë vetë i kam thënë ta mbyllë punën dhe të ikë. Mirëpo ai ka një nxitje të tillë të çuditshme. Ndonë.

njëherë edhe më ka keqkuptuar. Edhe dje a pardje i thashë. Se disa procese pune na lidhin. Sot e pashë nga dritarja që po ikte. Ndoshta ka shkuar te ndonjë shok. Megjithatë unë do të bisedoj prapë. Shqetësimi juaj është i kuptueshëm. Çdo gjë ka vendin e vet.

Unë: Faleminderit, shoku Sotir! Veç do t'ju lutesha që të mos i thoshit gjë që erdha te ju.

Ai: Ju kuptoj.

Me kaq biseda u mbyll. E përshëndeta dhe ika. Ndërsa dilja nga porta e uzinës, takova Marie Vason, ti e njeh, dhe ajo më tha se të kishte parë në klubin te qoshja e uzinës. Më tha se ishe me shefin e kuadrit dhe dy të tjerë. Dhe vërtet atje ishte. Ecja rrugës dhe gjithë ai lëmsh mbytës sikur po më shpërndahej. Ndieja një si hidhëtirë mbytëse. Në shtëpi nuk më tregove se ku kiske qenë. Më the se kiske qenë në punë. Por të nesërmen u ktheve tym, se kiske marrë vesh ardhjen time në uzinë dhe takimin që kisha bërë me Sotirin (sigurisht jo nga ai). Unë fillova të shpjegohesha, por ti nuk më dëgjoje. Fole sa fole dhe përfundove se këto survejime e bëjnë zero personalitetin tim. Nëna dëgjoi zhurmat dhe u shqetësua; edhe para se të vije ti ajo e kishte ndier veten shumë keq. Erdhi Najda dhe të nxorri nga dhoma. Ajo e mori vesh për se grindeshim dhe për herë të parë (çudi!) u kthyte kundër teje. Edhe kujdesin për nënën e mori në dorë vetë. Madje më foli ngrohtë, më qau hallin për lodhjen, gjë që s'e kiske bërrë kurrë. Ajo bile të hoqi nga dora librin që kiske nisur të lexoje dhe të thirri të merreshe me nënën.

Pas kësaj ngjarjeje ti ndryshove disi. Nuk vije më vonë, por gjithnjë ishe i ngrysur dhe si i pa-

kënaqur nga diçka. Mé të ardhur, nisje avazin: zhyteshe në punë, në skicime e llogaritje.

Iku dimri, dhe pranvera, me gjithë bukurinë e saj, vërshoi në qytetin tonë. Gjatë rrugës për në shkollë, në pushimet midis orëve të mësimit e në ekskursionët me nxënësit, kur merrja Elonën nga kopshti, e ndieja në çdo hap. Kur kthehetësha në shtëpi, punët e përditshme më mbytnin, m'i mpinin të gjitha ndjesitë.

Por në një nga ato mbrëmjet pranverore ndodhi grindja jonë e madhe.

Atë pasdite unë nuk ndenja gjatë në shtëpi. Nëna kishte shkuar te Najda e do të kthehej të nesërmen. Ti, po, si gjithmonë, vazhdoje të rrije deri vonë jashtë shtëpisë, në uzinë apo me shokët. Unë ta kisha hequr fillin. Tani e jetojat jetën ashtu si vinte, duke u mjaftuar me gëzimet që më falte Elona dhe puna.

Atë pasdite unë qëndrova gjatë përpara gardërobës. Më kishte marrë malli të vishesha bukur. Këtë ndoshta ti s'e kuption dot. Gjithçka të bukur që kisha, ma kishe blerë ti. Ti nuk ishe kursyer, më kishe blerë aq shumë gjëra të bukura, sa unë kurrë nuk kisha èndërruar. Sepse nuk e kisha pasur pa-sion, as qëllim. Duke hyrë në shtëpinë tënde, iu nënshtrova kërkeseave dhe shijeve të njerëzve të tu. U vesha, pra, me rrobat që më pëlqenin më shumë për pranverë: me trikon bojë jargavani, me fustanin e gjelbër gjithë lule, të mëdha, me këpucët e ndritshme e fare të reja. Në fytyrë kisha bërë shumë pak tualet, aq pak, sa të pëlqente ty, tamam si atëherë, kur, të sapomartuar, më thoshe: «Je bërë si kukkan, të rrëmbe e të lë pa mend...» (Ty ndoshta

s'të kujtohet, por mua më është ngulitur në kujtesë gjithçka e mirë që më ke thënë).

Me Elonën për dore ecja rrugëve e magjepsur. Të merrte sytë ai vërshim ngjyrash, aromash e freskie. Shëtitorja gëlonte nga njerëzit, por unë pak vëmendje u kushtoja. Madje edhe të njohurve. Ndokush do të jetë habitur me hutimin tim. Unë isha si e përhumbur. Vërvimi i pranverës është i gjithë-pushtetshëm. Nuk di, por diçka e bukur më vinte përbrenda bashkë me frymëmarrjen, më hynte në zemër e më shpërndahej nëpër dej. Koka m'u mbush me kumbime e shpirti me këngë. Jehona e tyre ishte e gjallë, drithëruese. Kisha kohë pa jetuar çaste të tilla. Unë isha bërë si e dehur. E dehur nga pranvera.

Shkoja anës lumi të vogël, përskaj parkut të mbushur me gjelbërim. Elona këpuste lule, këndonte e vraponte rrrotull meje. Unë s'ia ndaja sytë rrjedhës së ujit. Uji i tij ishte i prajshëm, fëshfëritës, Matanë lumthit ngrihej pylli i plepave me një lokal të bukur veror në gjirin e tyre. (Atje ne kishim shkuar bashkë disa herë.) Në të djathtë të pyllit dukej ai parku tjetër po aq i gjelbëruar e në të majtë stadiumi i lojërave me dorë. Dhe akoma më tej ura e vogël me shkallë, që konturohej bukur në atë sfond të gjelbëruar e të thyer nga çatitë e shtëpizave të vogla që varesin përgjatë bregut.

Ecja dhe thithja e etur flladin pranveror, s'ngopesha së pari tonet mbrëmësore, gjelbërimin e kадifenjtë, shkëlqimet e arta mbi sipërfaqen e valëzuar të ujit. Atë buzëmbrëmje, ndërsa shëtitja me Elonën, unë jetova bukurinë e qindra ditëve së

bashku, bukuri që ma mbajti shpirtin të ngrohtë për shumë kohë.

Ndërsa bëhesha gati t'i jepja fund shëtitjes, e ngopur nga diçka e papërcaktuar dhe nën përshtypjen e ndjesisë se isha bërë e lehtë, si flutur, përballë pashë të vinte ai shoku i maturës, për takimin me të cilin, u bë gjithë ajo zhurmë... Ai më vështronë me buzë në gaz, por unë, nga që kisha vite pa e parë, nuk e njoha menjëherë. Po të të flas për cilësitë e tij, ti ndoshta përsëri do të më keqkuptosh, por tani aq më pak kam arsyë të këm druajtje: ai ishte një djalë i giatë, simpatik dhe shumë i zgjuar. E di që tani mendon: gjithnië i ke pasur qejf djemtë e zgjuar. Po, ashtu është, edhe ai është i vetmi, para njohjes me ty, me të cilin mund të këm qenë ndoshta pakëz e dashuruar. Them kështu sepse kurrë nuk arrita të bindesha për këtë. Edhe ai, nga ana e tij, po ashtu. Nuk di nëse thjesht kishte atë simpatinë e zakonshme që çdo dialë për njérën nga shoqet e klasës mund ta ketë më të theksuar, a më tepër nuk e di, por fakti është që ai asnjëherë nuk m'u shfaq tjetërsoi veçse si një shok i mirë, i dashur e i siellshëm. S'kam aspak druajtie të të them atë që ishte: ai më afrohei, më buzëqeshte, këmbenim mendime, diskutonim, po ndodhë që të rrinte përparrë meje edhe si i hutuar e i druajtur. Më të u ndamë si miq, si me të gjithë, pa brengë që po ndaheshim, por edhe pa gjëzim.

Kur më doli përballë, s'kam pse të ta mohoj: ndjeva gjëzim, që as vetë nuk e kuptova, Ti mund të turbullohesh nga ky pohim. A ishte vallë ringjallja e atij

malli të lehtë rinor, tashmë të harruar, a ishte nevoja pér të këmbyer dy fjalë të njerëzishme me dikë, apo nga ajo që ai u shfaq si me magji në atë atmosferë të bulkur pranvere shpërthyese, nuk e di, por fakti është se unë u gëzova që u takova me të. U përshëndetëm si dy të njojur të vjetër, filluam ta pyesnim njëri-tjetrin pér gjithçka i kishte ndodhur secilit gjatë kësaj kohe. Ai kishte mbaruar pér gjeologji dhe më tha se kishte vitin e dytë në një ekspeditë në Veri. Ndërsa bisedonim, nisëm të ecnim buzë lumthit. Elona u afroa shpejt me të; ai e mori në krahë, e puthi dhe bënë një bisedë të shkurtër, tepër gazmore. Kur hijet e mbrëmjes u shtuan dhe kur konturet e gjithçkaje pérreth u tjetërsuan, ne dolëm nga parku. Ndaluan pranë një bufeje dhe ai m'u lut të na qeraste me diçka. Duke pirë kafet e duke qeshur me vajzën, që ishte përlyer me shikumën e pastës, me përsëriti kushedi pér të satën herë se ishte shumë i gëzuar që më shihte të lumtur, me fëmijën pér dore, me një jetë familjare ashtu si e kisha ëndërruar. (Këtë s'e mòra vesh: nga e dinte ai c'kisha ëndërruar unë?)

U ndamë porsa dolëm nga bufeja. U ndamë thjesht si miq, të kënaqur që dëgjuam mirë pér njëri-tjetrin. Elona vazhdonte të më pyeste pér atë khaxhi, por unë nuk ia zgjata, me ndarjen nga ai djalë isha ndarë edhe nga çdo mendim apo kujtim pér të. Gjithçka e dikurshme tanë i përkiste një kohe tepër të largët.

Por ti nuk mendove kështu. Atë mbrëmje, pér çudi, ti u ktheve herët në shtëpi. Dhe i téri si natë: i ngrysur e i zbehtë. Unë shtrova darkën por nuk u ule të haje. E merria me mend se ishe i lodhur, por, ndryshe nga herët e tjera, m'u duke

pak i nervozuar e i shqetësuar. U shtrive në dinvan, por s'qëndrove shumë; kalove në dhomën tonë e që aty më thirre. Aty prapë të gjeta ndryshe e gati u tremba, kur të pashë: sytë të ishin zmadhuar e m'u duke si i sëmurë. Të pyeta dhe nga përgjigja jote e nuhata: nuk ishe i sëmurë, as kishe ndonjë shqetësim për punën, por diçka që lidhej me mua. Dhe vërtet, nuk vonoi të nxirrte kryet shqetësimi yt, edhe pse nise të më pyesje fare qetë. Por unë e ndjeva, ajo ishte një qetësi e akullt. Më pyete se cili ishte ai djalë me të cilin kisha kaluar një kohë aq të bukur në lulishte. Pyetja më erdhi vërtet e papritur. Unë u hutova, e humba. Nuk di ç'më hutoi më shumë, e papritura, toni i fjalëve të tua, apo ai shikimi yt i ndezur. Të tregova gjithçka, po ti nuk më zure besë, dyshove. Dyshimi yt më fyeu. Megjithatë nuk bëra as përpjekjen më të vogël për t'u mbrojtur. Unë vetëm të svarova. Por ti vazhdove me fyerjet dhe me hamendjet më të ulëta. Kulmi arriti kur pyete Elonën duke shpresuar të mësoje ndonjë «hollësi» të patreguar. Atë natë e ndjeva yeten më të poshtëruar se kurrë. Për ty unë tanë nuk isha më ajo grua besnike, por një hakmarrëse që sajonte presione. Poshtërimi më bëri ta humbja aftësinë për të folur. Gjithçka që të thosha dilte e varfér, si prej një fajtoreje. Më vonë nisa ta ngrija zérin e kundërshtimet e mia për të gjithë qëndrimin tënd filluan të bëheshin gjithnjë e më të prera, më të vendosura, por atë strukjen time atë natë unë s'kam për t'ia falur vetes!

Të nesërmen në shkollë, sado që u përpoqa të mos e bëja veten, rashë në sy, se isha e hutuar, e vratë. Irena, më pyeti, më tha se do të vinte te ti e

do të të fliste ashpër. Edhe pse pak njihemi, tha, do të vete. Por unë iu luta, e ndalova.

Kur e morën vesh Najda dhe Landa këtë ndodhi, mbajtën qëndrim. Ato më dolën krah dhe më mbrojtën. Për të dytën herë më bëri përshtypje qëndrimi i Najdës. Nuk besoj se gabohem, por ajo kishte filluar të më donte. Mbase po më njihet më thellë. Ndoshta ajo po gjente tek unë atë që kishte kërkuar, shoqen e denjë të jetës të vëllait të saj. Sidoqoftë ajo më doli krah në një çast të vështirë dhe t'u kundërvu ty jo vetëm pér çështjen që, siç u kuptua, ty të tronditi shumë, por edhe të këshilloi, pér herë të dytë përparrë meje, që të lidheshe «pak më shumë» me problemet e shtëpisë.

Që nga ajo kohë e më vonë ajo mbajti një qëndrim shumë të mirë ndaj meje.

Sa pér nënën, ajo nuk reshtte nga ankesat, por ato më fort ishin pér sëmundjen e saj, sesa pér mua. Unë përpiqesha t'ia plotësoja të gjitha nevojat, por ajo ishte vazhdimisht e pakënaqur, si i thonë një fjale, edhe nga rroba që mbante veshur. Megjithatë, kur donte, kur ishte në orë të mirë, ajo e gjente fjasën e duhur njerëzore. Madje kohët e fundit kishte ndodhur që, pér çudi, sepse këtë s'e kishte bërë më parë, të më qante edhe hallin pér vetminë time. Ndoshta në ato raste ajo qante hallin e vetvetes, mërzinë dhe ndjenjën e braktisjes që edhe ajo me siguri e ndiente nga shkaku yt. Por mua, pér natyrën që kishte, natyrisht që nuk mund të më 'hapej. Ti vazhdimisht rrige i ngrysur, madje edhe gjatë kohës që u sëmur Elona, deri ditën e fundit që qëndrova aty.

Unë s'e dija se ç'sëmundje e rëndë ishin grykët

e bardha. U tmerrova kur më thanë se vajza duhej shtruar patjetër në spital. Megjithatë, desha apo s'desa unë, atë e shtruan. Çdo pasdite i rrija te koka. Dy a tri herë erdhi Irena, që u kujdes për të si për vajzën e saj. Po ashtu edhe Hajria. Por sytë më mbeteshin te dera, sepse të prisja ty, babanë e vajzës. Ti erdhe dy herë gjithsej. Edhe kur vije, ishe i lodhur, pa humor, pa arritur ta gëzoje vajzën, që të priste gjithë mall. Ajo përgjërohej për ty; ti ikje, por ajo s'të lëshonte nga goja. Me emrin tënd në gojë e zinte gjumi, me emrin tënd zgjohej. Me siguri, po të kishe ardhur më shpesh, ajo do të ishte shëruar më shpejt.

Nëna u bë më mirë. Pas sëmundjes së Elonës, sidomos, filloi të më sillej shumë ngrrohtë. E mundonte vetmia, sepse edhe Najda me Landën vinin rrallë. Shpesh nëna më vinte në dhomë (gjë që s'e kishte bërë më parë) e niste nga bisedat. Më tregonte si kishte hequr edhe ajo me të shoqin, babanë tënd. I marrosur pas punës, pas fitimeve... Deri në njëfarë mase e justifikonte, ashtu ishte koha, thoshte. Më vonë, me kalimin e viteve, ishte afruar, i ishte shtruar jetës familjare, shtëpisë. Më këshilloi që edhe unë, sa të mundesha, të tregohesha e duruar me ty. Jam treguar, i thashë, dhe po tregohem. Dhe kjo është e vërtetë, apo jo?

Kur Elona e mori veten mirë, nisi të shkoja më dendur te prindërit. Ata më shihnin me një sy të shiqetësuar, të merakosur. Unë kurrë s'u isha ankuar për ty; kjo mund të të duket e çuditshme, por është e vërtetë. Ata vetë e kishin nuhatur që punët nuk ishin fort mirë, po nuk ndërhynin. Kishin besim se unë dija ç'bëja, do të mund t'i rregulloja vetë

gjërat, nëse do të ishin të rrëgullueshme. Babai vetëm një gjë më porosiste: të shkoja sa më pak nga ata, ngaqë kishte hall se mos edhe kjo, edhe pse gjë e vogël, më aqaronte më shumë me ty. Por ato kohë unë nuk i rrallova vizitat tek ata. Megjithatë edhe vajtjet te prindërët jo që nuk ma hiqnin, po sikur ma shtonin zbrazëtinë që më shkaktonte mungesa jote. Asgjë nuk mund t'ia mbushë një gruaje këtë lloj zbrazëtie...

Kështu, unë ndodhesha te mamaja kur ti më dërgove fjalë të kthehesha urgjent në shtëpi. Ora ishte katër, dhe u çuditë pak: kohë e pazakontë për kthimin tënd. Kur vij në shtëpi, dhomën e gjej plot me shokët e tu të uzinës. Më kryesori ndërt ishte, kuptohet, drejtori. Ai m'u duk burrë i qetë dhe i shtruar. Ti ishe si në ethe, s'dije ç'të bëje që t'i kënaqje sa më mirë mysafirët. Të shihja ty e m'u kujtua një fjalë që më kishe thënë dikur: këto «pleksje» spontane ndodh të sjellin atë që s'e sjell një vit mund. Ti fluturoje, kërceje, hidhesh, qeshje edhe kur s'që fare për të qeshur, kurse përballë meje, mënjanë mysafirëve, turfulloje si kalë. Shaje nëpër dhëmbë që për «dreq» s'kishte ndodhur frigoriferi plot! Megjithatë ne sajuam dicëka e tryesa pati lezet. Ti kujdeseshe në mënyrë të veçantë për drejtorin, por ai as hëngri e as piu. Ai më shumë fliste. Përpala meje të lëvdoi dy a tri herë. Ti ishte i téri i ndezur; edhe prapa asaj pamjeje modeste që merrje nuk ishe në gjendje ta fshihje ledhatimin e sedrës, krekosjen që të shkaktuat ato lëvdata. Ti i përçolle ata dhë nuk di pse u vonove mjaft. Nejse, së fundi u ktheve. Unë isha në korridor dhe mbeta pa mend nga habia:

ti u afrove duke fërkuar duart, më kape me rrëmbim, më puthe e më the: «Veronika, gjithçka po shkon për mrekulli! Emërtimi im pothuaj është i sigurt!» Unë të pashë në sy e buzëqesha pa qejf. Ti u vrenjte pak por nuk the gjë, e kalove shkarazi. Gëzimi të kishte rrëmbyer të tèrin dhe ai gjesti im, ai qortim i brendshëm, që ta transmetova përmes asaj buzëqeshjeje, pak të preku. Rrëmbave Elo-nën, e ngrite lart, e puthe. Ajo u habit nga ky shpërthim i pazakonshëm. Të hodhi duart rrëth qafës e 'belbëzoi «babì, babì...» Të nesërmen èndrra jo te mbaroi si illuskë sapuni. Në vendin e kryein-xhinierit do të caktotonin një tjetër. Për ty kishin thënë se ishe ende i ri. Kurse në darkë folëm kësh-tu:

Unë: Vajza të paktën nuk të ka faj, Sandri. Drithërohet për një përkëdhelje tënden. Të paktën me të tregohu i dashur.

Ti: Po. Vetëm kjo më mbeti tani, të tregohem zbabia i mirë. Për këtë po, mund të kem talent, zotësi.

Unë: Mos i zmadho gjérat. Sa për punën, ta vlerësojnë, mos u bëj merak. Dije mirë, të vlerë-sojnë. Sepse punon, dhe kjo duket, dhe as u shkon ndër mend ta lidhin punën që bën me ambicjet e tua të fshehta. Se, të dinin këtë, as do të të vlerësonin fare!

Ti: E pashë sa më vlerësojnë. (Heshte pak e pas-taj shpërtheve.) Por do t'i detyroj unë ta bëjnë! Mos do të heq dorë nga puna? Kurrë!

Unë: Do të shkatërrohesh, Sandri. S'do të dish jë ruash masën. Mos u verbo nga një qëllim që e zhvlerëson gjithë mundin tënd.

Më pe në sy, pa folur, dhe qeshe hidhur. Pastaj shkove në dhomën e babait. Për të ngrënë, s'deshe, vetëm kafe, e s'mbaj mend sa pive. Kur hyra për herë të fundit, në orën tre të mëngjesit, të kishte zënë gjumi mbi tryezë. Dhe për herë të parë atë natë të bëra një pyetje që ndoshta duhej të ta kisha bërë prej kohe: ndoshta nuk më doje më. Edhe më parë më kishte shkuar ndër mend ky dyshim, po ja, nuk të kisha pyetur. Ti qeshe, qeshe sikur sapo kishe dëgjuar budallallëkun më të madh. The se nuk ishe një njeri me një karakter aq të dobët sa ta fshihje një të vërtetë po qe se ajo ekzistonte. Po, më the, të dashuroj si dhe më parë. Po kurrsesi nuk mund ta lejoj dashurinë t'i bëhet pengesë qëllimit që i kam vënë vetes. Përkundrazi, dashuria duhet t'i nënshتروhet atij. Dashuria jonë, imja dhe jotja. Se ai qëllim vlen për të dy, për dashurinë tonë, për të ardhmen e sigurinë tonë. Por ti, the, tani për tani nuk je në gjendje ta kuptosh këtë. Sepse unë s'isha veç një grua e rëndomtë, që s'kisha ambicje, s'kisha èndrra. Të mos kesh èndrra, the, do të thotë të vegjetosh në vend që të jetosh. (Fjalorin, ç'është e vërteta, të pasur e kel!) Pavarësisht ç'drejtëtim i dhe bisedës, unë nuk u largova nga tema që hapa, shpreha dyshimin mos doje ndonjë tjetër. Tani ti nuk qeshe, por u nxehë. The se s'kishe menduar kurrë për një tjetër e ndoshta kishe bërë gabim. Sepse unë, që kisha pasur fatin e rrallë të bëhesha gruaja jote, nuk dija ta vlerësoja këtë fat. Askund unë s'do të kisha qenë e mbushur me aq të mira, me një shtëpi të bukur, ku gjithçka, jashtë e brenda, ndriste, e me një gardërobë si e rrallëkujt tjetër... Fjalimi yt vazhdoi

dhe unë nuk qeshë i afë t'i bëja ballë gjithë atij shpërthimi. Ndjeja vetëm se gjithçka po rokullissej te poshtë. Pa folur asnjë fjalë shkova te dollapi i rrobave, e hapa dhe me duar të mpira rrëmbeva fustane, triko, bluza, funde e ku di unë... e të gjitha, një nga një, t'i hodha pranë këmbëve, Pastaj shkëputa nga gjoksi varësen me gurë të çmuar, unazën (dhuratat e tua për martesë) dhe i hodha mbi to. Rrëmbeva pastaj Elonën, që flinte e qetë, dhe e mora në duar. Ajo filloj të qante, por e mbulova me batanije. Duke e mbajtur atë me njérën dorë, rrëmbeva me tjetrën, kuturu, disa rroba të saj e bëra të dilja nga dera, por ti, papritur, u sule drejt meje dhe më rrëmbeve vajzën...

Diçka u thye tek unë dhe, po të mos kishte qenë puna, me siguri do të kisha vazhduar të isha në po atë gjendje të vështirë shpirtërore.

Vetëm në shkollë mund të them se e ndjeja veten tjetër. Puna më tërhiqte dhe ndjeja gjësim të madh kur arrija ta kryeja mirë, kur përgatistesha mirë. Të edukosh, do të thotë të ndërtosh. Dhe ndërtesa fillon nga themeli. Sa më i qëndrueshëm të jetë themeli, aq më e fortë do të ngrihet ajo. Por ndodhë që, për shkak të telasheve në shtëpi, t'i lejoja vetes edhe ndonjë boshllëk. Për këtë më vriste ndërgjegjja dhe luftoja me të gjitha forcat për ta përmirësuar sa më parë. Të kisha qenë e lumtur në shtëpi, do të më kishte ecur shumë më mirë edhe puna ime. Si të gjitha shoqet e tjera, si Irena. E shihja Irenën ashtu të qeshur e gazzmore dhe mendoja: pse vallë të mos isha edhe unë si ajo? Kur bie rasti të bisedoje për burrin dhe dy fëmijët që ka, sytë i xixëllojnë nga lumturia. Sa

mirë merret vesh ajo me të shoqin! Një ditë shkova tek ajo. I shoqi kishte marrë vajzën nga kopshhti dhe qeshte e lozte me të. Ai është agronom. Jo pak punë ka edhe ai, jo pak i duhet të studiojë edhe atij. Megjithatë e gjen kohën të merret edhe me fëmijët. S'e fsheh, ndjeva zili, zili për të mirë: pse të mos ishim edhe ne si ata? Si gjithë të tjerët?

Pas asaj ndodhisë së hidhur të asaj nate, kur unë mora Elonën e desha të largohesha, ti bëre disa herë përpjekje të afroheshe. Arsyen nuk edi: nga pendesa, nga dashuria, apo nga mëshira. Por, pavarësisht se cila do të ketë qenë ajo, unë iu përgjigja afrimit me atrim, me zemrën ende të vakët nga ai zjarr që s'ishte shuar përfundimisht tek unë.

C'është e vërteta, për një kohë, ndonëse të shkurtër, ti pate një kthjellim, një shkundje të madhe. U bëre ti, i dikurshmi. Vije në dhomë, më uleshe pranë e nisje të më flisje për rezultatet që po arrinit në tipat e fundit të makinave, si ju shkonin provat e për plot gjëra të tillë. Një mbrëmje më the se këtej e tutje do të punoje në shtëpi me një shok, që unë të mos mërzitesha më si më parë. (Sikur e kisha pasur hallin vetëm te mërzitja!) Sidoqoftë unë u gëzova. Ti do të rrije më shumë në shtëpi, kjo ishte kryesorja; më the se do të krijonim mundësinë që edhe të lexoja, edhe të dilja nëpër njerëz. Për nënën, gjatë mungesës sime të shkurtër, do të kujdeseshe vetë. Të nesërmen në mbrëmje Landa me të shoqin më morën në teatër. Të dy u sollën shumë ngrohtë me mua dhe unë u kënaqa sa s'bëhet. Dy net më vonë mua dhe nënën na mori Najda për darkë. Afrimi i saj më ka çuditur vërtet dhe as tani s'e kuptoj shkakun: i hyra në zemër apo thjesht si për të më lar-

guar mendjen. Ato ditë pata mundësi të shkoja më e shpenguar edhe nëpër njerëz, sidomos tek Irena e dy shoqe të tjera. Ndjeva, pas aq e aq kohe, të kthehesha në jetën e zakonshme, aq shumë të dëshiruar... Pse ta fsheh: mendimi se ty do të të gjeja në shtëpi, edhe pse të zhytur në punë, më jepte krahë, më ngazëllente.

Cdo pasdite ti fillove të vije në shtëpi me Janin, shokun tënd të punës. Nga ç'më kishe folur për të, dija se e vlerësoje dhe e cmoje shumë. Të dy, të mbyllur në dhomën e vogël, punonit deri vonë. Unë ju sillja ndonjë gjë për të ngrënë. Me mua fillove nga shakatë dashamirëse e me kripë (kjo ma bënte zemrën mal!), dhe Jani qeshte me gjithë shpirt. Ju vazhduat të punonit për më shumë se një muaj. Më thatë se ishte makina e katërt që po konstruktohej dhe e para që punonit bashkë. Realizimi i saj, the ti, do të vlerësohej si një hop në mekanikën tonë. Kur ramë të flnim, e vazhdove atë bisedë duke më thënë se për atë makinë do të shkruhej në gazeta, do të flitej në radio e televizion. Së shpejti emri yt do të bëhej i njohur në tërë vendin. Ky do të ishte suksesi, the, i pritur prej vitesh, që do t'u thyente hundët atyre që i vunë shkopin në rrotë punës tënde. Në fund shtove se këtë radhë me siguri do të shpërbleheshe ose me dekoratë ose do të propozoheshe për urdhër pune, që do të ishte një vlerësim edhe më i madh se posti i kryeinshinierit.

Unë u trishtova. Por nuk heshta, siç kisha bërrë shpeshherë. E dija se edhe heshtja flet, po duhej folur më fort, më ashpër se kurrrë. Duhej goditur ajo e keqe që po rrитеj te ti nga dita në ditë. I duhej shtypur koka nëpërkës së egoizmit para se

të të helmonte të tërin. Asaj nëpërke që derdhte vrer në ndërgjegjen tënde, por që ti s'e kuptoje. Puna që bëje ti ishte aq e mirë, aq e dobishme, dhe të tjerët të shpërblenin pér të. Se e shikonin me atë sy që mendonin se e shikoje edhe ti. Kurse ti... Ndaj dhe nisa atë natë një debat të gjatë e të ash-për me ty. Debatin e parë të vërtetë e, pér fat të keq, edhe të fundit. Deri sa ika.

Ishte vonë, ora kishte kaluar nga dymbë-djhjeta dhe unë, ende zgjuar, korrigjoja detyrat e nxënësve. Prisja që ti me Janin të mbaronit dhe të vije në dhomë pér të fjetur. Papritur vajza u zgjua me klithma e nisi të dridhej në mënyrë të frikshme. Unë bërtita. Të dy u sulët në dhomë, i shkuat vajzës te krevati. Jani e preku në qafë dhe më tha t'i çoja shpejt një çarçaf të lagur. Unë ia dhashë menjëherë dhe ai e mbështolli vajzën me të. Pas pak i dhamë aspirinë dhe temperatura i ra. Ajo u mbyt në djersë dhe u qetësua. Mjekja, që na erdhi menjëherë; na tha se vajza s'kishte gjë, vetëm një gjendje griviale, por duhej ruajtur të mos i hipte temperatura përsëri. Tërë natën i qëndrova te koka. Herë pas here shkoja edhe nga nëna, se edhe ajo kishte nevojë pér ndonjë gjë. Në dhomën e babait, ku punoje ti me Janin, nuk hyra, nuk doja t'ju shqetësoja. Ama prisja të vije e të pyesje si dukej vajza. Kurse ti asnjëherë nuk erdhe. Orët kalonin një nga një, kurse ti...hiç. Më vinte inat, më vinte të via e t'i bija derës me grusht duke thirrur «Pse s'pyet, pse?», por nuk erdha. Unë do të të mësoja c'duhej të bëje? Në mëngjes Jani iku. Ti po bëheshe gati pér të shkuar në punë. Në punë duhej të shkoja edhe

unë. Kokën e kisha plumb të rëndë, po s'e kisha pér gjë; nuk më hiqej nga mendja e më vinte plasje që ti, pér orë të tëra, një fije s'të hëngri më raku pér vajzën. Nuk them se të mungonte dashuria pér të, jo, por ti vure ambicjen, dëshirën pér «shkëlqim» mbi atë dashuri... S'ka si të shpjegohet ndryshe.

Para se të ikje nuk u mbajta e ta thashë këtë. Pse ta fsheh, isha jashtëzakonisht e prekur. Fjalët e mia të goditën keq, të ranë shumë hidhur. Të vërteta të hidhura të kisha thënë edhe më parë, por ajo që të thashë atë ditë të dhembi më shumë se kurrë. Besoj se të kujtohet dialogu i fundit:

Unë: Po ngurtësohesh, Sandri! Po bëhesh gur. Po e mbyt në veten tënde njeriun, burrin, babanë...

Ti: Veronika, unë po shkoj në punë. Mos harro se tërë natën më kanë rrjedhur trutë mbi projekte! I kam mangët tanë dërdëllisjet e tua?!

Unë: E di, Sandri, që mundohesh shumë. Po unë ndoshta... jam e vëtmja që e përbuz atë mund, që e urrej atë!

Ti: Veronika!

Unë: Sepse ai është pjellë... e egoizmit tënd!

Ti: Mos harro se jam burri, jo nxënësi yt. Mos harro se ke përballë një njeri që përfaqëson një familje, një traditë një edukatë. Kurse ti... ke harruar nga vjen. Ke harruar se në familjen tënde s'bëhej asgjë më e bukur se qypat e shtambat. Se balta!

Unë: Jo, nuk e kam harruar. Dhe s'do ta harroj. Jam krenare pér punën që bënte babai im, jam krenare pér të. (Ula zërin.) Dhe pér gjithçka që më dha ai, edukatën, shkollën, kuptimin pér gjérat.

Ajo që është rrënjosur te ti, gjithçka që the për vete, nuk pajtohet dot me atë që është rrënjosur tek unë. Le t'i japim fund, Sandri. Më mirë t'i japim fund.

Ti: Propozon të ndahemi? Mos po nxitohesh, Veronika?...

Unë: Jo, tani nuk nxitohem.

Ti: Atëherë... lamtumirë.

Dhe u ndamë. Mora vajzën, u pëershëndeta me nënën (ajo qau shumë kur e mori vesh) dhe ika. Ika përgjithnjë.

Agoi. Një purpur i bukur dallon matanë xhamave të dritares. Nga rruga vijnë zhurmat e para mëngjesore. Zhurmë e bukur për atë që e pret ditën me gëzim. Edhe për mua. Për herë të parë pas kaq kohe po e ndiej veten të lehtë, për herë të parë pas kaq kohe po e ndiej përsëri shijen dhe freskinë këtij ajri të pastër që më mbush mushkëritë. Hedh sytë nga dritarja e s'i reshtem dot bukurisë dhe diçka thérret brenda meje: agoi, buroi drita, gëzimi. Dhe them: edhe për mua...

Në dorë mora përsëri pusullën tënde. Lutesh të takohemi, të të dëgjoj. Nuk e kam të vështirë. Por ç'do të dalë nga kjo? Ja dhe të dëgjova. Ja dhe u ktheva përsëri. Po vallë a do të ndryshojë gjë? A nuk do të jetë po njësoj? Është lehtë të thuash se do t'ia fillojmë nga e para. Por është e vështirë, shumë e vështirë, sepse do të të duhet të përmby-sësh shumë gjëra në veten tënde. Mirë, po a do të mundeshe, vallë, a do të gjeje forca? Ndryshe asgjë s'do të ndreqej e përsëri them se është në dorën tënde t'ia fillojmë përsëri nga e para...

Pikturat buzë detit

Gjiri ishte i bukur, me ca kodra tepër të gjelbëruara sipër, ku ndodheshin hotele të mëdha luksoze. Ai ishte një qytet që vizitohej shumë nga turistët. Sezoni turistik ende nuk kishte filluar e megjithatë ndeshje plot grupe, më të shumtët nordikë, që dalloheshin nga lëkura e bardhë si e tejdukshme. Ata mbanin lloj-lloj aparatesh në duar dhe shëtitnin me jahte të bukura.

Kishim shkuar atje për një simpozium ndërkombetar, që vazhdonte prej disa ditësh. Seanca kishte edhe në mbrëmje dhe ne, aty nga ora pesë pasdite, niseshim nga hoteli, ku kishim zënë vend, për tek auditori ku mbaheshin sesionet shkencore.

Rruga shkonte buzë detit dhe kishte një park anash, që e ndante nga autostrada. Përbri saj, te skela e vogël e jahteve turistike, çdo pasdite, në të njëjtën orë, shihja një burrë që ekspononte piktura të madhësive të ndryshme, që me siguri i shiste. Ai rrinte pranë tyre, ulur apo në këmbë, dhe priste. Rrallë ndalej njeri për t'u hedhur ndonjë sy pikturave të tij. Më të shumtët ishin fëmijë që, si

qëndronin pak përpara tyre, largoheshin gjithë zhurmë.

Një pasdite unë dhe kolegu im po shëtitnim buzë detit. Pranë një kishe të vjetër e të zyrtë na tërroqi vëmendjen një vitrinë shumë e ndriçuar, ku ishin ekspozuar piktura e vizatime moderniste. Hymë.

Dyqani ishte i gjerë, me galeri ekthina të shuma e me tavan tepër të lartë. Një glob me ngjyra, që varej deri poshtë, rrrotullohej pa pushim, duke shpërndarë një spektër ngjyrash të ndryshme, që këmbbeheshin vazhdimisht. Brenda kishte pak vizitorë. Unë dhe kolegu iu afroam tablove dhe nisëm t'i shikonim më nge.

Të merreshin mendtë e të lodheshin sytë: figura gjeometrike të vendosura pa rregull, njëra mbi tjetren, rrëmujë trajtash, formash e vijash, rrëmujë njollash e ngjyrash.

Iu afrova një tabloje që mbante diçiturën «Ujku dhe kafka e lopës». E pashë me vëmendje për një copë herë të mirë, por nuk munda të gjeja as edhe një tipar qoftë të ujkut apo të kafkës së lopës në të. Vura re se edhe kolegu po e shikonte.

— C'thua? — e pyeta.

— S'po merret vesh gjë.

— Shiko ata rrathët atje. Dicka si sy, si rrötë biçikletë à si lule dielli.

— Reklamat e gomave të «Alfa Romeo», — tha ai.

Unë qesha.

— Dalim? Të paktën të na i çlodhë sytë deti, — i thashë.

— Pa prit... Shiko atje.

Ktheva kokën. Një zonjë, me një qen leshtor pranë, mori një tablo nga muri dhe po e vështron-te me vëmendje. Një burrë i gjatë dhe mjekrosh iu afrua dhe nisi t'i fliste. Gruaja sepse shpërtheu në gaz, kurse burri i gjatë, si duket pronari apo ndonjë nga shitësit, e shikoi plot ankth. Gruaja, e lyer sa s'ka më, nxori nga çanta një kuletë të qëndisur dhe i zgjati një tufë kartëmonedhash.

Ne dolëm. Ngadalë e pa folur shkuam pranë bregut të detit. Ndjeva një si lehtësim.

Pamja e detit ishte e këndshme dhe tepër clo-dhëse. Pasqyrimet e dritave në sipërfaqen e tij të pamatë kishin një dridhje të lehtë. Kështjella mes-jetare, e futur përgjysmë në ujë, dukej sikur nga çasti në çast do të niste të vraponte drejt thellësi-ve.

Nisëm të shëtitnim gjatë bregut. Kalimtarët ishin të rrallë. Në të djathën tonë shtrihej rruga e gjerë, e rrethuar nga restoranet e dancinget e shumta që endeshin bosh, në pritje të turistëve. Mbi to ngriheshin radhë hotelesh dhe pensionesh me emra të bujshëm. Të ndërtuar pjesërisht në rrafshulët e pjesërisht në faqe kodrash, hotelet i ngjajnin një rrjete të madhe merimangash që përpinqej të grumbullonte të ardhura të majme. Nuk ka qytet më të zhurmshëm se ky në stinën e verës, na tha një ditë kamerieri. Po ai kamerier të nesërmen na tregoi se si një jaht i bulkur, me turistë anglezë e sudezë. për pak ishte mbytur për shkak se turistët gjatë gjithë natës kishin pirë e ishin dehur së bashku me ekuipazhin prej tre vetash.

Të nesërmen pasdite dola vetëm nga hoteli për të bërë një shëtitje të shkurtër. Kalova përmes par-

kut e dola në brdetrëg të detit. Në hundë më goditi era e jodit dhe e leshterikëve.

Hodha shikimin përtej, te skela e jahteve turistike. Piktori i kishte nxjerrë tablotë e tij. Ai ishte krejt i vetém. Me një ndjenjë shqetësimi, por edhe kureshtjeje, vendosa t'i shihja ato tablo. Bleva te qoshku një paketë cigaře dhe bëra andej.

Piktori rrinte ulur mbi bazamentin e betontë të parmakëve dhe pinte cigaře, me shpinën kthyer nga deti. Ishte një burrë i imët, rreth tridhjetë e pesë vjeç, me një fytyrë të hequr e pak të zbehtë. Veshjes nuk i kishte kushtuar kujdes. Ai më hodhi një shikim mospërfillës dhe unë e pëershëndeta me kokë.

Nisa të vështroja pikturat. Ndjenja e shqetësimit më iku. Pikturat e tij nuk kishin asgjë të përafërt me ato pikturat moderniste që kisha parë në dyqan.

Pikturat e tij ishin të thjeshta, shumica pejzažë, që të bënin pér vete. Ato se si të zgjonin ca ndjenja që i kishe pandehur të harruara. Nga ato tablo ndjeva sikur diçka imja, intime dhe e dashur më tërhoqi e më thirri. Një bregdet shkëmbor i rrähur nga dallgët dhe një fragment kështjelle që u qëndron përjetësisht atyre. Një rrugicë e ngushtë e mbuluar me një mijegull të përhimtë, ndërsa nga dritaret e shtëpive buron një dritë e fortë. Portreti i një burri, i rrahuar nga dallgët e jetës, me shikim të rreptë.

Së fundi i fola piktorit:

— Profesionist jeni, zotëri?

— Jo, — më tha, — punoj me hope, pasditeve apo ditëve kur kam pushim.

I zgjata paketën e cigařeve, por ai u tregua më i

shkathët se unë dhe më zgjati të vetën. Ia mora cigaren dhe të dy nisëm të pinim duhan.

— Punoj në një fabrikë duhani, — më tha duke shkundur hirin e cigares. — Si biçim normisti. Në shkollën ku jepja mësim pikturre nuk ka më vend.

— Më vjen keq, — i thashë. — Si kështu?

— Nuk deshën të më mbanin. Nejse. Mund të isha bërë një mekanik i mirë, ashtu siç ka qenë dhe gjyshi im.

— Sepse keni pasur pasion pikturën, me siguri.

— Është e vërtetë. E kisha dhe për fat të keq ende e kam.

Vështrimi i tij ishte i butë, i trishtuar.

— Por në kohët e sotme, — vazhdoi, nuk është gjithmonë fatmirësi të kesh pasione.

— Po kur është puna për një talent të vërtetë...

— Ç'talent! — tha ai dhe lëshoi me rrëmbim një shtëllungë tymi. — Kush pyet për të! Nuk është gjithmonë talenti ai që vendos për të hapur rru-gët e artit, or zotëri!

Sytë e tij sikur u zgjuan nga dremitja dhe tanë u bënë tepër të gjallë e të lëvizshëm.

— Unë punoj deri në orët e vona të natës, — vazhdoi të fliste, i nxitur nga një dëshirë e brendshme. — Ka pasur shumë raste që kam qëndruar pranë kavaletit deri në mëngjes. Dhe pa u çlodhur asnjë minutë jam nisur për në punë. Se fëmijët, dhe unë kam tre, duan të hanë, të vishën e ç'të të them... Gruan e kam pa punë. Dhejeta sot është e vështirë, zotëri. Është shumë e vështirë...

— Sidoqoftë mua më vjen mirë që shikoj se ju e respektoni artin e vërtetë, — i thashë me një ton mirëdashës. — Këtë s'keni si e mohoni.

Ai heshti një grimë, më vështroi me njëfarë habie dhe shkeli cigaren me këmbë.

— Nga ju kemi? Mos jeni nga jugu?

Tani u habita unë, sepse ajo pyetje nuk kishte të bënte fare me bisedën tonë.

— Jo, — i thashë. — Jam i huaj. Nga Shqipëria.

— Nga Shqipëria??

— Po. Më duket se u habitët.

— Po, vërtet... M'u duk pak çudi. Xhaxhai im është vrarë në Shqipëri.

— Shumë të huaj janë vrarë në Shqipëri, — i thashë. — Dhe kjo për faktin e thjeshtë sepse kanë ardhur për të vrarë.

— Ke të drejtë, — më tha. — Nejse. Filluam një bisedë dhe papritur ajo mori tjetër drejtim. Përgjithësisht unë nuk i kam qejf bisedat, por me ju qenka ndryshe.

Ai qeshi, duke zbuluar një palë dhëmbë të rregullt, të bardhë. — A vini të pimë një kafe? Ja, tek ai qoshku atje.

— Po tablotë?

— I shikon ai, — më tha duke treguar përtej shitësin e cigareve. — Pastaj, njerëzit nuk çajnë shumë kryet për to. Dhe këtu është gjithnjë e keqja, — qeshi me hidhërim ai.

Shkuam te qoshku e morëm nga një kafe.

— Është për të ardhur keq, — i thashë, — që njerëzit ia kthejnë shpinën kështu artit të vërtetë.

Ai u mendua pak, piu një gllënjkë kafe dhe foli:

— S'janë kaq të thjeshta këto gjëra. Për pikturë të vërtetë pretendojnë edhe stile të tjera. Dhe, për fat të keq, mbahen si të tilla.

→ E di, — i thashë dhe heshta.

— Edhe unë mund të pikturoj ashtu, — tha ai me trishtim. — Dalim?

Pohova me kokë. Ndërsa ecnim ai vazhdoi:

— Para pak kohe bëra disa tablo, me mundim e me luftë, sepse po shkelja mbi diçka të shenjtë. Në shkollë kam mësuar edhe mënyra të tjera vizatimi, por unë gjithnjë kam mbetur i ftohtë ndaj tyre.

Ai heshti pak e vazhdoi:

— Njérës nga tablotë i kushtova më shumë rënëdësi. Përvijova disa nga lojërat e Pikasosë, disa nga trajtat e ngjyrat e Dalisë, nga përbindëshat e Gojës, trillova ca trajta e forma të ndryshme dhe ky gjësend u quajt i përfunduar. Por nuk pata guxim apo dëshirë ta çoja atje, në rrugën «Kiaramonte», ku qmoheshin këto lloj tablosh. Piktura për një kohë të gjatë më mbeti në shtëpi. Derisa një ditë, kur kishim mbetur pa të holla, e çoi gruaja. Tre fëmijë, më ku toni zotëri, duan të hanë. Dhe e pëlqyen. Apo bënë sikur e pëlqyen që të më tertiqnin edhe mua, sepse unë e kam njëfarë emri. Nejse, fakti është se ata e paguan mirë atë tablo. Gjë që mua nuk më gëzoi. Më besoni, nuk më gëzoi.

Unë pohova heshtur.

— Qysh atëherë nuk kam bërë më asgjë të tillë. Edhe pse shpesh në shtëpi jemi ndodhur ngshtë...

— Është gjë e madhe për njeriun kur i qëndron besnik pasionit të tij të pastër, — i thashë.

— E thatë bulkur, — tha ai dhe i shkëlavën svatë. — Pasionit të pastër. Po, ashtu është, po deri kur? Sepse nesër as vetë nuk e di çdo të bëj.

— Ju megjithatë nuk do të hiqni dorë nga ai, zoti...

— Tirelli, — tha ai, — Euxhenio.

— Po, Euxhenio, ju nuk duhet të hiqni dorë nga arti juaj.

Zjarri i ndezur në sytë e tij përsëri shkreptiu. E vazhduam bisedën edhe për një copë herë e ndër-kohë unë vendosa t'i blija atë tablonë ku shkulmat e detit, plot me stërkala e shkumë të bardhë, goditnин pareshtur kështjellën.

— Kjo ju pëlqeu më shumë? — më pyeti.

— Po, — i thashë dhe ia tregova. — Megjithë-se, ndershmërisht jua them, e kam vështirë t'i dalloj nga njëra-tjetra për nga bulkuria. Sidoqo fitë më shumë kjo më pëlqeu dhe do ta blej.

— Jo, nuk do t'jua shes, — tha ai, — do t'jua fal.

— Ju lutem, — i thashë, — nuk është nevojë.

— Unë e vendosa, — tha ai. — Kam dëshirë t'jua fal. Kam kaq kohë që s'kam bërë një bisedë të tillë me një njeri që të më kuptojë. Sepse... — këtu iu drodh pak zëri. — edhe shumë nga miqtë e mi të vjetër kanë filluar të mos më kuptojnë. Dhe ja, vini ju nga një vend i huaj e më prekni në diçka që mua më dhemb.

Ai heshti pak e vazhdoi: — Do të më bëhet qejfi që atë do ta shikojnë e ndoshta do ta pëlqejenë edhe miqtë tuaj. Vetëm dua të di edhe unë emrin tuaj.

Unë ia thashë. Ai mori tablonë dhe ma zgjati.

— Kështu, ju nuk keni për ta harruar një piktor shpresëpak pranë këtij gjiri të bukur.

E mora tablonë në duar duke u përpjekur të mposhtja emocionet.

— Falemnderit, mik, — më tha. — Falemnderit! Besoj mund t'ju quaj mikun tim, apo jo?

— Sigurisht, — i thashë. — Edhe unë dua t'ju falënderoj. Jam i sigurt se një ditë pikturat tuaja do të vlërësohen.

— Falemnderit, — tha ai. — Falemnderit që keni besim!

PASQYRË LËNDE

Flladi i mbrëmjes	3
Thirrja e gjelbërimit	17
Marti dhe xha Mihali	40
Kopshti me mollë	71
Një grindje jo e zakonshme	95
Natë kujtimesh	107
Pikturat buzë detit	145

Pone, S.

Flladi i mbrëmjes. Tregime. [Red.:
T. Haxhimihali J. T., «Naim Frashëri»,
1984.

156 f.

(B.m.) dhe
(B.v.) : 891.983-32

P 85

Tirazhi 4000 kopje Format 70x100/32 Stash 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re —
Tiranë, 1984